



Fondacioni Kosovës për Shoqëri të Hapur

Raport i
Punës
2011



#2 [Programi për Integritet Evropian dhe Qeverisje të Mirë]

#2 Programi për Integrim Evropian dhe Qeverisje të Mirë

Konteksti i përgjithshëm

Kosova vazhdon të ngec në rrugëtimin drejtë anëtarësimit në Bashkimin Evropian për dy arsye. E para është mosnjohja nga 5 shtete anëtare, ndërsa arsyeja e dytë është progresi i ngadalshëm në përmbushje të detyrave të shtruara në Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian. Ri rezultat i kësaj, viti 2011 nuk ka sjell avancim të veçantë në marrëdhëniet që Kosova ka me Bashkimin Evropian drejtë realizimit të perspektivës evropiane, mirëpo ka sjell risi në rolin e Bashkimit Evropian në zhvillimet brenda vendit. Që nga muaji Mars 2011, kur u vendosën strukturat qeveritare pas zgjedhjeve të dhjetorit 2010, Bashkimi Evropian ka marrë rolin e lehtësuesit dhe po ndërmjetëson dialogun mes Kosovës dhe Serbisë drejtë normalizimit eventual të marrëdhënieve. Edhe pse janë arritur disa marrëveshje për çështje teknike, zbatimi i tyre u tregua të jetë mjaft sfidues, dhe që nga korriku 2011, kur Policia e Kosovës ndërhyri të marrë dy pika kufitare në veri nën kontroll, diskursi politik në Kosovë është duke u dominuar mjaft nga këto zhvillime. Duke qenë se zhvillimet në veri janë mbështetur dukshëm nga strukturat politike në Beograd, në dhjetor 2011, u bë e qartë se ato nuk i ndihmuan Serbisë të fitojë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE.

Megjithatë retorika e evropianizimit ka ndëruar kursin. Retorika politike, e aplikuar nga përfaqësuesit qeveritar të Kosovës ndaj institucioneve dhe përfaqësuesve të Bashkimit Evropian ka përmbajtur kërkesa konkrete në krahasim me një vit më parë. Ndikim të madh në këtë ndryshim ka ushtruar vetë Fondacioni i Kosoves për Shoqëri të Hapur. Dy projekte avokimi të veçanta, Të Jetosh në Geto dhe Zgjedhja e Europës: Integro ose Stagno kanë prezentuar qartë situatën aktuale në Kosovë, duke përfshi këtu izolimin e qytetarëve karshi fqinjëve të rajonit, zonës Shengen, dhe më tej, si dhe stagnimin aktual të Kosovës në proces të integritimit.

Theksimi në raport I faktit që perspektiva evropiane e Kosoves nuk mund të konkretizohet pa perspektive të vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale, dhe pa ripërterimje të marrëveshjes për masat autonome tregtare është adoptuar nga udhëheqësit politik në Kosove dhe është

berë pjesë integrale e komunikimit të tyre me zyrtarëve evropian dhe publikun kosovar. Si rezultat i kësaj del edhe dhenia e dialogut për viza, në janar 2012, një avancim i shprehshëm nga Bashkimi Evropian për përmbushje të detyrave paraprake, e që për Kosovën kanë ripranimi dhe riintegrimi kosovarëve të kthyer nga shtete evropiane.

Raporti i Progresit ka sjellë mjaft tone kritike edhe për vitin 2011. Administrata e politizuar, mbikqyrje e dobët nga ana e Kuvendit, mungesa e platformës institucionale për dialog me institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare, verifikimi i dobët i legjislacionit të propozuar për përputhshmërinë me prioritetet e integritimit evropian, reformim i ngadalshëm i administratës, etj. veçohen si kritika madhore të raportit të fundit. Megjithatë në disa pjesë, raporti prezenton vlerësim pozitiv për progresin e arritur në disa aspekte të qeverisjes e që janë ndihmuar gjatë vitit me projektin Capacity Development Facility.

Në gjithë këtë kontekst, përmbushja e qëllimeve strategjike të programit për Integrim Evropian dhe Qeverisje të Mirë ka vazhduar pa u penguar. Projektet operacionale dhe përshtatshmëria e tyre ndaj sfidave të shumta kanë vazhduar të jenë mekanizmat kryesor të programit. Së bashku me projektet e grantuara, programi ka realizuar 135 projekte të ndryshme, në të katër orientimet strategjike:

- Qëllimi 1: Të kërkojë llogari nga qeveria për progresin në kuadër të procesit të integritimit evropian
- Qëllimi 2: Të ndërtojë kanale efektive dhe efikiente të komunikimit me shoqërinë civile e pesë shteteve evropiane që pengojnë procesin integruar të Kosovës në BE
- Qëllimi 3: Të avokojë më tepër pranë Bashkimit Evropian që të përfshijë Kosovën në politikën e tij të rregullt të zgjerimit
- Qëllimi 4: Të ngrisë efikasitetin e administratës Kosovare karshi reformave dhe procesit integruar

Kryesisht të gjitha aktivitetet e parapara në vitin 2011 kanë shkuar sipas planit. Programi i Integritimit Evropian dhe Qeverisjes së Mirë, është në pjesën më të madhe të tij i organizuar me projekte operacionale, sic janë Forumi 2015, Capacity Development Fund (CDF), Communicating with Europe, Shkolla për Integrim Evropian dhe Bridging Europe. Të gjitha këto do të vazhdojnë edhe në vitin 2012, në mes tjerash edhe fal faktit se programet si Communicating with Europe kanë fituar donacion të ri

nga qeveria e Kosoves dhe British Council. Ne vazhdim te projekteve operacionale, Programi ka bashkepunuar me shume CSO dhe think tenk grupe ne vend dhe jashte tij, si grantdhenes apo thjeshte si partner implementues.

Ajo qe ka shkuar posaqerisht mire ne vitin 2011 jane aktivitetet e lidhura me projektin (ad-one) Communicating with Europe, me crast fondacioni i ka vendosur kontaktet vendet me te cilat keto kontakte kane qene dhe akoma mbeten te veshtiresuara, edhe pse vazhdimisht shihen permiresime ne kete drejtim. Pasi qe ne vitin 2010 fondacioni punoi me Spanjen, Greqin dhe Serbine kryesisht, ne vitin 2011 eshte thelluar bashkepounimi me Serbine, dhe eshte vendosur nje komunikim shume i mire me Sllovakine dhe Rumanin. Ne fillim te vitit 2012 do te behet e njejta pune edhe me Bosnen dhe Hercegovinen, per cka jane bere te gjitha pergatitjet e duhura. Ky projekt ka treguar shume rezultate konkrete, mbi ato te parashikuara, e ne rend te pare, vazhdimin e komunikimit civil ne mes te Kosoves dhe shteteve europiane qe nuk e kane njohur pavarisine e saj dhe i kanepase te mbyllura shume detyra te komunikimit. Ky rezultat deshmohet me faktin se shume organizata tjera vazhduan te punojne ne kete drejtim, e sidomos organizata - think tenk grupe ne vendet me te cilat kemi punuar deri tash. Ato, jo vetem se kane mbetur te interesuara te vazhdojne bashkepounimin, por edhe jane duke nxitur nga ana e tyre projekte te ngjashme. Ne vitin e kaluar disa organizata dhe qeveri kane organizuar kontakte ne te gjitha nivelet, per ta adresuar nevojën e hapjes se komunikimit ne mes te shoqerive respektive, pavarisisht nga pozicioni politik i ketyre vendeve.

Forumi 2015 vazhdoi edhe ne 2011 te avokojte per integrimin e vendit ne BE. Disa studime te bera ne kete drejtim jane prezentuar gjere ne Kosove dhe BE. Sot, mund te thuhet , fale edhe iniciativave te fondacionit, ne Bruksel dhe Prishtine, presioni i shoqerise Kosovare ndihet shume me shume ne Bruksel, kur kemi te bejme me procesin e integrimin dhe liberalizimit te vizave. Ne muajin qe vjen pritet te shohim nje rezultat konkret te avokimit kembengules qe fondacioni ka bere gjate 2010 dhe 2011 përu liberalizim te vizave: dilaogu zyrtar ne mes te Prishtines dhe Brukselit duihet te filloje.

Disa projekte te Programit EU GG, gjate ketij viti kane filluar te ndryshojne per se mbrendi per t'i adresuar nevojat specifike qe vazhdimisht ndryshojne te perfituesve te projekteve. Fjala eshte per projektet afatgjata CDF dhe EIS. Ne vitin 2012, qe te dy keto projekte do te ndryshojne duke u perqendruar ne disa aspekte konkrete qe i kerkon sot koha dhe ambienti politik ne vend.

Projekti CDF do te perqendrihet vetem ne 3-4 lemi prioritare veprimi te qeverise se Kosoves - integrimet ne BE, pushteti i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe integrimi i minoriteteve. Pra nepermes te CDF keshillatereve qeveria do te ndihmohet per te adresuar keto prioritete strategjike vetem, e jo si me pare kur ajo eshte mbeshtetur ne shume me shume lemi veprimi. Ne anen tjetër, Shkolla per Integrimin Evropiane, poashtu do te fokusohet vetem ne disa lemi ku mungon ekspertize per politikën dhe ligjet europiane, si dhe rregullat e saj.

Në vijim ky raport pershkruan të arriturat dhe realizimet e programit në katër orientimet strategjike të tij

Qëllimi 1: Të kërkojë llogari nga qeveria për progresin në kuadër te procesit të integrimin evropian

Programi i IEQM është angazhuar që progresi në përmbushje të prioriteteve evropianizuese të jetë proces transparent duke mbështetur angazhimin e shoqërisë civile për të kërkuar llogari në strukturat qeveritare për veprimet apo mos-veprimet në proces. Për të arritur këtë qëllim, programi ka vepruar në realizimin e dy objektivave konkrete: Gjatë vitit 2011, programi realizuar dhe mbështetur një sërë aktivitetesh të cilat kanë monitorur procese qeverisëse bazuar në indikator të qartë. Për të përmbushur këtë objektiv programi ka aplikuar çasje dz-kahëshe. Ne njëren anë, programi ka realizuar vetë projekte monitoruese, me të cilat është avokur drejtë përmirësimit të qeverisjes dhe performancës ne segmente të caktuara. Këtë programi e ka realizu kryesisht nëpërmjet projektit të vetë operacionel Forum 2015, i cili qe nga themelimi shërben si mekanizmi kryesor avokues i Fondacionit. Në këtë mënyrë, programi ka ngritur çështjen e transparencës qeveritare të buxhetit shtetëror, të funksionimit të bordeve të ndërmarrjeve publike dhe politizimit të tyre, të raportimit të korrupsionit, të përmbushjes se planeve të ndërmarrjeve të privatizuara, të funksionimit të shtetit ne segmente të ndryshme, qeverisja me mjedisin ne Kosovë, etj. Në bashkëpunim të vazhdueshëm me organizata think tank, Forumi 2015 me studimet e veta ka nxitur dhe ushqyer debatin publik në çështjet ne të cilat vërrehet ngecje e madhe në qeverisje. Çështjet e ngritura gjithnjë e më tepër po janë çështje kritike të meanxhimit të fondeve publike, transparencës, dhe eficiences së tyre, ndërsa tema e mjedisit dhe korrupsionit kanë qenë proritaret ne krahasim me aspektet tjera. Në vijim raporti pershkruan aktivitetet dhe të arriturat e Forumit 2015, sipas kronologjisë retroaktive.

4 Reportazhe Sfidojnë Qeverisjen E Mjedisit Në Kosovë

Forumi 2015 ka sjellë për herë të parë në Kosovë kater mediumet nacionale në një projekt të përbashkët, e ky është debati për problemet mjedisore. Secili nga mediumet me mbulesë mbarë vendore ka realizuar një reportazh të vecantë në të cilin është adresu një segment i sfidave. Klan Kosova ka përgatit reportazhin për inspektoratin e mjedisit, Kohavizioni ka hulumtuar problemin e grymjen e lumenjeve për nxjerrje të zhavorrit ndërtime, RTV21 ka hulumtuar zhveshjen e Bjeshkëve të Nemuna nga premja ilegale e drunjëve, ndërsa Radio Televizioni i Kosovës ka realizu një reportazh për ndotjen e mjedisit nga fabrika e Feroniklit në Drenas. Secili reportazh është transmetuar në televizionet adekuate, i përcjellë me diskutime, ndërsa Fondacioni është duke përgatitur një tryeze madhore, ku do të prezentohet përmbledhja e të katër reportazheve dhe do të publikohet përmbledhja me 4 shkrime në keto tema.

Bankat Komerciale Dhe Zhvillimi Ekonomik

është një temë e re e cila nuk është prekur me parë qoftë nga analistë apo organizata vendore. Produktet dhe shërbimet e bankave komerciale në përgjithësi duhet të i shërbejnë edhe zhvillimit të vendit e jo vetëm të sigurimit të profitit vetanak. Për këtë arsye, Forumi 2015 bashkë me Institutin Riinvest kanë realizuar hulumtimin i cili prezenton të dhëna nëse bankat komerciale në Kosovë dhe produktet e shërbimet e tyre stimulojnë zhvillimin ekonomik apo jo. Studimi do të i prezentohet publikut kosovar në mars 2012.

Religjioni dhe Interesi Publik (nëntor 2011)

me kërkesë të të Fondacionit, Qendra për Studime Humanistike "Gani Bobi" ka realizuar studimin e parë në Kosovë me të cilin është tentuar të gjinden përgjegje në disa pyetje mbi sensibilitetin e opinionit kosovar ndaj çështjeve fetare, e që vitin që shkoi u dëgjuan pak më shpesh se më parë në opinionin publik. Çfarë mendojnë kosovarët për religjionin, për mënyrën tradicionale të praktikimit të islamit, për rrymat e reja që ofrojnë një praktikim tjetër të tij, për orientimin pro perëndimor të vendit, si dhe për çështjet konkrete të mbulesës së femrave dhe edukatës fetare në shkollat publike. Në tryezën e organizuar nga Forumi 2015, këto çështje u diskutuan shumë hapur dhe u prezentuan qëndrime të ndryshme nga pjesëmarrësit, të cilët vinin nga Bashkësia Islame, akademia, shoqëria civile, dhe mediat.

Studimi me të njëjtin titull u promovua mu në këtë tryezë.

Korrupsioni dhe Krimi i Organizuar – 10 vjet bashkëjetesë me politikën (shtator 2011)

This is a project which through three individual është projekt i cili me tri vepra individuale tërheq vëmendjen e opinionit kosovar për shtrirjen horizontale dhe vertikale të korrupsionit në Kosovë dhe vë në pah se gazetarët investigativ janë sturktura kryesore shoqërore e cila përkundër vështirësive dhe kërcënimeve mbetet forma e vetme e luftimit të këtij fenomeni. Prezenca e korrupsionit në projekte madhore zhvillimore dhe dhe anashkalimi i interesave kombëtar për zhvillim ekonomik për interesa politike të grupeve të caktuara janë temë kyçe e këtij projekti. Që nga fillimi i privatizimit të ndërmarjeve publike në vitin 2006, me privatizimin e Ferronikelit e deri në ditët e sotme ky proces është përcjellë me procedura e vendime të dyshimta të cilat bazuar në prezentimet nga mediat kosovare intersat zhvillimor të Kosovës i zëvendësojnë me interesa të investitorëve të huaj, strukturave të huaja, apo grupeve të veçanta politike. Në anën tjetër, gazetarët investigues kanë qenë gjithmonë të aktive në raportimin e këtyre proceseve.

Prandaj, duke u bazuar në masë të madhe me materiale arkivore, Forumi 2015, në bashkëpunim me organizatën Çohu, kanë realizuar 3 produkte avokuese përfshi këtu filmin dokumentar Korrupsioni dhe **Krimi i Organizuar – 10 vjet Bashkëjetesë me Politikën, përmbëdhjen e artikujve Hallka më e dobët e Demokracisë Kosovare, dhe publikimi Të Jeshë Gazetar në Kosovë**. Filmi dokumentar investigon 4 raste në të cilat një privatizim, licencim, apo tenderim me rëndësi të interesit kombëtar janë përcjellë me shkelje të numërta ligjore, procedurale, dhe keqmenaxhim me fonde dhe interesa nacionale për zhvillim ekonomik. Rastet e ilustruara në dokumentar përfshijnë, privatizimin e Ferronikelit, licencimin për opertorin e dytë të telefonisë mobile, ndërtimi i termo-centralit Kosova e Re, privatizimi i Post-Telekomunikacionit të Kosovës, dhe ndërtimin e autostradës Vërmicë-Merdare.

Së bashku me dokumentarin, Fondacioni dhe organizata Çohu kanë publikuar një sërë shkrimesh në të njëjtën temë. Përmbëdhja e artikujve **Hallka më e Dobët e Demokracisë Kosovare** sjell artikuj të ri, por edhe të publikuar më parë mbi aspekte të ndryshme të korrupsionit në Kosovë. Hallka sjell shkrime autoriale nga Luan Shllaku, Lumir Abdixhiku, Kujtim Kerveshi, Avni Zogjani, e Hasan Preteni, dhe përmbledh një sërë artikujve

jsh të mëhershëm duke dokumentuar kështu se rastet e vjetra të vendim-marrjes se korrumpuar vazhdojnë të jenë të pa adresuara nga organet e gjyqësorit, duke i dhënë hov trendit të tillë. Pos rasteve të ilustruara ne dokumentar, artikujt e prezentuar ne këtë publikim informojnë për financimin e partive politike nëpërmjet tenderet publike si një keqpërdorim tjetër i pushtetit dhe fondeve publike për interesa partiake.

Publikimi **Të Jeshë Gazetar në Kosovë** dokumenton vështirësitë me të cilat ballafaqohen gazetarët kosovar gjatë raportimit të rasteve korruptive. Plagosje me armë zjarri, rrahje në mes të rrugës, tërheqje zvarrë, kërcënime me telefon e shumë kanosje të tjera janë përvoja të shumta të gazetarëve kosovarë, e që vijnë nga zyrtar qeveritar nga të gjitha nivelet, asnjëherë pa u adresuar nga institucionet e drejtësisë.

Të gjitha këto iu prezentuan publikut kosovar ne një tryeze të rrumbullakët e cila shënoi pjesëmarrje të gjerë. Edhe pse të gjitha këto dokumente flasin shumë për fenomenin e korrupsionit ne Kosovë, fakti që mediat kosovare hezituan të transmetojnë dokumentarin flet shumë për ndikimin e pushtetit politik. Përfundimisht, Fondacioni arriti që dokumentarin ta shfaq ne kanalin televiziv Top Channel, i cili edhe pse bazuar në Tiranë, transmeton edhe ne Kosovë e rajon. Ky transmetim u pasua nga një debat me autorët dhe drejtorin e Fondacionit, në n drejtimin e Rudina Xhungës, në emisionin Shqip.

Reforma e Sistemit të Shëndetit Publik (shtator 2011) – analizoi situatën aktuale ne shëndetin publik të Kosovës dhe propozoi opsione për zgjidhje të qëndrueshme për përmirësim të kualitetit dhe zgjerim të spektrit të shërbimeve shëndetësore. Tryeza prezantoi të gjeturat e studimit të Forumit 2015 Si ta Mjekojmë Mjekësinë i cili për herë të parë në Kosovë prezantoi spektrin e gjerë të problemeve që e sfidojnë me këtë sektor, duke filluar nga financimi shëndetësor, pagesat, organizimi, legjisllacioni, dhe sjellja. Ministri i Shëndetësisë ka çmuar shumë studimin e prezentuar dhe diskutimin e bërë

Pasqyra E Shtetit: Indikatorët E Bazuar Në Performancë (Korrik, 2011)

Raporte të shumta vendore e ndërkombëtare prezantojnë të dhëna të ndryshme mbi zhvillimet politike, ekonomike, e shoqërore në vend. Rezultatet e tyre varrojnë shpesh mes vete, në mungesë të të dhënave të besueshme statistikore autentike kosovare. Mbështetur nga Forumi 2015, Instituti për Demokraci e Zhvillim (D4D) ka identifikuar me se 400 indikatorë të

performancës që mbulojnë sektorët e ekonomisë, qeverisjes, sundimit të ligjit, sigurisë, shëndetësisë, arsimit, kulturës e tjerë dhe i ka publikuar në raportin Pasqyra e Shtetit: Indikatorët e Bazuar në Performancë. Ky raport synon të bëhet raport periodik i organizatës D4D me të cilin do të përcillen trendët zhvillimore në vend. Be tryezën e mbajtur me 12 korrik, 2011, dokumentin e komentuan edhe analist te shqar kosovar, përfshirë këtu Agron Bajramin, Besnik Pulën, Dardan Sadriu, dhe Kujtim Kerveshi.

Shteti dhe buxheti: kujdes faturën! – (korrik, 2011)

Problemet e menaxhimit të aseteve publike po ndikojnë dukshëm në rrezikimin e qëndrueshmërisë financiare të vendit. Keto kryesisht janë të ndërlidhura në tri segmente kryesore: Qëndrueshmërinë Buxhetore, ndërtimin e Autostradës "Ibrahim Rugova" dhe shitjen e Postës dhe Telekomit të Kosovës. Buxheti i miratuar nga Parlamenti i vendit për 2011 ka shënuar disa defekte serioze për stabilitetin ekonomik të vendit. Projekti që ka shkaktuar barrën më të madhe në buxhetin e vendit, është ndërtimi i autostradës "Ibrahim Rugova" me një kosto financiare të vlerësuar sa një e katërta e Bruto Produktit të vendit. Kontrata e autostradës vazhdon edhe sot të jetë e mbyllur për publik ndonëse parametrat e prezantuar në projeksionet buxhetore arrijnë një vlerë rreth 1 miliardë euro. Regresi i marrëdhënieve me Fondin Monetar Ndërkombëtar ka thelluar problemet me deficitin buxhetor të vendit, duke rrezikuar që vendi të mbes pa asnjë rezervë bankare në fund të vitit 2011. Kjo ka rritur domosdoshmërinë e shitjes së aseteve publike, me theks të veçantë në Postën dhe Telekomin e Kosovës, përkundër implikimeve negative që mund të dalin nga ky proces. Për më tepër, mungesa e transparencës së plotë në menaxhimin e aseteve publike si dhe paqartësitë rreth këtyre proceseve krijojnë mundësinë e paraqitjes së disa skenarëve të pafavorshëm për vendin.

Forum 2015 dhe Instituti Riinvest kanë publikuar një raport hulumtimi synim i të cilit është të (a) përmirësoj informimin e politikëbërësve dhe palëve të tjera të interesuara të shoqërisë lidhur me çështjen e qëndrueshmërisë buxhetore në vitet që vijnë përballë burimeve të pa sigurta për financimin e projekteve të mëdha kapitale që veçse janë kontraktuar dhe (b) të përmirësoj transparencën dhe llogaridhënien e vendim-marrësve në këto procese si dhe (c) të ndihmoj procesin e rishikimit buxhetor të gjysmëvitet 2011. Raporti u prezantua për herë të parë në tryezën e mbajtur me 1 korrik, 2011.

Bordet e Ndërmarrjeve Publike (Qershor, 2011)

Çështja e pavarësisë dhe transparencës të bordeve të ndërmarrjeve publike është shtjelluar shumë herë në opinion publik Kosovar. Pavarësia dhe profesionalizmi i këtyre bordeve nuk përkojnë gjithmonë me ligjin dhe kjo gjë është raportuar vazhdimisht nga mediat. Megjithatë, ky problem është akoma më i rëndë se që duket për shkak se vetë ligjet nuk sigurojnë një kornizë të përshtatshme për përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen efektive të bordeve të kompanive publike dhe agjencive të pavarura në Kosovë. Si rezultat, ka lindur domosdoshmëria për një studim, përfshirë këtu edhe një analizë të kornizës ligjore që i rregullon këto çështje, të bordeve, pavarësisë dhe procesit të përzgjedhjes së tyre. Me mbështetje të Forumit 2015, KIPRED ka analizuar kornizën ligjore të përzgjedhjes të bordeve të drejtorëve të agjencive të pavarura dhe ndërmarrjeve publike. Në bazë të këtyre ligjeve janë analizuar lidhjet politike, shpërdorimi i detyrës, problemet dhe shkeljet në procesin e përzgjedhjes, etj. Në fund është publikuar një studim i cili i evidenton problemet me kornizën ligjore, jep shembuj të pasojave që këto ligje kanë dhe rekomandime për përmirësim. Raporti është publikuar me 29 qershor, 2011 dhe ka tërhequr vëmendjen e mediave dhe institucioneve përkatëse duke hapur rrugën për avokim në të ardhmen.

Aksham Pazari i Aseteve Publike (13 Prill, 2011)

Vitin e kaluar, Kosova ka filluar implementimin e një projekti rekord kapital, me një kosto financiare të vlerësuar sa një e katërta e Bruto Produktit të vendit. Kontrata e autostradës "Ibrahim Rugova" vazhdon edhe sot të jetë e mbyllur për publik ndonëse parametrat e prezantuar në projeksionet buxhetore arrijnë një vlerë rreth 1 miliardë euro. Mungesa e alternativave financuese ka bërë që vendi të planifikojë hendeqe të mëdha buxhetore në tre vitet e ardhshme; hendeqe këto që rrezikojnë seriozisht stabilitetin financiar të vendit dhe prosperitetin ekonomik. Kalimet nga suficitet e bollshme në deficitet e thella buxhetore tregojnë se Kosova po shpenzon më shumë se që ka. Një qasje e tillë në menaxhimin e parasë publike ka shtyrë vendin të shikojë drejt asetëve nacionale, me theks të veçantë drejt Telekomit të vendit dhe sektorit energjetik nëpërmjet projektit Kosova e Re; ndërmarrje këto publike me potenciale enorme. Shitja e Telekomit nacional do të mundësonte financimin e deficitit buxhetor për vitin 2011, ndonëse deficitet vijuese do të mbeteshin të pambuluara. Nevoja për shitje të asetëve prof-

itabile afatshkurta për të ndërtuar të tjera afatgjate, ka ngjallë papajtueshmëri në mes vendim-marrësve, partive opozitare dhe shoqërisë civile. Shitja për borxh dhe për nguti ka ngjallë frikën e mosmarrjes së vlerës reale të tregut për asetet e dhëna. Për më tepër, mungesa e konsensusit në menaxhimin e pasurisë nacionale ka krijuar potencial për paqëndrueshmërinë ekonomike të vendit dhe ka kërcënuar seriozisht menaxhimin e duhur të pasurisë publike.

Për të diskutuar këto çështje, Forumi 2015 ka organizuar tryezën më 13 Prill 2011, në të cilën ka ftuar përfaqësues qeveritar, diplomatik, e të shoqërisë civile të diskutojnë trendin ekzistues duke prezantuar të dhëna të reja mbi dy iniciativat më të mëdha qeveritare, atë të ndërtimit të autostradës dhe të privatizimit të Post-Telekomit të Kosovës.

Takimi Strategjik I KFOS (Mars 2011)

Duke perserit traditen e viteve të kaluara, edhe kete vit Fondacioni organizoi një takim strategjik, në të cilin me anetarët e bordit dhe me miq të Fondacionit u diskutuan sfidat e pritura për zhvillimin politik e ekonomik të Kosovës. Pjesëmarrësit, të cilët erdhën kryesisht nga shoqëria civile diskutuan një sërë problemesh të cilat duhen adresuar nëpërmjet aktiviteteve të Fondacionit, goftë nëpërmjet Forumit 2015, apo projekteve tjera. Temat e identifikuar janë të listuara përfshinë: a) Reforma zgjedhore dhe standardet e saj, b) Shitja e ndërmarrjeve publike – me çfare procedurash, c) Kufizimi i lirive nga sundimi i pakices, ç) Menagjimi i parase publike në lidhje me pasuritë nacionale të Kosovës, d) Rënia e fuqisë blerëse dhe stabiliteti social e politik, dh) Mediumi publik jo publik, e) Sindikatat – në shërbim në kujt, è) Agjencia e Inteligjences për kënd, f) Kush është parlamenti dhe cka kemi në të, g) Mungesa e pozicionit dhe planit të veprimit për veriun në dialog; gj) Çfare benefitesh nga shitja e asetëve nacionale, h) Regjistrimi i popullatës (serbet munden me u regjistru, ndersa kosovaret e diasporës jo), i) Shoqëria civile kosovare – cka është dhe kah po shkon si rrojtare e demokracisë, j) Pse Kosova humb grante të huaja – faktorët e kapacitetit të ulte absorbues, dhe l) Lobimi në Washington.

Shoqëria Civile dhe Partite Politike Parlamentare Diskutojnë Dialogun Kosovë – Serbi (Mars, 2011)

Që nga vera 2010, Fondacioni dhe Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ) kanë punuar në hartimin e platformës për normalizimin e marrëdhënieve me

Serbinë. Procesi gjithëpërfshirës ka sjellë në një tavoline partitë parlamentare (pozitë dhe opozitë), përfaqësues diplomatik, dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në fillim të këtij viti teme boshte e retorikes politike ishte bere fillimi i dialogut teknik mes Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, shoqëria kosovare nuk kishte parë ndonjë tentativë të organeve shtetërore për të shkëmbyer mendime, opsione dhe propozime brenda një korpusi më të gjerë shoqëror, për ta definuar më mirë pozitën e palës kosovare në këto bisedime. Prandaj Fondacioni, në partneritet me KPJ-në, ftuan një takim me përfaqësuesit e grupeve të cilat kishin qene pjesëmarrëse të takimeve që nga inicimi i projekti, dhe se bashke të prezantojnë dhe diskutojnë draftin e parë të prezantojnë draftin e parë të "punimit" (position paper) mbi platformën e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Takimi u mbajt me 9 mars, 2011, në sallën e hotelit Gorenje.

Në anën tjetër programi ka bashkëpunuar ngushtë me organizata qeveritare. Qoftë me ftesë të hapur me konkurs, apo me pranim e shqyrtim të vazhdueshëm të propozimeve të ndryshme, programi ka mbështetur projekte të OJQ-ve kosovare të cilat kanë vazhduar të luajnë rolin e tyre kritik në mbikqyrrjen e progresit të proceseve evropianizuese. Tema të ndryshme kanë zgjuar kërshërinë e organizatave kosovare të cilat vepronë drejtë avancimit të qeverisjes në Kosovë, përfshirë këtu transparencën e qeverisjes qendrore, efektiviteti i privatizimit të aeroportit, korrupcioni dhe gazetaria investigative, qeverisja e ndërmarrjeve publike, etj.

Tabela në vijim prezenton grantet e realizuara:

KIPRED	Analizë e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike	€ 7,400.00
Riinvest Institute	Shteti dhe buxheti	€ 9,989.20
Gani Bobi	Studimi: a janë myslimanët të diskriminuar në Kosovë?	€ 9,280.00
Arbana Xharra	Hulumtimi: të jesh gazetarë në Kosovë.....	€ 1,200.00
Artan Haraqija	Hulumtimi: të jesh gazetarë në Kosovë.....	€ 1,200.00
Instituti Riinvest	Ndikimi i sektorit të bankave në zhvillimin ekonomik të Kosovës	€ 9,723.20
Regional Environmental Center	Vetëdijësim për problemet me ambientin	€ 9,909.00
Radio Televizioni 21	Reportazh mbi bjeshket e nëmuna	€ 3,500.00
TV Klan Kosova	Reportazh për inspektoriatin e mjedisit	€ 3,500.00
Kohavision TV	Reportazh për gurrethyesit në Kosovë	€ 3,500.00
Radio Televizioni I Kosovës	Reportazh për mjedisin në Kosovë - Ferronikli	€ 3,500.00
Dokupolis	Ndodhja urbane, film dokumentar	€ 6,570.00
Foreign Policy Club	Magazina foreign policy	€ 8,200.00
Foreign Policy Initiative, Sarajevo, Bosnia and Hercegovina	Study visit of a delegation from Bosnia and Hercegovina to Kosovo	€ 7,000.00
Meteor	Vlerësimi i forumi 2015	€ 1,995.20
Coordination and research	Operacionale	€ 7,161.00
Production Services	Operacionale	€ 22,604.30
Publications	Operacionale	€ 21,050.00
Round table discussions and conferences	Operacionale	€ 13,045.40

Qëllimi 2: Të ndërtojë kanale efektive dhe efikente të komunikimit me shoqërinë civile të pesë shteteve evropiane që pengojnë procesin integrues të Kosovës në BE

Që nga viti 2009, Fondacioni ka realizuar projektin Të Komunikosh me Evropën nëpërmjet të cilit po synon të ndërtojë imazh dhe perceptime të reja për Kosovën duke prezentuar realitetin ekzistues, dhe perspektivën evropiane të cilat do të duhet të jenë bazë për komunikim me shoqëritë evropiane dhe ato në rajon. Deri më tani, Fondacioni ka shkëmbyer vizita të numërta me delegacione nga pesë shtete evropiane dhe Serbia, e poashtu edhe ka realizuar vizita të numërta në po këto shtete. Secila vizitë ka krijuar kuptim të ri në mesin e vizitorëve për Kosovën sepse theksi i është vënë të arriturave në procesin e shtet-ndërtimit pas vitit 1999.

Në fillim të vitit, Fondacioni ka prezentuar një formë të re të veprimit në këtë drejtim. Me qëllim që audiencia kosovare të ketë sa më shumë

informata adekuate për pozicionet e pesë shteteve evropiane dhe dy shteteve në rajon ndaj Kosovës, dhe formësimin e tyre gjatë historisë së viteve të fundit, programi ka angazhuar ekspertë dhe/ose think tank organizata në vendet e adersuara që të hartojnë punime analitike. Punimet e realizuara kanë shërbyer shumë mire në përgatitjen e përmbajtjes së programit për vizitat shëmbyese, qoftë në Kosovë apo në vendet e vizituara nga delegacionet kosovare. Si rrjedhim, projekti ka realizuar 4 punime individuale.

Suksesi i projektit Të Komunikosh me Evropën nuk ka kaluar pa u vërretur nga strukturat qeveritare të Kosovës. Duke e parë suksesin e arritur me gjitha aktivitetet e realizuara gjatë 2.5 viteve të kaluara, Ministria e Punëve të Jashtme ka vendosur që të mbështesë realizimin e projektit edhe gjatë vitit 2012. Projekti i tillë do të shërbejë jo vetëm vazhimit të komunikimit, po edhe zhvillimit të kapaciteteve të ministrisë për diplomaci publike, avokimit të metutjeshëm në disa qendra evropiane, aktivitete të diplomacisë

kulturore, të diplomacisë civile, si dhe të realizohet bashkëpunim më i ngushtë me partner evropian të fushës.

Në vijim raporti përshkruan aktivitetet e realizuara:

Organizimi i vizitës nga Bosna dhe Hercegovina

Shteti i fundit i cili është adresu nga projekti Communicating with Europe me vizitë studimore është Bosna dhe Hercegovina, me të cilën po kompletohet spektri i mosnjohësve evropian dhe rajonal të shtetësisë së Kosovës. Për të përgatitur këte vizitë sa më mire, Fondacioni ka bashkëpunuar me organizaten Foreign Policy Initiative dhe drejtoreshën Denisa Sarajlic Maglic. Fillimisht është punuar studimi i pozitës së ketij shteti ndaj Kosovës, që flet për pozicionin në arenën ndërkombëtare, për njohjen e dokumenteve të Kosovës, migrimin nga Kosova drejtë ketij vendi, dhe shkëmbimet tregtare dhe humbjet. Ky punim do të jetë pjesë e publikimit më të madh të të gjitha pozicioneve individuale.

Perndryshe, në bashkëpunim me këtë think tank organizate, Fondacioni do të organizojë vizitë studimore për një delegacion të gjerë nga Bosna dhe Hercegovina për muajin Prill 2012, përbërja e të cilit do të reflektojë përbërjen e delegacioneve të deri tashme.

Bashkëpunimi me Këshillin Britanik

In the second half of the year, the British Council gjysmën e dyte të vitit, Këshilli Britanik i Kosovës, organizatë e themeluar dhe mbështetur nga qeveria britanike realizoi në bashkëpunim me Klubin për Politikë të Jashtme studime për pozitën e Spanjës, Greqisë, dhe të Qipros ndaj Kosovës. Në bazë të interesimit të përbashkët që të adresojnë problemin e qasjes që pesëshja evropiane po mban ndaj Kosovës, në Dhjetor 2011, Fondacioni lidhi marrëveshje mirëkuptimi me Këshillin Britanik për të publikuar të gjitha punimet në një botim të përbashkët dhe për të realizuar një konferencë promovuese në Kosovë e cila do të eksplorojë avancimin e me tutjeshëm të komunikimit ndërshoqëror e ndërkulturor. Keshtu botimi do të ketë punime për qëndrimin e Greqisë, Qipros, Rumanisë, Sllovakisë, Spanjës, Bosne dhe Hercegovinës, dhe Serbisë. Punimet do të publikohen në 3 gjuhë, shqip, serbisht, anglisht, në pronësi të të dy palëve. Konferenca e paraparë për Prill 2012 do të ftojë autorët në një sesion të pare që të prezantojnë punimet e tyre, elementet që e karakterizojnë pozicionin e shteteve të tyre, dhe të përshkruajnë dritaret e mundësive për të avancuar komunikimin dhe

zhvillimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe shteteve të adresuara. Konferenca do të ftojë zyrtarë të lartë të vendeve të adresuara, përfaqësues të lartë qeveritar e diplomatik, si dhe shoqërinë kosovare e palë të tjera me interes. Bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës

Sic është cekë me heret, sukcesi i projektit Të Komunikosh me Evropën nuk ka kaluar pa u verejtur edhe nga aktorët qeveritar kosovar. Si rezultat i gjithë aktiviteteve të realizuara dy viteve të fundit, Fondacioni tashmë ka filluar të njihet si organizata me e zëshme në promovimin e Kosovës tek shtetet mosnjohëse në BE dhe rajon. Aktivitetet e vendosjes së kanaleve komunikuese janë treguar shumë të dobishme për spektre të ndryshme të shoqërisë, përfshirë këtu edhe institucionet qeveritare. Prandaj në baze të ketij sukcesi, në Dhjetor 2011, Ministria e Punëve të Jashtme i ofroi një grant Fondacionit që të vazhdojë me realizimin e projektit edhe gjatë vitit 2012. Kjo marrëveshje do të i mundësojë Fondacionit që të zhvillojë kapacitetet njerëzore të Ministrisë në diplomaci publike me caktim të konsulencës adekuate dhe me aftësim akademik, të realizojë aktivitete të diplomacisë publike, tryeza të rrumbullakëta në disa kryeqytete evropiane, aktivitete të diplomacisë kulturore, diplomaci civile, vizita shkëmbyese, projekte bashkëpunimi me partner evropian, publikime të ndryshme, përfshi një edicion të veçantë të Magazinës Evropiane me temë në politikën e jashtme të Kosovës, etj.

Vizita e delegacionit rumun në Kosovë (tetor 2011)

Një delegacion prej 16 anëtarëve përbërë nga një senator, një kongresmen, gazetarë, studiues ballkani, dhe ekspertë të politikës së jashtme rumun, arritën në Prishtinë më 24 tetor për në vizitë dyditore vendit dhe institucioneve të Kosovës për të mësuar me shumë për procesin e ndërtimit të shtetit evropian në Kosovë. I realizuar në bashkëpunim me Qendrën Rumune për Politika Evropiane, kjo vizitë prezantoi të aritura të shumta në Kosovë duke tentuar gjithnjë të prezantojë imazh të ri të Kosovës dhe për të nxitur e krijuar kanale të reja komunikimi mes shoqërisë kosovare dhe asaj rumune. Programi i përgatitur enkas për këtë delegacion filloi me takimim me Petrit Selimin, Zëvendës Minister i Punëve të Jashtme të Kosovës i cili prezantoi një vështrim historik të raporteve mes Kosovës dhe Rumunisë dhe perspektivës evropiane për ringjalljen e tyre. Në takimim me Kryetarin e Parlamentit dhe deputetë të zgjedhur nga të gjitha partitë parlamentare u theksua roli i Parlamentit

në mbikqyrjen e zbatimit të ligjeve, përkushtimi i Kosovës për proceset integruese, ndërsa u prek poashtu edhe tema e veriut të Kosovës, të cilën Kryeparlamentari e sqaroi si shkak i mosveprimit të institucioneve lokale, rajonale, dhe ndërkombëtare e që ka rezultuar me mospranimin e popullatës serbe në atë zonë të sundimit të ligjit. Takimet e tjera secila veç e veç i shërbyen plotësisht të metutjeshëm me të dhëna për realitetin e Kosovës. Keshtu takimi me pjesëtarë të shoqërisë civile kosovare u perqëndrua në rolin e aktorëve të ndryshëm në shtetndërtimin e Kosovës; takimi me Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil prezantoi të arriturat në përmbushjen e planit të Ahtisaarit; takimi me përfaqësues joqeveritar serb prezantoi sfidat me të cilat ballafaqohet ky komunitet; takimi me përfaqësues diplomatik evropian në Kosovë analizoi qasjen e BE-së karshi Kosovës pasi u prezentua studimi i Forumit 2015 Zgjedhja e Evropës: Integro ose Stagno; përfaqësues të lartë prezentuan punën e zyrës së Komisionit Evropian dhe të EULEX-it, ndërsa takimi me mediat kosovare ishte takim i hapur në të cilin u dominoi informimi i grupeve minoritare në Kosovë.

Programi dyditor u përmbyll me një koktej rasti në të cilin ishin ftuar më se 200 mysafir nga spektre të ndryshme të jetës kosovare që të takojnë dhe bisedojnë me mysafirët rumun.

Pjesa e dytë e këtij projekti po vazhdon të implementohet nga partneri nga Romania, think tank organizata Romanian Center for European Policies. Në këtë fazë të dytë, kjo qendër po bashkëpunon me think tank organizatën CI-DOB nga Barcelona Spanjë, që të prodhojë një studime mbi do cilën qeveria rumune dhe ajo spanjolle do të rekomandohen se si të levizin nga pozita aktuale e mos-njohjes së Kosovës, drejtë një pozite konstruktive. Për këtë qëllim, dz analistet udhëheqës të këtyre organizatave kanë realizuar takime konsultative me palë me interes në kryeqendrat e tyre, në Prishtinë, Beograd, dhe Bruksel. Analiza do të i shërbejë disa tryezave të rrumbullakëta në keto kryeqendra, të parapara për Maj e Qershor 2012.

Punëtori me Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës (gusht 2011)

Përvoja që Fondacioni ka krijuar gjatë tri viteve të fundit duke u angazhuar në vendosjen e kanaleve të komunikimit me shtete të ndryshme ka filluar të çmohet në veçanti edhe nga institucionet shtetërore. Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga ka ftuar Fondacionin që të i ndihmojë këtij institucioni me për se afërmi në arritjen e qëllimeve të ngjashme. Gjatë një

punëtorie mbajtur me 23-26 gusht, 2011 në Vlorë, kabineti i presidentes së bashku me Fondacionin dhe Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile kanë diskutuar për qasjen që duhet marrë në menyrë që Kosova të i çmojë dhe perfitojë me shumë nga miqë të shumtë të saj ndërkombëtar.

Vizita e Delegacionit Kosovar në Bratisllavë (qershor, 2011)

Hapjen e kanaleve të komunikimit me shtetet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, Fondacioni i e nisi me organizimin e vizitës të një delegacioni në Sllovaki. Delegacioni i përbërë nga Veton Surroi, Luan Shllaku, Venera Hajrullahu, Ylli Hoxha, dhe Iliriana Kacaniku u takuan me një sërë aktorësh qeveritar dhe joqeveritar gjatë një qëndrimi njëditor në Bratisllavë. Edhe pse organizate nikoqire ishte Komisioni Atlantik i Sllovakisë, Ministria e Punëve të Jashtme ka qenë për se afërmi e angazhuar në organizimin dhe realizimin e kësaj vizite duke mundësuar kështu takimin me zyrtarë të lartë të këtij institucioni. Përveç tyre, delegacioni takoi z. Frantishek Shebej, kryesues i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, dhe z. Ivan Shtefanec, kryesues i Komisionit Parlamentar për Çështje Evropiane. Poashtu, takime u realizuan me figura tjera të shquara të jetës publike politike, gazetarë të mediave të ndryshme, përfaqësues të think tank organizatave me të mëdha, ndërsa në diskutimin publik u prezantua situata ekzistuese në Kosovë dhe u theksua nevoja për shkëmbim përvojash drejtë rrugëtimin evropian.

Vizitës në Sllovaki i parapriu hartimi i punimit, në të cilin është elaboruar pozicioni i Sllovakisë karshi Kosovës dhe ndërlidhja e tij me politikën e brendshme të kësaj anëtareje evropiane.

Vizita e Delegacionit Kosovar në Beograd (prill 2011)

Në kuadër të projekti Të Komunikosh me Evropën, vitin e kaluar Fondacioni ka organizuar disa vizita për delegacione nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian që nuk kanë njohur shtetësinë e Kosovës. Ndër delegacionet me të mëdha ka qenë ai nga Beogradi, me të cilën figura të shquara kanë vizituar Kosovën shumica për herë të parë. Grupi i përbërë nga intelektual, deputet, pjesëtarë të shoqërisë civile, gazetarë, ish-zëvendës ministra kanë qëndruar për dy ditë në Kosovë dhe kanë diskutuar me homolog të tyre në takime pune, tryezë të rrumbullakët, ligjëratë, etj. Në maj të këtij viti, një delegacion i ngjashëm u përpilua nga figura të shquara kosovare të cilët takuan homologe të tyre në Beograd, në

kuadër të iniciativës se investimit në dialogun civil me Kosovës dhe Serbisë. Vizita u organizua në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit për të Drejta të Njeriut në Serbi, dhe Fondacionin për Shoqëri të Hapur në Serbi ndërsa qëllimi kryesor i saj ishte të vazhdojë të investojë në dialogun mes shoqërive civile në të dy anët e kufirit drejtë krijimit të një marrëdhënie reciproke të besueshme mes dy shoqërive. Si pjesë e vizitës për delegacionin nga Kosova u organizuan konferenca me titullin Evropianizimi: Dialogu Civil mes Serbëve dhe Shqiptarëve, i cili konsistoi nga dy panele. Paneli i parë shqyrtoi temën Evropianizimi: Sundimi i Ligjit, Liria e Lëvizjes, Toleranca, dhe Bashkëpunimi, me panelistët: Jadranka Jelinić, Engjellushe Morina, Boško Jakšić, Agron Bajrami, Vukašin Obradović, dhe Ylli Hoxha. Paneli i dytë u përqëndrua në temën e kulturës. Në formë më specifike, ky panel shqyrtoi nëse Kultura mund të jetë katalizator i bashkëjetesës duke u përqëndruar në diversitetin kulturor, dialogun ndërkulturor, kulturën si element kryesor i marrëdhënieve bilaterale, duke i bërë nëpërmjet kësaj një ri-ekzaminim kritik të kaluarës. Pjesëmarrës në këtë panel ishin Milena Dragičević-Šević, Shkelzen Maliqi, Branimir Stojanović, Belul Beqaj, dhe Nenad Vasić. Në mbrëmje, në Qendrën për Dekontaminim Kulturor u promovua libri "Nga Prishtina me Dashuri," ndërsa në ditën e dytë u mbajtë një konferencë e përbashkët për shtyp për të gjithë pjesëmarrësit.

Tabela e granteve:

Hulumtim mbi marrëdhëniet Kosovë, BE, e Serbi	€ 8,600.00
Përgatitja dhe organizimi i vizitës së delegacionit Kosovar në Sllovaki	€ 14,040.00
Hapja e Kanaleve të komunikimit mes Kosovës dhe Sllovakisë e Bosnje dhe Hercegovines	€ 8,089.08
Dialogu Alternative Prishtinë-Beograd: Drejtë një Dialogu përmbajtësor Alternative Dialogues Belgrade-Prishtina: Towards a Substantive Dialogue on 'Technical Issues'	€ 8,000.00
Vizitë e Delegacionit Rumun në Prishtinë	€ 8,950.00
Pozicioni i Bosnjës dhe Hercegovinës ndaj Kosovës	€ 2,000.00
Paper On Position Of Bosnia And Hercegovina Towards Kosovo	€ 1,500.00
Përgatitja dhe organizimi i vizitës së delegacionit nga Bosna e Hercegovina në Kosovë	€ 23,820.00
Publikime	€ 15,725.62

Qëllimi 3: Të avokojë më tepër pranë Bashkimit Evropian që të përfshijë Kosovën në politikën e tij të rregulltë të zgjerimit

Zgjedhja e Evropës: Integro ose Stagno, Tetor 2012, Bruksel

Duke pasur parasysh se e ardhmja evropiane e Kosovës për vihet në pikëpyetje me dialogun aktual, Fondacioni ka realizu edhe një studim të tretë mbi këtë proces. Ky është studimi Zgjidhja e Evropës: Integro ose Stagno me të cilin Bashkimi Evropian alarmohet mbi rrezikun që mungesa e politikave të qarta ndaj Kosovës sjell për procesin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, po edhe për vetë kredibilitetin e BE-së ndaj Kosovarëve. Si asnjë vend tjetër i rajonit, Kosova ka nevojë për BE-në si partner dhe për procesin e përafrimit evropian si motor për reforma dhe zhvillim. Studimi jep nje pasqyrë efektive që mos-dhënia e udhërrëfyesit për viza dhe mos-ripërtimja e Masave Tregtare Autonome për Kosovën kanë në përafrimin e Kosovës ndaj BE-së dhe ngecjen e saj të edhe mëtutjeshme në proces të evropianizimit. Studimi poashtu i bën një vështrim kritik edhe qeverisë së Kosovës për të arriturat vetanake dhe mungesën e kapaciteteve për zbatim të disa obligimeve karshi këtij procesi, duke aplikuar fletënotimin me vlerë prej 1 deri ne 5.

Titulli i këtij studimi i shërbeu Forumit 2015 që të emëroj publikimin me tri studime të ngjashme e që theksojnë nevojën e politikës më të qartë të BE-së kundrejt Kosovës. Studimi i dytë është Të synosh Lartë: Vizioni Evropian për Dialogun mes Kosovës dhe Serbisë u publikua ne Mars 2011 me synim të terhejë vëmendjen e audien-cen kosovare dhe evropiane se dialogut të filluar

me Serbine i mungon vizioni i qartë evropian, dhe si i tillë vë në pikëpyetje perspektivën evropiane të Kosovës. Dokumenti i prezantuar propozon një zgjidhje me përfitime të përbashkëta për të gjitha palët në dialog, që nënkupton Bashkimin Evropian, Kosovë, dhe Serbi. Në esencë, mesazhi kryesor që dërgon ky dokument është se tri palët në bisedime do të nxjerrin përfitimet më

të medha nga procesi nëse ate e rrënjosin në procesin e avancimit drejtë anëtarësisë së plotë në Bashkimin Evropian.

Studimi i tretë është përfunduar dhe prezentuar në tetor 2010, Platforma për Procesin e Normalizimit të Marrëdhënieve mes Kosovës – BE-së—Serbisë edhe pse ne të është punuar për një periudhë të gjatë paraprake së bashku me përfaqësues qeveritar e diplomatik në Kosovë. Duke pasë parasysh thirrjen për dialog që kishte bërë Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe zhvillimeve politike ne ate drejtim, Fondacioni kishte filluar shumë herët bashkëpunimin me akterë politik me ndikim drejtë vendosjes së një platforme për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Prandaj, Forumi 2015 ka publikuar këtë trilogji studimet me të cilat alarmon se duke e shtyrë përafrimin për një të ardhme të pacaktuar, Evropa po e humb ndikimin shpejt dhe mund ta humbasë edhe Kosovën krejt.

Publikimi i shërbeu Forumit për të organizuar dy takime avokuese. E para u mbajtë në Bruksel, në bashkëpunim me European Policy Center me 18 tetor, 2011. Ky takim, i realizuar në formë të mbyllur, pa prezencë të gazetarëve, tërhoqi vëmendjen e zyrtarëve të lartë të Komisionit Evropian, Këshillit të Ministrave, ambasadave të vendosura në Bruksel dhe misionve të ndryshme ne BE, etj. Prezentimit të tij i parapriu edhe Deputetja e Parlamentit Evropian dhe raportuesja për Kosovë Ulrike Lunacek. Argumentet e prezentuara u plotësuan nga Blerim Shala, Venera Hajrullahu, e Luan Shllaku, të cilët Fondacioni i kishte ftuar për këtë qëllim. Poashtu diskutimit se BE-ja duhet të ketë politike shumë më të qartë ndaj Kosovës i kontribuoi dhe Ilir Dugolli, ambasador i Kosovës në Belgjikë, veçanërisht duke theksuar se opinioni këshillëdhënës i GJND-së do të duhej të i ndihmojë këtij qëllimi. Në këtë takim, tone inkurajuese erdhën nga Drejtorati i Përgjithshëm për Drejtësi dhe Punë të Brendshme duke marrë si shembull të arriturat e Kosovës për të përmbushur me iniciative vetanake kriteret e udhërrëfyesve rajonal për liberalizim të vizave. Prezentimi i dytë i studimit u mbajtë në Prishtinë para audiencës diplomatike në përbërje të ambasadorëve të Britanisë së Madhe, Italisë, Greqisë, Francës, Sllovakisë, dhe Rumunisë me 24 tetor, 2011.

Një Drejtim i Munguar: Platforma Evropiane Për Dialogun (17 Mars, 2011)

Kjo tryezë e rrumbullakët prezantoi dokumentin Të synosh Lartë: Vizioni Evropian për Dialogun

mes Kosovës dhe Serbisë, dhe synim kryesor ishte të tërhjekë vëmendjen e audiencën kosovare dhe evropiane të dialogut të filluar me Serbinë i mungon vizioni i qartë evropian, dhe si i tillë vë në pikëpyetje perspektivën evropiane të Kosovës. Dokumenti i prezentuar propozon një zgjidhje me përfitime të dyanshme për të gjitha palët në dialog, që nënkupton Bashkimin Evropian, Kosovë, dhe Serbi.

Inputi Për Raport Të Progresit

Si çdo vit më herët, edhe këtë vit Fondacioni ka dhënë kontributin e vet në hartimin e raportit të progresit të Komisionit Evropian. Temat e përgatitura dhe të prezentuara në Bruksel ishin: progresi i Kosovës në të drejtat e komuniteteve Roma, Ashkali, dhe Egjiptian, përgatitur nga Blerinda Idrizi, progresi në qeverisjen komunale dhe decentralizimi, përgatitur nga Leon Malazogu, dhe Politikat kundër korrupsionit dhe Ombudspersoni, përgatitur nga Eridana Çano.

Bridging Europe

Përpos këtyre raporteve individuale, Fondacioni ka mbështetur realizimin e disa studimeve analitike dhe monitoruese të realizuara nga organizata joqeveritare të Kosoves. Në maj 2011, Fondacioni shpalli konkurs me të cilin I ftoi organizata joqeveritare kosovare të aplikojnë me projekt propozime të cilat do a) të i kontribuojnë evropianizimit të politik-bërjes nëpërmjet dialogut të përqendruar, mire të informuar, dhe të vazhdueshëm me strukturat vendim-marrëse; b) të avancojnë dialogun civil – atë në mes të strukturave qeveritare dhe shoqërisë civile – në përmirësimin e qeverisjes dhe proceseve integruese duke e bërë atë më përgjegjës dhe transparent ndaj votuesve dhe tatim-paguesve kosovar; c) të zhvillojnë dhe promovojnë bashkëpunim me qeveritë komunale në avancimin e qeverisjes në nivel komunal; dhe ç) të ndihmojnë rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me organizatat në rajon dhe në Bashkimin Evropian drejtë shkëmbimit të përvojës dhe mekanizmave avokues. Pas procesit vlerësues, komisioni I programit vlerësoi pozitivisht realizimin e këtyre projekteve:

Monitorimi i të arriturave komunale për zbatim të strategjive për reintegrimin e kosovarëve të riatdhsuar, analizimi i veprimeve qeveritare në disa kritika madhore të raportit të progoresit, studimi i premtimeve të realizuara nga konsociumi turko-francez që mori Aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës me koncesion, vlerësim analitik mbi shkallën e implementimit të Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis dhe Ligjit për Vlerësim

Strategjik Mjedisor, mbështetje gazetarisë hulumtues që të hetojë e të publikojë shkrime të vayhdueshme për progresin e Kosovës në integrimin evropian, si dhe monitorimi dhe avokimi për realizim e së drejtës në informacion dhe qasje në dokumente publike janë disa prej çështjeve që janë mbështetur me grantet e realizuara në kuadër të projektit operacional Bridging Europe, e që është dizajnuar pikërisht për të ngritur ndikimin e shoqërisë civile kosovare në proceset integruese.

Çfarë vlen të theksohet për këtë vit është fakti se programi për integrim evropian ka mbështetur dy organizata lokale serbe për të realizuar projekte hulumtuese me karakter të integritit evropian. Nje çasje e tillë sinjalizon një ndryshim në çasje të së paku shoqërisë civile të komunitetit serb ndaj zhvillimeve në Kosovë viteve të fundit dhe nje hap të metutjeshëm në integrimin e ketij grupi në shoqërinë e gjerë kosovare

Grantist	Titulli I projektit	Vlera e grantit
Blerinda Idrizi	hartimi I inputit per raport te progresit	€ 300.00
Leon Malazogu	hartimi dhe prezentimi I inputit per raport te progresit	€ 600.00
Eridana Çano	hartimi dhe prezentimi I inputit per raport te progresit	€ 600.00
Çelnaja	Liberalizimi I vizave - venia e kosovareve jashtë getos	€ 10,000.00
Atlantic Forum	European Young Leaders' Forum	€ 3,000.00
Regional Environmental Center	Vlerësim analitik mbi shkallën e implementimit të Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis dhe Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor	€ 9,980.00
Kosovo Public Policy Center	Managing Diversity in the Post-Conflict Western Balkans: Multiculturalism, Multiethnicity, and Europeanization	€ 4,000.00
Infoglobi	Hulumtimi dhe publikimi i "Speciales" për kriteret për anëtarësim në Bashkimin Evropian" shoqëruar me një vështrim analitik të dështimeve dhe sukseseve në rastin e Kosovës	€ 2,000.00
Balkan Investigative Reporting Network	Gazetari Hulumtues mbi integrimin evropian dhe transparencën	€ 9,980.00
Klubi per Politike te Jashtme	Tracking the European Commission Progress Report	€ 10,000.00
DNG Solution	Integrimi Evropian – Prioritet per Komunitetet Serb apo Jo	€ 9,970.00
3E Institut	Politika te qëndrueshme mjedisore per komunën e Graçanicës	€ 8,200.00
American University in Kosovo	The AUK Summer Program 2011, "Peace-building, Post-conflict Transformation and Development"	€ 8,500.00
Evliana Berani	Hulumtimi dhe publikimi i "Speciales" për kriteret për anëtarësim në Bashkimin Evropian" shoqëruar me një vështrim analitik të dështimeve dhe sukseseve në rastin e Kosovës	€ 12,860.00
Arben Zharku	Mbeshtetje dialogut multikulturor	€ 7,000.00
Augustin Palokaj	Organizimi I Vizites Studimore në Bruksel	€ 1,500.00
	Shpenzime tjera operacionale	€ 7,090.72

Qëllimi 4: Të ngrisë efqiencën e administratës Kosovare karshi reformave dhe procesit integruar

Capacity Development Facility

Projekti CDF tashmë ka hyrë në vitin e tetë të tij dhe vazhdon të jetë një ndër projektet me efektive në aftësimin e vazhdueshëm të shërbimit civil të Kosovës po poashtu edhe të mbështetjes së nivelit politik të administratës me ekspertizë adekuate. Projekti vazhdon të punojë në bazë të kërkesave dhe prioritetve të identifikuar nga institucionet qeveritare të Kosovës, dhe gjatë vitit që lamë pase ka realizu më se 80 këshillime, apo afër 500 muaj konsulencë për ekzekutivin dhe legjislativin e shtetit.

Një numër i konsiderueshem i vlerësimeve pozitive në raportin e fundit të progresit, të Komisionit Evropian i referohen proceseve të cilat në një formë apo tjetrën kanë qenë të mbështetura nga këshilltarë të projektit CDF. Këtu përfshihet marrëveshja për bashkëpunim juridik, fushata e agjencionit kundër korrupsionit, etj, ndërsa ndër të arriturat specifike të projektit renditen:

- Hartimi i dokumentit "Teknikat për Hartimin e Akteve Ligjore per Komuna" dhe pregaditja e dokumentit shpjegues per nëpunësit civil komunal të zgjedhur si anëtarë te Kuvendit te Kosoves;
- Hartimi i Rregullores per Periudhen Provuese per Nepunesit Civil si dhe Rregullores per nderprerje, suspendim dhe perfundim te kontrates per nenpunesit civil;
- Hartimi I dokumentit "Udhezuesi per Hartimin e Programeve Banesore per Komunat: bazuar ne ligjin no. 03/L-164
- Hartimi I dokumentit "Rregullat e Mbrendshme dhe Sistematizimi I pozitive ne MeF" ;
- Hartimi I tre Urdheresave Administrative per zbatim te Ligji per Ekspropriim no. 03/I-13; i) UA per miratimin e metodologjise dhe kriterëve teknike per përcaktimin e kostos dhe vleresimit te demit per pronen e paluajtshme; ii) Vendimi (propozim) "Per procedurat dhe afatet kohore per komunikim mes autoriteteve publike gjate procesit te expropriimit te promes te paluajtshme"; iii) Vendim (propozim) "Per miratimin e modelit te vleresimit nga Zyra per Vleresimin e prones te paluajtshme ne Departamentin e Tatimit ne Prone gjate procesit te expropriimit"
- Perkraheje per zbatimin e "Planit te Veprimit per Fuqizimin Ekonomik te Grave ne Kosove 2011-2013" (e hartuar nga keshilltarja e CDF Projektit ne vitin 2010);

- Perkraheje per permiresimin e mekanizmave institucional nme nivel qendror dhe komunal qe perkrahin zbatimin e Planit te Veprimit
- Perkraheje Departamentit Ligjor ne finalizimin e Kodit Penal
- Perkraheje per Departamentin per Integrim Evropian dhe Koordinim te Politikave ne hartimin e IPA projekteve
- Perkraheje Departamentit te Rinise ne i)zbatimin e ligjit ne nivel komunal ; ii) konstituimi i Qendrave te Rinise, Keshilleve Rinore Komunale ; iii) Hartimi i Planit Komunal per Rini
- Pregaditja e Raportit Vleresues per funksionimin e strukturave qendrore institucionale pergjegjese per integrimin ne EU;
- Pregaditja e Raportit Vleresues per perfshirjen e stukturave komunale ne procesin e integrimit Evropian si dhe pregaditja e ToRs per pozitat "Zyrtar per Integrim ne nivel komunal"

Mbështetja zhvillimit komunal qe i është ofruar komunave, është rritur ne krahasim me vitet e mëparshme. Vitin e kaluar projekti ka mblshetur tri komuna ne zhvillim kapacitetetesh, përfshirë ketu Prishtinën, Junikun, Pejën, dhe Shtërpcen. Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Junikut janë mbështet nga projekti CDF me sigurim të këshilltarëve për zhvillim të kapaciteteve. E para është ndihmuar në zhvillimin e politikave për partneritet publiko privat dhe për politikën e sigurisë. Komuna e Junikut, si komunë e re e krijuar me procesin e decentralizimit në Kosovë është mbështetur për hartim të planit për zhvillim ekonomik. Komuna e Pejës është mbështetë ne konsolidimin e komunikimit me qytetarë me qëllim të prezentimit transparent të aktiviteteve të komunës. Ndërsa komuna e Shtërpcështe ndihmuar në finalizimin dhe miratimin e Planit per Qendren e re te skijatoreve.

Përndryshe gjatë vitit që shkoi projekti CDF ka kaluar nëpër tri rishikime për të vlerësuar përmblshjen e qëllimit të tij dhe identifikuar nevojën për pershtatje rrethanave të reja në të cilat funksionon administrata kosovare. Rishikimi i parë u mbajt në korrik 2011 në mes të partnerëve të projektit dhe një grupi të këshilltarëve të zgjedhur me objektivin që të: a) të mësojë nga përvoja e drejtëpërdrejtë, mësimet e nxjerra, dhe njohuritë e këshilltarëve të projektit për zbatimin e projektit në mënyrë që të informojë formulimin e fazave të ardhme të projektit për zbatim në nivel qendror dhe komunalë b) të kuptojë më për së afërmi çështjet të cilat sfidojnë përmblshjen e detyrave të tyre dhe të angazhimit efektiv mes këshilltarëve dhe klientëve qeveritarë; dhe të krijojë mundësi që Fondacioni, UNDP, dhe këshilltarët të eksplorojnë mundësi apo formate

të reja për projektin në të ardhmen. Duke u bazuar në vlerësimet e projektit të bëra gjatë vitit 2010, një punëtori e tillë u shërbeu partnerëve të kuptojnë më mire "vlerën e shtuar të projektit" dhe elementet të cilat e bëjnë projektin të vlefshëm për ndryshimet të cilat synon të i arrijë, të kuptojnë aspektet të cilat kanë nevojë për përmirësim, dhe të pozicionojë projektin karshi donatorëve dhe qeverisë. Nga kjo punëtori dolën një sërë rekomandimesh mbi ngritjen e vlerës se metutjeshme të projektit duke përdorur mekanizmat e tij eksistues, si psh, të organizohen takime të rregulta formale dhe joformale mes klientë dhe këshilltarë, të u ofrohet këshilltarëve orientim në këshillim dhe mentorim të cilët kanë ekspertizën teknike po jo edhe përgatitje formale në konceptet dhe praktikën e transferit të njohurive, ndërtimi i sinergjisë mes këshilltarëve të projektit, etj.

Për të dokumentuar më mirë të gjitha këto rekomandime dhe zhvillimin e projektit që nga themelimi, Fondacioni angazhoi ekspertë të jashtëm që të i bëjnë projektin një rishikim kualitativ, duke u përqëndruar në të arriturat e tij. Dokumenti i gjeneruar nga ky proces gjendet në Annexin 1.

Punëtorja e dytë, përpos partnerëve dhe këshilltarëve, ftoi dhe përfituesit e projektit dhe se bashku u vlerësuan të arriturat e projektit, nevojat e administratës publike në Kosovë për të identifikuar prioritetet në të cilat do të duhej të përqëndrohej projekti në fazën e rradhës. Në esencë, kjo punëtori eksploroj nevojën për zhvillim të qëndrueshëm të kapaciteteve, vlerësoi të arriturat e projektit nga këndvështrimi i përfituesve, dhe diskutoi prioritetet qeveritare në mënyrë që efekti i projektit të rritet duke iu përshatur këtyre nevojave. Këtë punëtori e kryesuan Fondacioni dhe UNDP, ndërsa u kryesua nga zëvendëskryeministri Hajredin Kuqi. Në punëtori morën pjesë me se 60 pjesëmarrës, përfshirë përfaqësues të Ministrisë për Integritet Evropian, Ministrisë së financave, Agjencionit Anti-korrupsion, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe përfaqësues nga UNDP në Bratisllavë. Nga diskutimet e realizuara doli se Qeveria e Kosovës ende ka nevojë për mbështetje të projektit, që do të përfitoj nga një partneritet i drejtëpërdrejtë me qeverinë, e poashtu edhe nga mbështetja e drejtëpërdrejtë financiare nga Qeveria, e kombinuar me mbështetje të donatorëve të ndryshëm.

Aktiviteti I tretë ishte konferenca me përfaqësues të lartë të Qeverisë, përfaqësuesve diplomatik, dhe donatorë në Kosovë. E kryesuar nga Zëvendëskryeministri, kjo konferencë u hap me prezentimet e partnerëve në të arriturat e

projektit. Esenca e këtij diskutimi ishte se nevoja për zhvillim të kapaciteteve është e theksuar në raportin e fundit të progresit dhe në deklaratat e qeverisë, e poashtu shërbimi civil profesional përbën kurrizin e zhvillimit të një shoqërie. Nga kjo konferencë u konkludua se projekti duhet të vazhdojë me aspektin e tij pozitiv, të jetë i udhëhequr nga kërkesat dhe nevojat e shërbimit civil, të zhvillohet një kornizë e fortë monitorimi dhe vlerësimi, etj si dhe të zhvillojë strategji të qarta të daljes.

Nga të gjitha këto aktivitete, partnerët kanë vendosur se në fazën e ardhme, projekti duhet të përqëndrohet në zhvillimin e kapaciteteve të shërbimit civil në katër fusha prioritare, dhe atë, integritet evropian, sundim i ligjit, zhvillim ekonomik, dhe integritet të minoriteteve.

Përndryshe, vitin që shkoi, projekti ka mbështetur këto departamente e ministri në zhvillim të kapaciteteve:

Këshilltar	Përfituesi qeveritar	Vlera e grantit
Agon Demjaha	MEM, Sekretari permanent	€ 18,100.00
Illir Kanina	MEF, Dept. Adminisitrates qendrore	€ 18,200.00
Jordan Daci	MMPH, Dprt I Banimit dhe Ndertimit	€ 15,800.00
Nagip Skenderi	MEF, Dprt I Makroekonomise	€ 10,889.04
Ardian Zajmi	MPA, Departamenti TI	€ 15,000.00
Xhevat Lushi	Ministria e Bujqesise	€ 10,152.18
Haki Merovci	Zyra e Kryeministrit	€ 10,889.04
Valentina Hoxha	MAP/Departamenti I Administrates se Sherbimit Civil	€ 18,200.00
Visar Morina	Agjensioni per Mbrojtjen e Mjedisit te Kosoves	€ 7,941.72
Driart Elshani	ZKM/Divizioni i IT	€ 7,200.00
Eridana Cano	Instituti i Avokatit te Popullit	€ 15,150.00
Edon Miftari	Komuna e Prishtines	€ 9,415.44
Syle Sefaj	MPB/Departamenti per Atdhesim, Riintegrim	€ 10,152.18
Flutra Gërmizaj	MPMS/Departamenti I Mireqenies Social	€ 5,731.92
Florent Bakija	MTI/Kabineti I Ministres	€ 9,415.44
Asdren Osaj	Komuna e Prishtines	€ 8,678.58
Ertjan Çabiri	MZhE/Sekretari I Perhershëm	€ 13,200.00
Drini Çano	MF/Departamentit I Tatimit ne Prone	€ 13,200.00
Fadil Miftari	Agjensioni Anti-korrupsion	€ 10,889.04
Besnik Vasolli	MPB/Zyra e Sekretarit te Perhershëm	€ 10,889.04
Valon Gërmizaj	Keshilli Kosovar per Trashigemi Kulturore	€ 12,000.00
Arta Balaj	MBPZhr/ Kabineti I Ministrit	€ 10,152.18
Avni Arifi	Komisioni Parlamentar per Pune te Brendshëm, Siguri dhe Mbikeqyrje te Forces se Sigurise	€ 10,152.18
Ibrahim Kryeziu	Komuna e Junikut	€ 9,415.44
Jeton Rexha	MAPL/Kabineti I Ministrit	€ 10,152.18
Arban Abrashi	Komisioni Parlamentar per Integritim Evropiane	€ 8,678.58
Arben Lila	Keshilli Prokurorial I Kosoves	€ 10,889.04
Donike Qerimi	MD/Kabinati I Ministrit	€ 7,204.80
Illir Shala	Kabineti I Zevendes Kryeministrit	€ 13,800.00
Dukagjin Gorani	Kabineti I Kryeministrit	€ 13,099.62
Sladjan Ilic	Komuna e Shterpces	€ 10,889.04
Blerinda Idrizi	Agjensioni per Barazi Gjinore	€ 20,000.00
Mirela Savic	Kabineti I Ministrit/MKK	€ 13,200.00
Nuredin Ibishi	Komisioni Parlamentar per te Drejtat e Njeriut	€ 10,889.04

Abit Hoxha	Kabineti I Ministrit/MPB	€ 9,415.44
Sali Kelmendi	Komuna e Pejës	€ 10,889.04
Aferdita Maliqi	MESH/T/Kabineti I Ministrit	€ 7,204.80
Illir Kanina	MEF, Dept. Administratës qendrore	€ 18,000.00
Agon Demjaha	Ministria e Punëve të Brendshme	€ 18,100.00
Enton Elezi	Zyra e Sekretarit të Përhershëm/MAPL	€ 15,600.00
Marta Gazideda	CDF Executive Office	€ 14,000.00
Haki Merovci	Zyra e Kryeministrit	€ 10,889.04
Mihajlo Dekic	MAPL/Kabineti I Ministrit	€ 7,941.72
Ardijan Zajmi	MPA, Departamenti TI	€ 10,869.52
Brikena Hoxha	Konisioni Parlamentar për Tërkëmbje, Industri, Ekonomi, Infrastruktura	€ 17,300.00
Sabahate Grajcevcic	Grupi I Grave Deputete	€ 10,889.04
Eleonora Kelmendi	CDF Executive Office	€ 8,310.06
Jehona Lushaku	Kabineti i Ministrit/MDrejtësisë	€ 10,889.04
Muharrem Nitaj	Kabineti i Ministrit/MDiasporës	€ 10,889.04
Syle Sefaj	MPB/Departamenti për Atdhësim, Riintegrim	€ 10,152.18
Edon Miftari	Komuna e Prishtinës	€ 9,415.44
Asderi Osaj	Komuna e Prishtinës	€ 8,460.15
Myesere Hoxha-Lamaxhema	KIPA	€ 8,460.15
Ertjan Cabiri	MZHE/Sekretari i Përhershëm	€ 11,000.00
Drini Cano	MF/Departamenti i Tatimit në Prone	€ 11,000.00
Gezim Kolgeci	Gjykata Supreme	€ 10,889.04
Afrim Haliti	Kabineti I Ministrit/MFSK	€ 12,000.00
Besa Kabashi	Kabineti I Ministrit/MFSK	€ 7,846.20
Fadil Miftari	Agjensioni Anti-korrupsion	€ 7,259.36
Valentina Hoxha	MAP/Departamenti i Administratës së Sherbimit Civil	€ 12,000.00
Avni Arifi	Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbrojtje të Forcës së Sigurisë	€ 10,152.18
Afrim Hoti	Komisioni Parlamentar për Edukim, Rinë, Sport, Administratë Publike dhe Media	€ 6,276.96
Valon Germizaj	Keshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	€ 8,000.00
Arta Balaj	MBPZHR/ Kabineti I Ministrit	€ 10,152.18
Ibrahim Kryeziu	Komuna e Junikut	€ 9,415.44
Arben Lila	Keshilli Prokurorial i Kosovës	€ 5,444.52

Donike Qerimi	MD/Kabinati I Ministrit	€ 7,204.80
Sladjan Ilic	Komuna e Shterpces	€ 10,889.04
Blerinda Idrizi	Agjencia për Barayi Gjinore	€ 18,000.00
Mirela Savic	Kabineti I Ministrit/MKK	€ 13,200.00
Nuredin Ibishi	Komisioni Parlamentar per te Drejtat e Njeriut	€ 10,889.04
Sali Kelmendi	Komuna e Pejes	€ 7,259.36
Aferdita Maliqi	MESHt/Kabineti I Ministrit	€ 4,803.20
Agon Demjaha	Ministria e Puneve te Brendshem	€ 15,100.00
Sonja Skarep	ZKM/Zyra e Komuniteteve dhe Kthimit	€ 7,090.80
Gent Salihu	Zyra e Presidentes	€ 10,889.04

Shkolla Për Integritime Evropiane

Që nga inicimi i saj në vjeshtë të vitit 2005 deri në fund të vitit 2011 Shkolla për Integritim Evropian ka arsimuar 13 gjenerata kosovarësh të cilët njohurit e marra mbi Bashkimin Evropian, institucionet e politikave të saj, dhe procesin integruar të Kosovës i kanë përcjellë tutje tek vendet dhe proceset e tyre të punës. Gjatë vitit të kaluar 120 Zyrtar qeveritar, shërbyes civil, shërbyes të policisë së Kosovës e të doganave, gazetarë, aktivist të shoqërisë civile, dhe vijues nga sektori privat kanë shtuar numrin e alumnive të shkollës në rreth 800.

Edhe me këto dy gjenerata Shkolla Evropiane është angazhuar që a) të promovojë idetë dhe vlerat evropiane në shoqërinë kosovare, b) të sigurojë arsimin evropian të kualitetit të lartë për zyrtarë qeveritar, udhëheqës të shoqërisë civile, të komuniteteve, dhe bizneseve, medieve, dhe të tjerëve, c) të krijojë masë kritike për të ndihmuar dhe për t'u angazhuar në proceset integruar të Kosovës, d) të nxisë dialog brenda komunitetit kosovar për adresim më përmbajtësor të nevojave të Kosovës dhe rajonit në kuadër të proceseve integruar, e) të nxisë dialogje dhe bashkëpunim rajonal, dhe ë) të krijojë rrjet të ish-vijuesve të shkollës.

Për të përmbushur keto objektiva, Programi për integritim evropian ka angazhuar ligjvues të shquar, qoftë nga akademja, qoftë nga sfera politike e praktike, të cilët në më se 35 orë akademike secilës gjeneratë i kanë përcjellë njohuritë e tyre të veçanta për një spektër të Bashkimit Evropian. Programi për të dy gjeneratat e fundit është organizuar në module specifike, duke fillu me historikun e themelimit dhe

zhvillimit të Bashkimit Evropian, për të vazhduar me kornizën ligjore të BE-së, politikave dhe proceset politik-bërëse të BE-së, BE-ja si aktor global, dhe politika e zgjerimit.

Moduli i parë u është prezantuar vijuesve gjatë punëtorisë dy-ditore në fillim të secilës shkollës. Ligjëratat mbi historikun e BE-së, strukturën institucionale, proceset vendimmarrëse, dhe politikave kryesore u janë mbajtur vijuesve nga z. Ditmir Bushati. Ligjëratat nga pjesa tjetër e programit u vazhduan në qendrën informative kulturore të Bashkimit Evropian, të cilën e operon Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, përndryshe partner i Fondacionit në këtë projekt. Temat nga programi i rregullt janë ligjëruar nga Hajredin Kuqi, Zëvendës Kryeministër, Elie Muir, ligjëruar në Universitetin e Mastroiut, Laurent Van De Poele, Universitetit Katolik i Leuven-it, Augustin Palokaj, korrespondent nga Brukseli, e Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, përfshirë edhe Luan Shllakun, drejtor ekzekutiv i Fondacionit. Edhe në dy gjeneratat e kaluara vijuesit kanë vlerësuar secilën ligjëratë për ligjëruar, përmbajtjen, dhe efektivitetin e ligjërit, që njëherit po shërben edhe si mekanizëm i vazhdueshëm vlerësimi për vetë projektin.

Që nga viti 2010, procesit teorik të nxënjes së njohurive i kontribuon edhe ushtrimi praktik në forme të simulimit. Qëllimi i simulimit është që pjesëmarrësit të afrohen me procesin e vendim-marrjes në Këshillin e Ministrave të BE-së, duke marrë rolin e shtetit anëtar dhe duke përfaqësuar interesat kombëtare në çështje specifike. Dy gjeneratat e fundit u është dhënë rasti i Turqisë dhe kërkesa e saj për përshejtim të negociatave për anëtarësim në BE.

Për të marrë pjesë në simulim, pjesëmarrësit që nga fillimi ndahen në ekipe të cilat përfaqësojnë shtetet anëtare, Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian, dhe presidencën. Simulimi ka tri runde të diskutimeve, gjatë të cilave të gjithë pjesëmarrësit prezantojnë pozicionet e tyre me shkrim në jo me shumë se një faqe, ndërsa në simulimin e fundit, ato diskutojnë dhe vendosim nëse kërkesa duhet pranuar apo jo. Pjesëmarrja në simulim, prezentimi dhe argumentimi vlerësohen nga organizatorët, ndërsa rezultatet kombinohen me rezultatet e dy testeve për vlerësimin final të pjesëmarrësve.

Programi i dy gjeneratave të kaluara është përforcuar dhe me vizitë studimore. Pasi seminari përmblylës tradicionalisht mbahet në Durrës, në vitin e kaluar janë organizuar dhe vizita institucioneve shtetërore të Shqipërisë, si Ministrisë për Integrim Evropian, Parlamentit, e poashtu edhe organizatave të shoqërisë civile aktive në çështje të proceseve evropianzuese në Shqipëri, si Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Poashtu, gjenerata e fundit mori pjesë edhe në konferencën "1 vit nga Liberalizimi i vizave – Eksperienca e Shqipërisë," e cila ishte organizuar nga Lëvizja Evropian e Shqipërisë.

Të gjitha aktivitetet e realizuar në kuadër të Shkollës Evropian tregojnë qartë se programi i saj është zhvulluar dukshëm që nga themelimi i projektit në vjeshtë të vitit 2005. Procesi i transferimit të njohurive dhe praktikave evropiane tek kosovarët e angazhuar qoftë në institucionet shtetërore, organizatat qeveritare, mediat, apo bizneset gjithnjë e më tepër po bëhet interaktiv duke siguruar se nxënja e njohurive po bëhet e qëndrueshme dhe e aplikueshme në jetën e përditshme profesionale.

Risia e dytë e projektit e realizuar për herë të parë vitin e kaluar, ishte vizita studimore institucioneve të BE-së në Bruksel. Në fund të vitit, organizatorët përzgjedhën 10 vijuesit më të suksesshëm të të dy gjeneratave, në bazë të performancës së tyre gjatë gjithë programit të përgatitur. Dhjetë vijuesit e shkollës kaluan tri ditë në Bruksel gjatë javës së fundit të Janarit 2012, gjatë të cilave vizituan institucionet kryesore të Bashkimit Evropian dhe u takuan me deputetët e Parlamentit Evropian, Eduard Kukan, Tanja Fajon, dhe Ulrike Lunacek, tre përfaqësues të Komisionit Evropian të cilët punojnë për Kosovën, zëdhënësen Maja Kocijancic të Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian Baroneshës Catherine Ashton. Vijuesit poashtu vizituan think tank organizatën European Policy Center, u takuan dhe diskutuan me korrespondentët kryesor kosovarë Augustin Palokaj dhe Gjeraqina Tuhina, ndërsa takimi më i preferuar për të gjithë ishte vizita ambasadës së Republikës së Kosovës në

Belgjikë dhe bisedimi me Ambasadorin Ilir Dugollin.

Risia e rradhës e sjellë në Shkollën për Integrim Evropian vitin e kaluar është vlerësimi i jashtëm. Pas realizimit të 13 gjeneratave, Fondacioni ka vendosur të vlerësoj se çfarë ndikimi ka pasë projekti, sa ka ndihmuar avancimin e proceseve, dhe si u ka ndihmuar vijuesve që të shtyjnë këto procese nga vendet e tyre të punës. Vlerësimin e shkollës është duke e realizuar kompania private e konsulencës IQ Consulting, ndërsa rezultatet e para priten në fund të muajit Shkurt 2012

Magazina Evropiane

Në vitin 2010 programi për Integrim Evropian filloi me publikimin e magazinës periodike të quajtur Magazina Evropiane. E dizajnuar që të shpërndajë njohuri specifike evropiane para një audience të gjerë kosovare, Magazina ka sjellë artikuj të shumtë analitik e informativ në politika të rëndësishme për zhvillimin në Kosovë. Çak i Magazinës Evropiane, projektit më të ri të Fondacionit, janë zyrtarët qeveritarë të cilët ballafaqohen çdo ditë me sfidat e integritit. Temat të cilave u përkushtohet secili numër i veçantë mbështeten në nevojat më urgjente por njëkohësisht jo mjaft të adresuara nga aktorë qeveritarë e jo-qeveritarë. Ndërsa përgjegjësia elementare e shoqërisë civile karshi procesit integruar mbetet monitorimi i vazhdueshëm i përparimit të përmbushjes së prioriteteve evropiane.

Vitin që shkoi, programi botoi tre numra të Magazinës Evropiane. Numri i parë, apo i katërti i rradhës, iu dedikua çështjeve të mjedisit, ndërsa numri i pestë iu dedikua çështjeve të komuniteteve Roma, Ashkali, dhe Egjiptas. Për këtë numër Fondacioni ka identifikuar ekspertë të shquar që të ndajnë ekspertizën dhe eksperiencën e tyre në adresimin e çështjeve rrome në Europë dhe atyre që ndërlidhen posaqërisht me komunitetet RAE në Kosovë. Kjo Magazinë ka sjellë artikuj të ndryshëm që sjellin informacion por edhe gjykim kritik për këto procese. Posaqërisht shpalosin opcionet që e kanë burimin në politikat evropiane dhe rezultatet e marrëveshjeve që autoritetet kosovare i kanë bërë lidhur me riatdhesimin e personave që nuk kanë leje qëndrimi në vendet e europës perendimore, kryesishtantare të BE. Poashtu, janë adresuar edhe dy procese që e shënojnë dukshëm diskursin aktual, dhe njëkohësisht janë shansë për integrim të suksesshëm. Në planin ndërkombëtar është Dekada e Romëve dhe në planin kombëtar është Strategjia për Integrimin e Komuniteteve RAE në Kosovë.

Numri i pestë i Magazinës iu dedikua çështjeve të mjedisit për të nxitur me tutje debat publik me këtë temë i cili mungon tash sa kohë. Ky edicion i magazines sjelli artikuj për mjedisin në Kosovë, për ndotjen e ajrit, për dhjetë testet e presidencës hungareze të BE-së, direktivën mbi transportimin e ujit, ndotjen e mjedisit nga linjiti, mbrojtjen e qyteteve, si dhe mbi biodiversitetin. Expertë mjedisor nga Kosova dhe jashtë i kontribuan ketij numri me shkrimet e tyre.

Kah fundi i vitit, programi filloi përgatitjet për edicionin në temën zhvillimi urban, e cila pritet të publikohet në fund të muajit Shkurt 2012. Ky edicion do të merret me planifikimin dhe zhvillimet hapësinore urbane, në nivelin lokal dhe rajonal. Me këtë edicion të gjashtë tentohet të kontribuohet në ngritjen e vetëdijes së opinionit të gjerë në tërë këto koncepte shumë të rëndësishme për planerët gjithandej botës, porse shumë pak të njohura për opinionin e gjerë profesional kosovar. Kjo posaçërisht është shumë e rëndësishme kur kemi të bëjmë me integrimet evropiane dhe ndikimin e së planifikuarës për një zhvillim të qëndrueshëm të një hapësire, zhvillimit ekonomik, mjedisor dhe social.

Të dy numrat janë publikuar në shqip, anglisht, dhe serbisht, ndërsa numri për komunitetin RAE është publikuar dhe në gjuhën romë. Të gjitha edicionet e Magazinës u janë shpërndarë institucioneve shtetërore, përfaqësuesve diplomatik, organizatave ndërkombëtare, dhe shoqërisë civile, derisa njëkohësisht janë publikuar dhe në webfaqen e Fondacionit. Deri më tani, Magazina Evropiane ka adresuar keto çështje: energjia, liberalizimi i vizave, bujqësia, mjedisi, roma, dhe planifikimi urban.

Aktiviteti	Grantist	Shuma e grantit
Koordinimi i Magazinës Evropiane	Elvida Pallaska	€ 1,842.11
Magazina Evropiane – Roma	Operacionale	€ 19,027.88
Magazina Evropiane – Zhvillimi Urban	Environmentalists without Borders	€ 10,000

Mbështetje politikave evropianizuese në administratën lokale

Objektivi i fundit strategjik i programit për periudhën 2011-2012 është të mbështesë organizata joqeveritare që të ndihmojnë evropianizimin e administratës qoftë në nivel lokal apo komunal duke monitoruar apo analizuar praktikat qeverisëse, dhe avokuar llogaridhënie nga organet e zgjedhura me vote direkte, përfshirë ketu kryetarë dhe asamblatë komunale.

Një sërë organizatash janë mbështetë në realizim të projekteve synimet e të cilave ndihmuan përbushjen e ketij objekti:

Sa i përket projekteve monitoruese, programi ka mbështetur organizatën INPO që të monitorojë Komunën e Prishtinës. Në bashkëpunim me programin për shoqëri civile, kjo organizatë ka realizuar monitorim një vjeçar të drejtëpërdrejtë të punës së Kuvendit Komunal dhe trupave të tij, dhe ekzekutivit të Komunës.

Organizata	Projekti	Shuma e grantit
Iniciativa për Progres	Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në Komunën e Prishtinës	€ 9,930.00
FOL	Fole te Verteten	€ 10,000.00
Balkan Policy Institute	Hulumtim mbi efektin ekonomik të privatizimit të aeroportit	€ 10,000.00
Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë	Vlerësimi i sfidave të Kosovës për të ju bashkangjitur programit të NATO-s "Partneritet për Paqe"	€ 8,726.00
Qendra për Politikë dhe Avokim	Monitorimi dhe avokimi për realizim të së drejtës në informacion dhe qasje në dokumente publike	€ 9,980.00



#3 [Programi i Minoriteteve dhe Roma]

#3 Programi i Minoriteteve dhe Roma

Programi i Minoriteteve dhe Roma synon përmirësimin dhe avansimin e pozitës së komuniteteve pakicë për të takuar standardet Evropiane. Për të arritur këtë qëllim programi punon në binar paralel me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet qeveritare. Përderisa asiston institucionet qeveritare në hartimin dhe zbatimin e masave të parapara me ligj dhe politika zhvillimore për sigurimin dhe respektimin e të drejtave të pakicave, Fondacioni gjithashtu mbështet OJQ-të në rritjen e kapaciteteve të tyre për të monitoruar, avokuar dhe ofruar shërbime në emër të komuniteteve të tyre përkatëse.

Struktura programore dhe ajo buxhetore e programit kanë mbetë të njëjta si në vitet paraprake duke operuar përmes dy buxheteve të ndara për adresimin e nevojave specifike të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptias dhe atij për adresimin e nevojave të komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në Kosovë. Ky program aktualisht lidh më së shumti mjete financiare që kryesisht shkojnë drejt implementimit të Strategjisë së Qeversisë së Kosovës për Integrimin e Romeve, Ashkalive dhe Egjiptasve (RAE) në Shoqërinë Kosovare.

Fillimi i vitit 2011 gjeti programin e Minoriteteve dhe Roma me dy projekte operationale të vendosura mirë për mbështetje të implementimit të strategjisë së qeversisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe me agjendë të zhvilluar për adresimin e sfidave përpara të komuniteteve minoritare.

Synimet strategjike të programit të Minoriteteve dhe Roma për vitet 2011-12 janë si në vijim:

1. Mbështetja efektive e implementimit të strategjisë së qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve RAE-ky synim strategjik realizohet përmes dy projekteve operationale të financuara nga Unioni Evropian në shumë prej 1.0 mil € dhe nga një grant i veçant prej 0.5 mil € i ndarë për këtë qëllim nga Z. Soros në konferencën e donatorëve për Kosovën.
2. Përgaditja dhe avokimi për anëtarësimin e Kosovës në Dekadën për Përfshirjen e Romëve 2005-2015 dhe riintegrimin e të riatëdesuarve të komuniteteve RAE.
3. Intensifikimi i dialogut publik mbi integrimin e komuniteteve pakicë dhe decantralizimi i komunave të banuar me komunitete pakicë.

4. Fuqizimi i kapaciteteve të OJQ-ve të pakicave (think tank) për të avokuar dhe promovuar agjendat e politikave zhvillimore publike për integrimin e komuniteteve pakicë.

Programi i Minoriteteve dhe Roma vepron brenda një ambienti politikisht jo stabil por kjo nuk ndikoj qenësisht në zbatimin e strategjisë së programit. Edhe në këtë vit është vazhduar puna me organizatat jo-qeveritare me të cilat është vendosur një bashkëpunim afatgjatë, si dhe me organizata të reja të cilat e kanë begatuar dukshëm skenën civile minoritare. Programi poashtu ka përdorur mekanizmat avokues të vendosur përbrenda Fondacionit si që është Forumi 2015, Magazina Evropiane dhe rrejtet jo formale apo tematike të vendosura në mes të OJQ-ve.

Organizatave e shoqërisë civile minoritare treguan një tendencë të vazhdueshme që të profilizohen dhe bëhen faktorë i rëndësishëm me ndikim në lëvizjet politike, socio-ekonomike, edukative, kulturore, etj. Ato gjithnjë e më shumë tregojnë pjekuri dhe përkushtim për tu marrë me çështje zhvillimore të komuniteteve të tyre, me tendencë të faktorizimit të mëtejshëm të potencialit që mban për të sjell ndryshime pozitive në mbrojtjen e pozitës së komuniteteve respektive dhe integritit të tyre në shoqërinë kosovare. Tendanca e OJQ-ve minoritare për bashkëpunim dhe rrjetëzim ishte sidomos e dukshme në periudhën e zgjedhjeve të parakohëshme, përgaditjes për regjistrimit të popullsisë dhe dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Për t'i adresuar këto sfida dhe për të arritur rezultate sa më konkrete programi përdori mekanizmat avokues që posedon Fondacioni si Forumin 2015 përmes së cilit u prezantuan katër studime mbi çështjet më të rëndësishme të gjashtë komuniteteve pakicë e që synonin partitë e tyre politike që garonin në zgjedhjet e parakohshme. Dialogu Kosovë-Serbi shënoj ngritje të bashkëpunimit pakicë-shumicë përmes disa projekteve të cilat fituan edhe vëmendje mediale dhe ndikuan që komunitetet pakicë të paraqesin opinjonet dhe shqetësimet e tyre. Në 2011 dukshëm u ngrit edhe bashkëpunimi në mes të organizatave "pakicë-shumicë" që edhe ishte një ndër synimet e Programi M&R.

Si çdo vit edhe ky 2011 u fillua me takimin tradicional të përfaqësuesve të shoqërisë civile të komuniteteve pakicë i cili u mbajt në Mavrovë prej 31/01-01/02/2011 me pjesëmarrje të 70 pjesëmarrësve. Ky takim sjell çdo vit përfaqësues më të spikatur të OJQ-ve, mediave, përfaqësuesve politik dhe organizatave tjera relevante të të gjitha komuniteteve etnike për të biseduar mbi çështjet dhe zhvillimet në komunitetet e tyre dhe ato të cilat ndikojnë në integrimin e tyre në

shoqërinë kosovare. Duke synuar informimin e mirë mbi strategjinë programore dhe mundësitë e bashkëpunimit takimi fillohet me prezantimin e strategjisë dhe objektivave të programit në mënyrë që diskutimet në vijim të jenë të fokusuar në prioritetet e komuniteteve dhe disajnim të iniciativave sipas prioriteteve dhe mundësive që programi ka.

Programi vazhdon të ketë një bashkëpunim të mirë me qeverinë e Kosovës si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal duke e përkrahur atë në implementimin e politikave publike dhe zhvillimore për integrimin e komuniteteve minoritare e në veçanti të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Gjithashtu bashkëpunim i mirë u realizua edhe me programet e rrjetit, e në veçanti me Roma Initiatives dhe Roma Cultural Program të OSI Budapest dhe Bruksel.

Rezultatet e arritura deri më tani, eksperiencia dhe ekspertiza në adresimin e çështjeve RAE nuk kaloj e pavërejtur nga donatorët dhe organizatat tjera. Gjatë vitit 2011 falë këtij reputacioni Fondacioni i filloj negociatat me Karl Kubel Stiftung, organizate Gjermane e cila financohet nga qeveria Gjermane, për një projekt të ri tri-vjeçarë në shumë prej 580 000 € i cili do të filloj në qershorë 2012.

1. Mbështetja efektive e implementimit të strategjisë së qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve RAE

Që nga viti 2006 Fondacioni është partneri kryesorë i qeverisë në hartimin e strategjisë së qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas, më pas të planit për zbatim të po të njejtit dokument dhe tani në zbatimin e tij. Ky bashkëpunim zhvillohet në dy nivele të qeverisjes, atë qendrorë dhe lokal dhe ndahet në dy forma, duke ofruar ekspertizë dhe duke bashkëpunuar në implementim të projekteve për arritjen e objektivave dhe masave të parapara me planin e veprimit.

Për të ndihmuar procesin e implementimit të strategjisë së qeverisë së Kosovës Programi M&R implementon 2 projekt prej të cilëve i pari është i financuar nga Bashkimi Evropian në shumë prej 1.0 mil. € dhe i dyti i cili ishte në vitin e tretë dhe përfundimtarë i financuar përmes një granti të veçant që Z. Soros zotoi në konferencën e donatorëve për Kosovës në vitin 2008.

Përmes këtyre 2 projekteve janë plotësuar objektivat e vendosur me strategjinë e Programit M&R për 2011-2012. Template B, anex i këtij raporti, jep rezultatet konkrete të arritura për të dy objektivat e vendosur për mbështetjen

efektive të implementimit të Strategjisë RAE për intergimin e komuniteteve RAE, ndërsa në vazhdim jepet një përshkrim i realizimit të të dy projekteve ndaras.

Mund të konkludohet se projektet në pjesë të madhe kanë realizuar objektivat e percaktuar me strategji duke vendosur 10 qendra të komuniteteve në 9 komuna të Kosovës, përmes vendosjes së skemës së ndërmejtësimit shëndetësorë dhe social në 8 komuna, duke organizuar dy shkolla verore të cilat mbuluan me se 100 të rinj të këtyre komuniteteve, duke ndarë 200 bursa për nxënës të shkollave të mesme dhe 20 për studentë universiteti, duke organizuar edicionin e parë të festivalit të kulturës dhe trashigimisë kulturore të RAE komuniteteve dhe duke avancuar aftësitë e tyre në gazetari.

Ajo që nuk shkoj sipas planit, por që nuk ishte rezultat i realizimit të dobët të projekteve, është mos gadishmëria e komunave me të cilat bashkëpunojmë në realizimin e projekteve të ndajnë mjete buxhetore për të siguruar qëndrueshmërinë e iniciativave të filluara. Ky rast nuk ndodh në të gjitha komunat por në vetëm tri prej tyre. Programi M&R në vitin 2012 posaçërisht do ta adresojë këtë problem duke intensifikuar kontaktet me komunat, avokimit/presionit në qeverinë dhe përfshirjen e donatorëve tjerë.

Mbështetja e BE-së për zbatimin e strategjisë për RAE (EU SIMRAES)

Projekti mbështetja e BEs për zbatimin e Strategjisë RAE-EU SIMRAES që filloi me zbatim në shtator 2010 dhe synon të mbështesë Qeverinë e Kosovës në zbatimin e Strategjisë RAE dhe Planit të saj të Veprimit duke përbushur nëntë masa nga katër objektiva të këtij dokumenti. Përmirësimi i mirëqenjes socio-ekonomike të komunitetit RAE është vënë në shënjestër me këtë projekt. Lehtësimi i çasjes në arsim të komuniteteve RAE, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore RAE, dhe përmirësimi i informacionit mbi dhe nga komunitetet RAE përmes mediave. Fokusi i komponentit të arsimit është në 6 qendra të komunitetit në pesë komuna: Ferizaj, Gjakovë, Graçanicë, Mitrovicë dhe Prizren, ndërsa komponenta e Kulturës dhe Mediave zhvillohet në tërë teritorin Kosovës.

Ky projekt vitin 2011 përbushi të gjitha aktivitetet e parapara me projekt për këtë periudhë kohore. Efektet e projektit janë të dukshme dhe të matshme dhe qysh në fillim treguan rezultate të prekshme. Gjatë vitit të parë të implementimit projekti arriti të ngris vijueshmërinë e

nxënësve RAE për 2 % ndërsa pritet se deri në fund të projektit kjo përqindje të arrij 5 %. Në kuadër të komponentës së arsimit u ndanë 200 bursa për nxënës të shkollave të mesme dhe 20 për studnetë universiteti. Promovimi i kulturës dhe trashigimisë kulturore të komuniteteve RAE ishte më se i suksesshëm. Festivali i kulturës dhe trashigimisë kulturore të komuniteteve RAE i mbajtur në Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë në Maj 2011 kishte një mbulesë shumë të mirë mediale falë programit kualitativ dhe interesant të prezantuar.

Projekti ka të vendosur bashkëpunim të ngusht me ministrinë përkatëse për secilën komponentë, përfaqësues të komunave dhe udhëhiqet nga këshilli drejtues i projektit në përbërje: Zyra për Qeversije të Mirë (ZKM), MASHT, MKRS, tre përfaqësues të komuniteteve që njokohësisht janë edhe zyrtarë komunal, ECLLO dhe KFOS.

Raporti më detal me të dhëna numerike mbi këtë projekt gjindet si ANEX I i këtij raporti.

Në shtatorë projekti është vlerësuar nga vlerësuesi i pavarur i anagzhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Raporti i vlerësuesit është më se pozitiv dhe gjindet si ANEX II i këtij raporti. Projekti gjithashtu pati edhe vlerësim intern i cili u mbajtë në gusht 2011. Raporti nga ky vlerësim gjindet si ANEX III i këtij raporti.
Komponenta e Arsimit

Kjo komponentë ka për cak përmbushjen e katër masave nga dy objektiva të përcaktuar me planin për zbatim të RAE Strategjisë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës: 1.5.4 Ofrimi i kurseve përgatitore gjatë vitit shkollor për regjistrim në shkollim të lartë për nxënësit me rezultate të dobëta; 1.7.3 Ofrim kurse të gjuhës për nxënësit parashkollor; 1.10.5 Vendosi skema e granteve shkollore për nxënës dhe studentë; dhe 3.7.1 Në 5 komuna të Kosovës do të krijohen qendrat burimore (edukative) të cilat do të (1) Ofrjnë orë plotësuese për nxënësit e shkollës fillore; (2) Kurse të ndryshme për pjesëtarët e komuniteteve roma, ashkali dhe egjiptas; dhe (3) Ofrjnë programe për zhdukjen e analfabetizmit.

Përmbushja e objektivave të komponentës së arsimit arrihet përmes vendosjes së gjashtë qendrave të komuniteteve/mësimnxënije në pesë komuna (Ferizaj, Graçanicë, Gjakovë, Mitrovicë dhe dy në Prizren) të cilave iu parapriu nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me komunat metë cilat zotohen që të marrin përsipër menaxhimin e këtyre qendrave pas përfundimit të projektit. Secila qendër e komunitetit

menagjohet nga një OJQ lokale dhe është partnere lokale në projekt. Kështu në Prizren për partner kemi Iniciativën 6 dhe Durmish Aslano, në Ferizaj Caraitas Kosova, në Gjakovë Bethany Christian Service, në Mitrovicë Roma and Ashkali Documentation Center, dhe në Graçanicë Balkan Sunflowers.

Në këto gjashtë qendra zbatohen programe arsimore të cilat mbulojnë fëmijë parashkollorë, të nivelit të ulët dhe të mesëm të mesimit dhe studentë. Shtesë programeve arsimore në qendra organizohen edhe kurse kundër analfabetizmit të disajnuara për prindër duke synuar femrat e këtyre komuniteteve dhe ndarjen e 200 bursave për nyënës të shkollave të mesme dhe 20 për studnet universiteti.

Komponenta zbatohet në bashkëpunim të ngusht me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe departmentet komunale të arsimit.

Lista e granteve:

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
EU SIMRAES Education component – all equipment and supplies for the implementation of the activities in six Learning Centers	KEC	77 065.00
Punëtorja e vlerësimit të projektit EU SIMRAES	Operacionale	9 502.75

Komponenta e Kulturës dhe Mediave

Përmes kësaj komponente përbushen pesë masa nga dy objektiva të planit të veprimit për zbatim të RAE Stratejisë: 1.3.2 Ofrimi i trajnimeve për përfaqësues të komuniteteve dhe aftësimi i tyre në përdorimin e pajisjeve teknike, politika editoriale, gazetari, menaxhim informacioni dhe komunikim; 1.3.4 Mbështetje për aktivitetet për ndërtim kapacitetesh për gazetarë nga tri komunitetet; 1.3.5 Mbështetje financiare për botimin e gazetave, revistave dhe publikimeve të ndryshme, prodhimin e dokumentareve; 2.2.4 Mbështetje për mbledhjen dhe incizimin e muzikës Rome; 2.2.5 Organizimi i javës së kulturës rome, ashkali dhe egjiptase.

40

Nën-komponenta e kulturës zbatohet në bashkëpunim të plotë me Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit. Partner në zbatim të një pjese të komponentës së kulturës është organizata Pranë Femijëve ndërsa të gjitha të tjerat zbatohen përmes organizatave të nën-kontraktuara dhe vetë Fondacionti. Të nën-kontraktuar për tërë nën-komponentën e mediave është Rrjeti për Gazetari Huluntuëse (BIRN), ndërsa të nën-kontraktuar tjerë për komponentën e kulturës janë: Qendra Multimedia, Radio Urban FM, karavani i shkrimëtarëve Agim Deva.

Nën komponenta e Kulturës

Aktiviteti kryesorë dhe i cili ndikoj dukshëm në vizibilitetin e tërë projektit ishte Festivali i kulturës dhe trashigimisë kulturore të komuniteteve RAE. Ky festival i organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit u përcjellë nga më se 3000 vizitorë ndërsa vlerësohet se numri i atyre që kanë ndëgjuar për Festivalin apo kanë përcjellë ngjarjet përmes mediave është shumë më i madh. Organizimi i Festivalit udhëhiqet nga këshilli artistik i vendosur nga MKRS. Në vazhdim gjinden përshkrime të shkurta mbi aktivitetet që ishin pjesë e Festivalit por edhe i atyre që janë zhvilluar nëpër qendra të komuniteteve.

Poashtu janë dhënë edhe përshkrime të shkurta mbi aktivitetet për përmbushjen e objektivave të përcaktuar për nën-komponentën e mediave.

Organizimi i festivalit Java e Kulturës së Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve

Festival i kulturës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian është organizuar nga 23-29 maj 2011 në Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren. Aktivitetet përbëheshin nga: ekspozitë fotografike, ekspozitë etnologjike, shfaqje teatrore, debate, projeksionet e filmave të shkurtër dokumentarë, dhe koncertet. Festivali u shënua me pjesëmarrje të mirë për të gjitha aktivitetet dhe me përcjellje të mirë të mediave për ngjarjet.

Ekspozita fotografike e titulluar "Përmes syve të mi" me të cilën edhe u hap Festivali ishte kolazh i 60 fotografitë të punuara nga të rinjtë RAE nga 6 qendra të komunitetit. Ata kishin mundësi për të treguar krijimtarinë e tyre përmes fotografisë, duke shprehur se si e shohin jetën përmes syve të tyre duke treguar në të njëjtën kohë atë që është përreth tyre. Këta artistë të rinj ishin mysafir të veçantë të ftuar për ekspozitë. Të gjitha fotot janë marr me kamera digjitale.

Ekspozita etnologjike e artefakteve, veprave të artit dhe faktet, karakteristike për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian u hap në Muzeun Etnologjik të Prishtinës. Ekspozita ka lejuar vizitorët të njihen me rite të veçanta, ceremonitë dhe ritualet që i kanë këto tri komunitete (ritet e lindjes, dasmës dhe vdekjes), me traditën e tyre, veshje, historinë, dhe faktet e rëndësishme statistikore.

Performanca e improvizuar teatrale "Ne jemi e ardhmja!" përbëhej nga shtatë tema të ndryshme (pika), që lidhin tema të ndryshme sociale nëpërmjet muzikës dhe tregimeve personale të këtyre aktorëve të rinj. "Ne jemi e ardhmja!" është shfaqur më 25 maj 2011 në Teatrin Dodona, Prishtinë dhe më 26 maj 2011 në Teatrin e qytetit në Prizren. Ky grup prej 20 të rinjesh të RAE komuniteteve punuar për 2 muaj me profesionistë të Qendrës Multimedia dhe trajnere italiane.

Debati "Promovimi i vlerave të BE-së: Integrimi i komunitetit Roma, Ashkali dhe Egjiptian përmes medias dhe kulturës" i mbajtur më 26 maj 2011 në Prishtinë, është moderuar nga Agron Bajrami, kryeredaktor i gazetës Koha Ditore. Qëllimi i këtij debati ishte rritja e diskutimit në lidhje me rolin e mediave në promovimin e kulturës së komuniteteve RAE dhe roli i të dyjave në procesin e integritimit dhe përfshirjes së komuniteteve RAE në shoqërinë kosovare.

Dy koncerte janë organizuar gjatë ditës së pestë të festivalit, njëri gjatë ditës dhe tjetri në mbrëmje. Në koncertin e ditës, shumë artist lokal dhe grupet e bendeve RAE kanë performuar në rrugën Nëna Terezë në Prishtinë, çka ka tërhequr vëmendjen e shumë qytetarëve. Gjatë koncertit në mbrëmje, një grup dhe një ansambël nga Maqedonia kanë performuar së bashku me oktetin nga Prizreni. Koncerti u mbajt në Teatrin Oda në prani të më se 300 shikues.

Dy filma të shkurtër dokumentar të punuar nga artistës Rom dhe të cilat trajtonin tema nga jeta e komuniteteve janë shfaqur gjatë dy ditëve të fundit të festivalit. Dy rrëfime dashurie nga Shota Bukoshi dhe Një diell një komb nga Sami Mustafa, u shfaqën në Qendrën për Mësim në Mitrovicë dhe në Tetris, Prishtinë.

Aktivitete të organizuara në Klubet e Aktiviteteve të zbatuara në Ferizaj dhe Graçanicë

Grupi i artistëve të njohur kanë zbatuar aktivitetet e tyre në qendrat e komuniteteve në Ferizaj, Graçanicë, dhe në dy qendrat në komunën e Prizrenit. Muzicentë, aktorët, piktorë, shkrimtarët dhe regjisorët televiziv kanë punuar për 15 javë me fëmijët që frekventojnë këto qendra për të ekspozuar talentet e tyre. Si rezultat, fëmijët kanë përgatitur program artistik (në qershor dhe dhejtor 2011) së bashku me shfaqje muzikore, aktrim dhe ekspozitë të pikturave. Të dy programet janë shfaqur në qendrat kulturore të komunave respektive dhe kanë pas mbulesë të mirë mediale.

Karavani i shkrimtarëve "Agim Deva" vizitoi 6 Qendra të Komunitetit në tërë Kosovën

Karavani i shkrimtarëve "Agim Deva" tradicionalisht viziton shkollat në mbarë Kosovën, ku shkrimtarët e njohur lexojnë shkrimet e tyre dhe bisedojnë me nxënësit. Karvan i sivjetshëm përbëhej jo vetëm nga shkrimtarë shqiptarë por edhe nga ata RAE. Ky grup i shkrimtarëve i viz-

itoi qendrat e komunitetit RAE, ku i kanë lexuar shkrimet e tyre dhe i ndanë librat për fëmijët. Vizitat janë mirëpritur nga fëmijët dhe të rinjtë dhe janë vizituar nga një numër i madh i pjesëtarëve të komuniteteve.

Nën komponenta e Mediave

Prodhimi i një programi televiziv 60-minutash për festivalin e kulturës RAE në bashkëpunim me RTK-në

Siç është planifikuar me projekt, bashkëpunimi është themeluar me transmetuesin publik të Kosovës. Ekipi i programit të RTK-së në gjuhën romë ka mbuluar të gjitha aktivitetet e organizuara për festivalin e kulturës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Dokumentari televiziv rreth Festivalit është prodhuar dhe transmetuar në RTK në qershor 2011.

Trajnime për përdorimin e pajisjeve dhe menaxhimin të mediave

BIRN ka filluar me trajnime për 50 pjesëtarët e komunitetit RAE që nga maji 2011. Trajnime për përdorimin e pajisjeve në TV, radio, shtyp dhe menaxhimi i mediave është në proces. Të trajnuarit për përdorim të pajisjeve kanë arritur rezultate të mëdha. Ata kanë prodhuar dhe marrë pjesë në prodhimin e pesë raporte televizive mbi tema të ndryshme dhe tri nga ato janë transmetuar në RTK- Radio Televizionin e Kosovës.

Lista e granteve

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Media trainings – use of equipment, media management, journalism course	BIRN	48 600.00
Activity Clubs organized in community centers with famous Kosovo artists	Close to Children	26 120.00
Festival – theatre performance, film showings, ethnological exhibition	Qendra Multimedia	18 860.00
Festival – concerts in Oda Theatre and in Mother Theresa Street in Pristina	Urban FM	10 150.00
Festival - TV program about the festival	Operational	4 318.19
Festival - Visual arts exhibition (cameras, workshop, and exhibition)	Operational	6 366.68
Festival – Debate about the integration of RAE communities through media and culture	Operational	1 589.11
Design, printing and distribution of posters, leaflets, booklets for the festival	Operational	4 560.25
Artistic Committee – travel expenses	Operational	172.80
Caravan of writers – visits to community centers	Caravan of writers Agim Deva	1 400.00

Mbështejta për zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE

Ky projekt 3 vjeçarë, i mbështetur nga fondet e ndara nga Z. Soros në konferencën e donatorëve për periudhën 1 janar, 2009-31 dhejtor, 2011 pati për qëllim avancimin e pozitës socio-ekonomike të komuniteteve RAE dhe krijimin e një baze institucionale për adresimin e nevojave të tyre për një integrim sa më domethënës në shoqërinë Kosovare.

Për tri vite sa zgjati ky projekt në cak ish-in (1) avancimi i bashkëpunimit në mes të komuniteteve dhe qeverisë lokale/komunave, (2) fuqizimi i të rinjve të komunitetve për pjesëmarrje aktive në shoqëri dhe (3) përmirësimi i pozitës sociale me theks të veçantë në shëndetin e komuniteteve RAE.

Ky projekt përveç objektivave të përcaktuar krijoi edhe infrastrukturë të nevojshme për implementim të projektit EU SIMRAES siç janë identifikimi i komunave dhe qendrave të komunitetit për zbatim të aktiviteteve të parapara me plan të veprimit, ngriti kapacitetet e OJQ-ve partnere për implementim të projekteve, mbështeti hu-

niteteve RAE në Kosovë dhe kapacitetet e qeverisë në të dy nivelet për implementim të kësaj strategjie.

Për periudhën tri vjeçare ky projekt vendosi 9 qendra të komuniteteve në 8 komuna, ngriti kapacitetet e OJQ-ve të komuniteteve për menagjim të projekteve, hartoi plane veprimi për pesë komuna, investoi në ngritjen e kapaciteteve të rinisë përmes kurseve të gjuhës, kompjuterëve, trajnimeve për qytatari aktive dhe lidhesh dhe vendosi skemen e ndërmjetesimit shëndetësorë dhe social në 8 komuna.

Viti 2011 dhe njëherit përmbyllës për këtë projekt ishte vit kur projekti është përqëndruar më shumë në sigurimin e qëndrueshmërisë së iniciativave të ndërmarra. Në këtë aspekt Fondacioni ka intensifikuar bashkëpunimin me komunat dhe ministritë përkatëse. Kjo iniciativë jo gjithnjë ishte e sukseshme e sidomos në ato raste kur nga komunat kërkohej ndarje e buxhetit. Sigurimi i qëndrueshmërisë së iniciativave të ndërmarra me projekt mbetet si sfidë për programin M&R për vitin 2012.

Bashkëpunimi në mes të përfaqësuesve të komuniteteve RAE dhe qeverisë lokale

Nga viti 2009 përmes këtij projekti u asistuan pesë komuna me hartimin e planeve lokale për zbatim të Strategjisë RAE. Këto plane të veprimit tashmë janë të aprovuar nga asambltetë komunale në Ferizaj, Fushë Kosovë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjakovë. Këto plane lokale veprimi, të hartuara në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve i shërbejnë strukturat komunale për të planifikuar aktivitete dhe buxhete për zbatim si dhe për të vendosur mekanizma që sigurojnë përmirësimin afatgjatë të pozitës socio-ekonomike të komuniteteve.

Bashkëpunimi me institucionet komunale në komunën e Istogut rezultuan edhe me ndarje të dy klasëve të shkollës së vjetër në fshatin Gurrakocë për përdorim nga komunitetet si qendër komuniteti. Kjo qendër ofron programe arsimore, kulturore për të rinjtë e komuniteteve që jetojnë në këtë fshat.

Bashkëpunimi me qeverisjen lokale është realizuar edhe për institucionalizimin e modelit të ndërmjetësisimit shëndetësorë-social me ç'rast janë nënshkruar memorandume mirkuptimi për vazhdim të kësaj skeme me fonde partiale nga komunat ku kjo skemë zbatohet

Lista e granteve

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Rishikimi i planit të veprimit të komunës së Gjakovës	Akademia për Trajnime dhe Asistencë Teknike	6 870.00
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Gëzimi ynë rinor-Ferizaj	3 506.16
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Iniciativa 6-Prinen	3 506.16
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Visioni 02-Istog	3 506.16
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Roma and Ashkali Documentation Center-Mitrovicë	3 506.16
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Bethany Christian Service-Gjakovë	3 506.16
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Ashkani-Lipjan	3 506.16
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	7 Shtatori-Pejë	3 506.16
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Youth for Positiv Change	3 506.16

Fuqizimi i të rinjve të komuniteteve RAE për të marrë rol aktivë në shoqëri

Avansimi i të rinjëve nga komunitetet RAE përmes kurseve të gjuhëve, kurseve të kompjuterëve, puna e tyre praktike në realizim të mini projekteve, avansimi i dijenisë së tyre mbi aktivizmin qytetarë, etj është një domosdoshmëri nëse merret parasysh nevoja për të identifikuar potencialin e tyre si liderë të ardhshëm. Duke u fokusuar në të rinjtë e komuniteteve RAE Fondacioni synon të ngris kapacitetet e tyre për të krijuar një potencial të liderëve të rinj të së ardhmes dhe model për të rinjtë tjerë të këtyre komuniteteve me qëllim të avancimit të pozitës së tyre në shoqërin kosovare.

Në kuadër të këtij projekti Fondacioni ka organizuar dy vite radhazi shkollë verore për qytetari aktive me të cilat janë mbuluar 100 të rinjë nga komunitetet RAE. Shkolla verore për herë të parë u organizua në vitin 2010 dhe ishte e përkrahur nga Fondacioni dhe Roma Initiatives e OSI Budapest. Në vitin 2011 Fondacioni siguroj fonde nga MASHT, dhe në këtë mënyrë arriti ta institucionalizoj këtë iniciativë e cila nga viti i ardhshëm do të vazhdoj të organizohet me fonde të MASHT, MKRS dhe një pjesë nga buxheti bazë i Fondacionit.

Programi i shkollës verore për qytetarinë aktive u fokusua në përgatitjen e të rinjëve për të marrë rol aktivë në proceset vendimmarrëse dhe të avokojnë për çështjet që ngriten në komunitetin e tyre. Programi përbëhej nga pesë module: Moduli për Shtetin dhe Zgjedhjet, moduli për Debat, Moduli për Gjqësorin, Moduli për Medie si dhe Moduli i Teatrit të Rrugës dhe Pantomimës. Trajnimet e këtyre moduleve u kryen me sukses të madh nga ana e trajnerëve të lëvizjes „FOL”.

Lista e granteve:

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Shkolla verore për qytetari aktive-01-08/07/2012	FOL	4 850.00
Shkolla verore për qytetari aktive-01-08/07/2012	Operational	21 456.75
Zhvillimi i aktiviteteve arsimore dhe kulturore për të rinj në qendrën në Sallahane-Ferizaj	Gëzimi ynë rinor	2 279.00
Kurse të gjuhës angleze dhe kompjuterëve për të rinj në qendrën e komunitetit në Gurrakoc-Istog	Visioni 02	3 804.04

Avancimi i pozitës sociale dhe shëndetësore të komuniteteve RAE

Duke synuar përmirësimin e pozitës së RAE komuniteteve në sferën e shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe duke u bazuar në eksperiencat e shteteve të regjionit, në veçanti në eksperiencat në Rumuni dhe Bullgari, Fondacioni në 2010 ndërmori iniciativën e ndërtimit të modelit të ndërmjetësimit shëndetësor/social. Ky model synon ndërmjetësimin në mes të komuniteteve dhe institucioneve përkatëse për të lehtësuar çasjen e komuniteteve ndaj institucioneve respektive që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe sociale.

Kjo iniciativë mbulon tetë komunat në vijim: Pejë, Istog, Lipjan, Mitrovicë, Graçanicë, Gjakovë, Ferizaj dhe Prizren. Pas trajnimeve të përfunduara, në terren janë vendosur nga dy ndërmjetësues në secilën komunë të cilët i identifikojnë problemet dhe nevojat e komuniteteve dhe në koordinim me Qendrat e Mjekësisë Familjare në komunat e tyre respektive organizojnë takime me komunitet të cilat mbahen nga mjekët e fushave të dhura dhe njëkohësisht drejtojnë individë nga komunitetet në institucionet përkatëse për të zgjidhur problemet apo përmbushur nevojat që ata kanë.

Problemet e identifikuara adresohen nga ndërmjetësuesit në institucionet përkatëse duke lehtësuar kështu çasjen e komuniteteve ndaj tyre, qofshin ato institucione apo organizata ndërkombëtare e njëkohësisht arrihet informimi dhe vetdijësimi i tyre për mundësitë e ndryshme për zgjidhje të problemeve me të cilat ata ballafaqohen si regjistrimi civil, regjistrimi i fëmijëve në shkolla, vaksinimi i rregullt, trajnimet e ndryshme shëndetësore, informime mbi mundësi të punësimit, etj.

Në fund të vitit 2011 Fondacioni organizoj një punëtori 2 ditore me pjesëmarrje të institucioneve qeveritare të nivelit qendrorë dhe lokal, OJQ partnere të komuniteteve RAE, përfituesve të projektit dhe ekspert për të gjetur modalitetet e qëndrueshmërisë së iniciativave të filluara për mes projektit dhe për të vlerësuar punën e deri tanishme. Përmirësimi i shëndetit dhe përdorimi i skemave sociale të komuniteteve RAE pas dy viteve implementimi të iniciativës së ndërmjetësimit shëndetësorë/social është i dukshëm. Kjo konfirmohet duke u bazuar në numrin e fëmijëve të vaksinuar, atyre të regjistruar në shkollë për herë të parë apo të kthyer pas braktisjes, regjistrimit në regjistrat civil, etj falë punës së ndërmjetësuesve.

Për nevoja të vlerësimit të rezultateve të arritura por edhe për t'i bërë të ditura të arriturat e me qëllim të sigurimit të fondeve shtesë nga donatorët tjerë për vazhdim të kësaj iniciative Fondacioni angazhoj kompaninë IQ Consulting për vlerësimin e punës dhe për të përgaditur një broshurë me të arriturat. Kjo broshurë do të përfundoj në Mars, 2012.

Lista e granteve:

Project title	Grantee	Grant Amount
Ndërtimi i kapaciteteve të ndërmjetësuesve shëndetësorë social	Kosova Association of Family Doctors'	10 090.00
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Gëzimi ynë rinor-Ferizaj	4 674.88
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Iniciativa 6-Priren	6 080.88
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Visioni 02-Istog	4 774.88
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Roma and Ashkali Documentation Center-Mitrovicë	4 774.88
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Bethany Christian Service-Gjakovë	4 674.88
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Ashkani-Lipjan	4 774.88
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	7 Shtatori-Pejë	4 914.88
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Youth for Positive Change	1 168.72
Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve komunale dhe komuniteteve RAE-Ndërmjetësimi shëndetësorë-social	Balkan Sunflowers	3 506.16
Punëtori vlerësimi të rezultateve dhe sigurim të qëndrueshmërisë të proejktit RAEIS, 03-04/12/2012	Operacional	10 000.00

Vlerësimi i punës së ndërmjetësimit shëndetësorë/social dhe publikimi i brochures

të këtij viti dhe të mbyllin hendekun në mes të IQ Romëve dhe jo-Romëve deri në 2020.

2. Përgaditja dhe avokimi për anëtarësimin e Kosovës në Dekadën për Përfshirjen e Romëve 2005-2015 dhe riintegrimin e të riatdësuarve të komuniteteve RAE

Iniciativat avokuese të Programit M&R për çështjet e komuniteteve RAE qëndrojnë lartë në agjendën e programit të Minoriteteve dhe Roma. Këto iniciativa shkojnë në tri drejtime paralele: (1) duke i ofruar asistencë teknike qeverisë, (2) duke përdorur mekanizmat avokues të Fondacionit për të ngritur çështjen te institucionet dhe shoqëria civile e vendit dhe ato ndërkombëtare dhe (3) duke ofruar asistencë personave të riatdësuar për të përmbushur nevojat dhe të drejtat e tyre. Për të arritur këtë qëllim Programi M&R prodhohet një film dokumentarë, bashkë-organizohet një konferencë të nivelit të lartë qeveritarë dhe EUs, publikohet një edicioni të veçantë me temën Romët, Ashkalit dhe Egjiptasit të Magazinës Evropiane, në bashkëpunim me UNCEF fillohet përgaditja për një konferencë mbi integrimin e personave të komuniteteve RAE të riatdësuar nga shtetet e Perëndimit dhe ofron asistencë asistencë për integrim në sistemin arsimorë përmes qendrave të komuniteteve të krijuara përbrenda dy projekteve për përkrahje të implementimit të RAE Strategjisë (RAIES dhe EU SIMRAES).

Asistenca teknike e ofruar qeverisë që nga viti 2006 e pajisi atë me dy dokumente të rëndësishme që i hapin Kosovës rrugë për antarësim të plotë në Dekadën për Përfshirjen e Romëve 2005-2015, po që se nuk do të ekzistonte problemi politik i mos njohjesë së pesë shteteve anëtar të DR dhe presioni i Sërbisë e cila potenconë se Romët e Kosovës janë të përfshirë në këtë organizëm përmes saj duke u thirrur në Rezolutën e KB 1244. Megjithatë Kosova fitoi statusin e vëzhguesit në këtë iniciativë rajonale falë angazhimit të Fondacionit për të vendosur qeverinë e Kosovës në kontakt me Sekretariatën e Dekadës.

Dekada për Përfshirjen e Romëve 2005-2015 tashmë në pjesën e dytë të dhjetë vjeçarit arriti që dukshëm të përmirësojë pozitën e Romëve në shtetet anëtare por edhe të ndikoj fuqishëm në Unionin Evropian për të vendosur një agjendë më proaktive ndaj Romëve në BE dhe shtetet për zgjerim, përfshi këtu shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. Kështu DR ndikoi që BE të merrë vendim të prerë që të gjitha shtetet anëtare të BE-së të hartojnë strategjitë e tyre për përfshirjen e komunitetit Rom deri në fund

Ky vendim i Parlamentit Evropian shtyu edhe Zyrën e Unionit Evropian në Kosovë (EUOK) t'i kushtoj më shumë rëndësi zbatimit të strategjisë për intergim të këtyre komuniteteve në Kosovë dhe të tregoj shumë më shumë interesim që Kosova të bëhet anëtare e Dekadës Rome.

Konferenca në kuadër të Dialogut për Stabilizim Asociim e mbajtur me 11 maj, 2011 në Prishtinë: "Inclusion of Roma, Ashkali and Egyptians-The way forward" u organizua në bashkëpunim të plotë në mes të EUOK dhe Fondacionit. Kjo konferencë e kryesuar nga Z. Pierre Mirel, Drejtor për Ballkanin Perëndimorë DG ELARG dhe Znj. Vlora Çitaku, ministre e Ministrisë të Integritimit Evropian mbledhi përfaqësues të lartë, sekretarë permanent, të të gjitha ministrive dhe të drejtues të organizatave ndërkombëtare dhe atyre lokale për të diskutuar çështjet dhe ngecjet me zbatim të RAE Strategjisë. Fondacioni në këtë konferencë mbuloj segmentin e buxhetimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit për masat e parapara me RAE Strategji si dhe vlerësimin e situatës për sa i përket komponentës së arsimit që është bërë përmes përfaqësimit të Qendrës për Arsim e Kosovës, spin off i Fondacionit. Fondacioni përveç kontributit të vetë në organizimin dhe disajnimin të përmbajtjes së kësaj konference dhe kontributin e vet për hartimin e 40 rekomandimeve për të dy nivelet e qeverisë dhe përgaditjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile për pjesëmarrje dhe prezantim në këtë konferencë. Me këtë qëllim një takim pune u mbajt me 10 maj, 2011 me 20 përfaqësuesit më të spikatur të shoqërisë civile të RAE komuniteteve të cilët për këtë takim përgaditën një deklaratë të përbashkët. Në konferencë u bë e qartë edhe se Fondacioni shihet si një prej partnerëve më serioz të qeverisë si në zbatim të strategjisë ashtu edhe për ta ndihmuar atë në aspiratat e saj për tu bërë anëtare e Dekadës së Romëve.

Proçesi i Riatdësimit u fillua menjëherë pasi UNHCR në 2009 vlerësoj se situata në Kosovë për pakica është e sigurtë dhe pas nënshkrimeve të para të marrëveshjeve mbi riatdësimitin me shtetet e perëndimit. Qeveria e Kosovës nuk hezitoi të merrë përsipër obligimet që dalin nga marrëveshjet e riatdësimitit për t'i hap rrugë vetës për fillimin e bisedimeve për liberalizim të vizave, përkundër faktit se nuk ishte e përgaditur as me infrastrukturë as me buxhet për një proces të tillë. Kështu një numër i madh i kosovarëve u gjetën në aeroportin e Prishinës pa pasë ku të shkojnë apo kuj t'i drejtohej për ndi-

hmë. Komunitetet më të rezikuar nga ky proces janë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të cilët ishin në numër më të madh në krahasim me madhësinë e komunitetit që jeton në Kosovë, por edhe në rastet e rralla kishin shtëpi të vetën apo familje për tu streguar. Numri total i të riatëdhësuarve të komuniteteve RAE dnë 2010 dhe 2011 është 1409, prej të cilëve numri më i madh është i komunitetit Rom 955. Në vitim 2010 Ministria e Punëve të Brendshme me strategji dhe plan të veprimit të hartuar dhe aprovuar siguroj një fond prej 3,5 mil € për adresimin e nevojave të personave të riatëdhësuar, por për shkak të fluksit të madh të të riatëdhësuarve nuk arrin ti shqyrtoj dhe ndërmerrë masa të shpejta për të gjitha kërkesat dhe nevojat e të riatëdhësuarve. Kjo ngadalsi në shqyrtimin e kërkesave është poashtu edhe rezultat i centralizimit të buxhetit. Deri sa identifikimi i nevojave bëhet në nivel komunal nga zyrtarët e zyrave për komunitete dhe kthim, të cilat zyra njihen si ato me kapacitetet më të ulta, vendimi për përkrahje merret nga bordi i vendosur në MPB që e ngadalësonë procesin edhe më tej duke lenë një numër të madh të të riatdhesuarve me problem të pazgjidhur për një kohë mjaft të gjatë. Buxheti shfrytëzohet për nevojat emergjente si strehimi, ushqimi dhe në raste të rralla veshmbathje. Problemi tjetër që shihet në adresim të nevojave specifike që kanë të riatëdhësuarit është jo harmonizimi i strategjive ekzistuese në mes veti që e bënë procesin edhe më pak efektiv. Një numër i madh i Romëve të kthyer me forcë duke mos pas zgjidhje tjetër përfundon në kampin e vetëm të mbetur në veri të vendit, në Leposaviq, ku jeton në kushte jo humane dhe pa mundësi për arsim, punësim e plotësim të të drejtave tjera që ju takojnë. Vetëm 16% të fëmijëve vlerësohet se vazhdojnë shkollimin, kjo si pasoje e mos njohjes së gjuhës së instrukcionit apo kushteve të rënda ekonomike të cilat i shtyjnë këta fëmijë të merren me punë të rënda fizike për të siguruar të ardhura për vete dhe familjet e veta.

Programi i M&R i'u çasë këtij problemi duke avokuar në drejtim të qeverisë së Kosovës dhe shteteve të Perëndimit, në veçanti qeverisë Gjermane, shtetë në të cilin jeton numri më i madh i komuniteteve me status "të toleruar". Për të arritur këtë Programi M&R në bashkëpunim me Roma Initiatives të Open Society Institute prodhoh një film dokumentarë të kualitetit të lartë mbi riatdhesimin e pjesëtarëve të komuniteteve RAE nga Gjermania të titulluar: Të Çrënjësuarit: Perspektiva e komuniteteve RAE në politikën e riatdhesimit nga Evropa Perëndimore. Për prodhim të këtij filmi dokumentarë Programi M&R dhe Roma Initiatives angazhuan Romedia Foundation me bazë në Budapest. Ky film dokumen-

tarë u bazua në dy hulumtime të bëra paraparakisht: Pozita socio-ekonomike e komuniteteve RAE në Kosovë (hulumtim i financuar nga KFOS) dhe Integrimi sipas kushteve (hulumtim i financuar nga UNICEF). Ky film trajton një familje me dy fëmijë të moshës shkollore të lindur në Gjermani, jetën që kanë pasë në Gjermani dhe si ata çrënjësen nga realiteti, të vetmin të cilin e njohin, për tu gjetë në kampin e Laposaviqit ku nuk vijojne mësimin dhe janë të detyruar të mbledhin mbeturina për të mbijetuar. Ky film dokumentarë premierën e vet e pati në prime-time në emisionin Jeta në Kosovë dhe u pasua me debat në të cilën morrën pjesë përfaqësues të MPB, Ambasadës Zvicrane, përfaqësues të shoqërisë civile, hulumtues dhe të Fondacionit. Ky debat u realizua me 29 shtator 2011. Ky film poashtu do të merrë pjesë edhe në fesalet për të drejtat e njeriut në vend dhe jasht tij.

Në Mars 2012 do të mbahet një konferencë me titull pune: Integrimi i personave të riatdhesuar të komunitetieve RAE në Kosovë. Kjo konferencë do të realizohet në bashkëpunim me Zyrën e Unionin Evropian në Kosovë, UNICEF, Ministrinë e Integritimeve Evropiane, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Fondacionit. Gjatë kësaj konference do të shfaqet edhe filmi dokumentarë të Çrënjësuarit.

Programi i Minoriteteve dhe Roma përdori edhe një mekanizëm të Fondacionit, Magazinës Evropiane, për të ngritur çështjen e komuniteteve RAE, lëvizjet që ndërmiren për përmirësimin dhe përfshirjen e këtyre komuniteteve, si në nivelin evropian, rajonal ashtu dhe në Kosovë.. Edicioni i 5 i Magazinës Evropiane e titulluar: Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit, për të cilën Programi M&R angazhoj ekspert me renome ndërkombëtare dhe vendore për të trajtuar tema në 5 tërësi: (1) BE dhe iniciativat rajonale, duke mbuluar politikën e BEs për përfshirjen e dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom, Dekadën për Përfshirje të Romëve 2005-2015, (2) Proçesi i riatdhesimit, (3) Strategjia për Integrim të Komuniteteve RAE, (4) Projektet në përkrahje të RAE Strategjisë, dhe (5) Kultura dhe identiteti. Magazina u botua në 4 gjuhë është shpërndarë institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, ambasadave dhe organizatave jo qeveritare. Kjo magazinë do të përdoret edhe për iniciativë avokimi në të ardhmën ngecjet në implementim të RAE e strategjisë dhe riatdhesimit si proces i cili e ngadalsion implementimin e kësaj strategjie dhe Kosovën e gjenë të papërgaditur për të pranuar një numër aq të madh të të kthyerve.

Në fund të vitit kjo magazinë u promovua edhe në një mbrëmje kulturore të organizuar nga

Fondacioni ku përveç artistëve të komuniteteve morrën pjesë edhe aktorë të njohur kosovarë si Enver Petrovci i cili recitoi së bashku me autorin e poezive Kujtim Paçakun, Hazir Myftari i cili e luajti një pjesë nga monodrama "Shtatë maskat e bardha" deri sa performuan me këngë tradicionale romë muzikantë rom nga plemetina. Në këtë mbramje u vendosë edhe ekspozita e disa fotografive të përzgjedhura të punuara nga femijët në 5 komunat ku implementohet projekti EU SIMRAES.

Fondacioni poashtu mbështeti dhe disa projekte tjera të cilat synonin avokim për çështjet e komuniteteve RAE. Ndër më të suksesshmet dhe të dukshme ishin **Rolling Film Festival**. Ky festival i filmit dokumentarë mbi çështjet Romë përveç mbrëmjeve të shfaqjes së këtyre filmave organizoj edhe garë për të rinjtë RAE për filmin e shkurt me të mirë të gjiruar me kamerë të telefonit. Festivali ishte i vizituar nga shumë shikues nga rradhët e komuniteteve RAE por edhe të komuniteteve tjera si dhe nga përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare prezente në Kosovë. Temat e trajtuara në filmat dokumentarë ishin

aktuale duke ja nisë me gjuhën romë e duke përfunduar me gjendjen e tyre nëpër komuna të ndryshme të Kosovës duke u adresuar pikë së pari komunat ku ata jetojnë me shumicë serbe dhe nevojat e tyre nuk adresohen apo adresohen shumë pak nga qeveria e Kosovës. Projekti tjetër avokues përmes kulturës ishte projekti me titull **Arts in Action** i cili u zhvillua në Plemetinë, fshat i komunës së Obiliqit, ku ky komunitet jeton me shumicën serbe. Ky projekt përmes artit dhe me pjesëmarrje të 50 të rinjëve nga Kosova, Gjermani dhe Franca përmes aktiviteteve të ndryshme artistike ngritën çështje për tu adresuar nga qeveria dhe përveç tjerash tipike për keto komunitete u adresua edhe çështja e ndotjes në këtë komunë. Projekti përfundoi me një performansë në qendër të Prishtinës me 3 shtator, 2011. Në fund të vitit u përkrah edhe një iniciativë rajonale avokimi përmes artit vizuel **Don't look me down** i cili përmes fotografive të komuniteteve RAE në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe Malin e Zi do të portretizoj pjesëtarë të këtyre komuniteteve nga shtresa të ndryshme duke dokumentuar nga një rast se kur ata u ndien të diskriminuar. Që të tri projektet u përkrahën në

Lista e granteve:

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Filmi Dokumentar të Çrënjosurit	Romedia Foundation	7 940
Traskriptimi, titllimi, kopjimi i filmit dokumentar të Çrënjosurit	Operational	2776.52
Një mbrëmje me RAE-promovim i Magazinës Evropiane dhe kulturës RAE	Operational	6 776.17
Rolling Film Festival	Balkan Sunflowers	14 000
Art in Action	GAIA	6 500
Don't look me down	Morina Films	5 250
Drama Shtatë maskat e bardha	Theater Company Moissi	3 600

bashkëpunim dhe ko-financim me Roma Cultural Program të OSI Budapest.

3. Intensifikimi i dialogut publik mbi integrimin e komuniteteve pakicë dhe decentralizimi i komunave e banuar me komunitete pakicë.

Pjesëmarrja qytetare në vendimarrje por edhe partneritet me institucionet lokale të qeverisjes u realizua përmes 40 projekteve që u realizuan për përmbushjen e këtij objektivit të Programi M&R. Programi asistoj në hartimin e 6 planeve veprimi/strategji në 5 komunat e banuara me komunitete pakicë, u monitorua puna e komunës së Graçanicës, u realizua 1 kampanjë e gjërë avokimi për regjistrim të popullsisë në tërë Kosovën e përcjellur në fund me një tryezë diskutimi, 6 emisione televizive për inkurajim të komunitetit Serb që të marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, u organizuan 10 tryeza diskutimi mbi pozitën e komuniteteve pakicë në komunën e Prizrenit 3 vite pas shpalljes së pavarësisë, u hulumtua pjesëmarrja e komuniteteve RAE në sistemin arsimorë në Gjilan, u vendosën 1 rrjet jo formal i OJQ-ve boshnjake, 1 qendër e OJQ-ve në regjionin e Dragashit, dhe u perkrahen 11 iniciativa komunale në fushat e arsimit, kulturës, mediave, etj.

Përfshirja e OJQ-ve në zhvillimin e agjendave politike komunale dhe monitorimi i punës së komunave u arrit përmes projekteve ne vijim:

Avokimi për të drejtat qytetare në komunën e Graçanicës i cili prodhoj një film dokumentarë dhe një analizë të shërbimeve qytetarëve që komuna e graçanicës i ofron qytatarë. Këto produkte u arritën përmes anketës dhe organizimit të fokus grupeve të të rinjëve, komunitetit të biznesit, dhe OJQ-ve. Ky projekt u realizua nga asociacioni i grave Avenija dhe Media Qendra. Analiza e përfunduar tregoi rezultate interesante dhe përmbanë rekomandime konkrete për avancim të punës së komunës ndaj qytetarëve të vet. Vërehet se banorët e komunës së Graçanicës janë më të knaqur me punët e infrastrukturës ndërsa shumë të pa knaqur me transparencën e komunës në aspekt të punësimit dhe ndarjes së fondeve për OJQ-të. Rezultatet e analizës do të prezantohen në fillim të muajit Mars në Media Qendër në Çagllavicë.

Hartimi i strategjisë për kthim të komunitetit Serb në komunën e Prizrenit-Ky projekt i filluar në fund të vitit 2010 pas më se 25 takime pune në mes të personave të zhvendosur

brenda Kosovës dhe në Serbi, zyrtarëve komunal, shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare si DRC, UNHCR, etj është në proces të aprovimit të në asamblenë komunale të Prizrenit. Procesi i hartimit ishte gjithpërfshirës me pjesëmarrje të strukturave komunale, personave të çvendosur dhe organizatave lokale dhe ndërkombëtare. Për këtë punë është angazhuar Agjencioni për Trajnime dhe Asistenec teknike. Projekti zgjoj interesim të madh ndër organizatat ndërkombëtare dhe donatër të cilët veç treguan interesim dhe përkushtim për ndërtim të shtëpive për të krijuar infrastrukturë për kthim.

Pozita e komuniteteve minoritare në komunën e Prizrenit, tri vite pas shpalljes së pavarësisë

-Projekti i implementuar nga Qendra për Integrim të Komuniteteve e Prizrenit si një ndër organizatat lidere në adresimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në komunën e Prizrenit dhe rrethinë. Ky projekt shqyrtoj se sa kanë përparuar/ngecur të drejtat e komuniteteve pakicë në komunën e Prizrenit dhe në çfarë mënyre mund të përparohet komuna në adresimin e këtyre çështjeve. Për të arritur deri te rezultatet konkrete Qendra organizoj 10 tryeza diskutimi me pjesëmarrje të gjërë duke përfshi përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë komunal dhe ekspert të të drejtave të pakicave. Hartimi i rekomandimeve të dala nga këto tryeza është në proces dhe pritet se dokumenti të prezantohet në prill.

Hulumtimi mbi pjesëmarrjen e komuniteteve RAE në sistemin arsimor në komunën e Gjilanit jep një pasqyrë të qartë se me cilat problemet kyçe për shak të së cilëve vijushmëria e fëmijëve rom në nivelin e ulët dhe atë të mesëm në shkollat me plan program të Kosovës është i ulët dhe pse ky komunitet vendosë që fëmijët e tyre të vijnë në mësimin në sistemin arsimor paralel me plan program të Serbisë dhe shpeshë herë për këtë udhëtojnë edhe nga 8 kilometra largë vendbanimeve të tyre, përkundër se shkollat tël sistemit të Kosovës i kanë pran. Ky hulumtim shpalosë edhe shumë probleme tjera të qeverisjes së dyfishtë në këtë komunë dhe si ka ndikuar decentralizimi në këtë aspekt. Hulumtimi është i përfunduar dhe do të prezantohet në afat shumë të shkurtër kohor.

Përfshirja e OJQ-ve në aktivitetet e pararegjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare mobilizoj 18 OJQ të komuniteteve prej të cilave 6 ishin të komuniteteve RAE, 3 të komunitetit Serb, 8 të komunitetit Boshnjak dhe 1 e komunitetit Turk. Një ndër sfidat më të rëndësishme të pjesës së parë të vitit ishte

procesi i regjistrimit të popullsisë i cili për herë të fundit në Kosovë u administrua para 30 vjetësh në 1981. Këtë sfidë të rëndësishme për tërë popullsinë e Kosovës programi i Minoriteteve dhe Roma e priti i përgaditur me agjendë të zhvilluar bashkarisht me OJQ-të e komuniteteve pakicë gjatë një punëtorie e cila u organizua me qëllim të paraprirjes së këtij procesi në dhjetor të vitit 2010. Kjo punëtori mundësoi pjesëmarrësit të njoftohen pikë së pari me domethënien e regjistrimit të popullsisë, që ishte një ndër problemet kyçe të cilat në masë të madhe shkaktonin frikë dhe konfuzion ndër komunitetet minoritare, ndërsa në anën tjetër kjo punëtori u shfrytëzua edhe për planifikimin e iniciativave të ndryshme bashkëpunuese për adresimin e sfidave të regjistrimit të popullsisë. Në këtë periudhë një numër i madh i OJQ-ve minoritare i dhanë prioritet bashkëpunimit për të ndikuar në suksesshmërinë e regjistrimit të popullsisë duke implementuar projekte informimi por edhe projekte inkurajimi për deklarim të përkatësisë etnike, gjë që u pa e rëndësishme së madhe sidomos ndër komunitetet Rom, Ashkali, Egjiptian, Boshnjak e Goran. Te komuniteti Serb kjo sfidë ishte më shumë e natyrës politike se e mos njohjes së procesit dhe domethënies së regjistrimit të popullsisë, edhe pse kishte edhe raste të tilla.

50

Përveç informimit të drejtë mbi regjistrimin e popullsisë dhe për çka saktësisht përdoren të dhënat e mbledhura, deklarimi i përkatësisë etnike ishte një ndër sfidat kryesore për komunitetet Rom, Ashkali, Egjiptian, ndërsa komunitetet Bosnjak dhe Goran u ballafaqonin edhe me tendencën të presionit për t'u deklaruar ndryshe se që ata ndihën.

Për të adresuar nevojat e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian Fondacioni mbështeti 6 OJQ për një kampanjë të gjërë, në tërë teritoin e Kosovës duke përfshirë këtu edhe enklavat Serbe. Rrjeti prej pesë OJQ-ve i udhëhequr nga Balkan Sunflowers organizoi kampanja informuese në dy forma: "shtëpi për shtëpi" dhe takime nëpër qendra të komunitetit. Edhe pse ende nuk ka të dhëna të përpunuara nga Enti Statistikorë i Kosovës mbi strukturën etnike të banorëve të Kosovës vizitat e rrjetit të OJQ-ve pas regjistrimit treguan se kjo kampanjë kishte ndikuar pozitivisht si në pranimin për tu regjistruar të një numri mjaft të madh të atyre të cilët kishin fikë nga ky proces dhe në të njejtën kohë në deklarimin e përkatësisë etnike.

Për të adresuar nevojat e komuniteteve Boshnjake dhe Gorane u përkarahen 8 OJQ të cilët përmes vizitave "shtëpi për shtëpi" organizuan edhe disa tryeza të rrumbullakëta ku u diskutua

mbi identitetin e të gjitha grupeve nëngrupeve të cilat shpesh përmbledhen në një dhe përmes këtyre diskutimeve u ndikua pozitivisht në uljen e tensioneve të ngritura dhe akuzave ndaj njëri tjetrit për tentim të asimilimit.

Edhe organizatat e shoqërisë civile të komunitetit Serb e panë këtë moment si shumë të rëndësishëm dhe duke pas parasysh se natyra e hezitimit për tu regjistruar ishte krejtësisht e ndryshme nga ajo e komuniteteve tjera edhe çasja ndaj këtij komuniteti ishte në një format të ndryshëm se ai që u aplikua për komunitetet tjera. Problemi politik dhe presioni nga Beogradi për tu mos regjistruar kërkonte një mesazh më të fuqishëm dhe më të qartë për banorët Serb të Kosovës. Fondacioni mbështeti 3 iniciative dy prej të cilave kishin format të ngjashëm me ato për komunitetet tjera dhe ishin të disajnuara si kampanja informuese dhe promovuese sidomos në vendet më të vogla të banuara me komunitetin Serbe ku nuk kishte radio apo televizion lokal të fuqishëm apo të vullnetëshëm për një kampanjë informuese inkurajuese, ndërsa iniciativa e tretë ishte një seri prej 8 emisioneve diskutimi mbi regjistrimin e popullsisë në RTK.

Skema e granteve të vogla u tregua të jetë një ndër mënyrat më të përshtatshme për të adresuar nevojat e komuniteteve minoritare të cilat jetojnë në zonat rurale/të largëta të Kosovës. Ky lloj i aktiviteteve mbanë komunitetet e angazhuara dhe promovon aktivizmin civil. Fondacioni mbështeti edhe 17 projekte të OJQ-ve të cilat veprojnë në viset rurale dhe larg mundësi për të fituar ndonjë përkushtim më të madh nga qeveria si ajo lokale ashtu edhe ajo qendrore. Këto projekt të ndërtimit të komuniteteve mbulojnë nevojat e komuniteteve për tu angazhuar si në sferën e kulturës ashtu të arsimit, medieve, mbrojtjes së ambientit etj.

Lista e granteve:

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Javno zastupanje gradjanskih prava u opštini Gracanica	UPZ Avenija	9 000
Hartimi i strategjisë dhe planit të veprimit për kthim të qëndrueshëm të komunitetit Serb në komunën e Prizrenit	Academy for Trainings and Technical Assistance	2 500
Pozita e komuniteteve pakicë në komunën e Prizrenit 3 vjet pas shpalljes së pavarësisë	Center for Integration of Ethnic Communities	8 500
Hulumtim: Pjesëmarrja e komuniteteve RAE në sistemin arsimorë të Kosovës	Operational	4 476.50
Census awareness campaign for RAE communities through out Kosovo	Balkan Sunflowers Kosova	14 000
Regjistohu!	Initiative 6	3 142.50
Mbroje identitetin tënd	Initiative for Action	2 717
Kampanjë për regjistrimin e popullsisë përmes Radio Romano Avazo	Durmish Aslano	940
Kampanja za popis stanovnistva u Plemetini	Romano Resaibe	1 229
Pokazi da postojis-6 debate televizive	Link Production	10 000
Doprinos popisu stanovnistva	Center for Integration of Ethnic Communities	3 787
Ukljuci se i ti	The Congress of Bosnian Intellectuals in Kosova	3 855
Kosovo je moj dom	NGO Relax	2 735
Upisi bliznjeg svog	Katedra Slobodnog Uma	2 315
Ja hocu popis	Youth Organization Krusevo	3 470
Podizanje svesti o vaznosti popisa kod zena u regionu Zupe i Gore	NGO Equality	4 748
Radio kampanja za popis stanovnistva u regionu Peci	Radio Astra	780
Okrugli sto: Popis kako Izazov	Udruzenje Bosnjaka Kosovski Avaz	3 150
Support to Kosovo minority participation at census process in Strpce municipality	Future without Fear	4 897.50

Project title	Grantee	Grant Amount
Enhancing minority turnout at Kosovo census	Youth Rights Promotion Center, Partesh	5 955
Regjistrohu për te ardhmen tënde	Turkiye Mezunlari Dernegi	4 455
Samo vas pitamo	NGO Dona	3 000
Mountain for all	Scardus	3 750
Gostovanje pozorisne predstave iz Crne Gore u regionu Peci	Udruzenje Crnogoraca Lovcen	2 500
Shkolla verore multietnike	Visioni 02	1000
Kuda posle srednje skole	Utilis	2 000
Zhvillimi i kulturës përmes aktiviteteve teatrore	SHKA Gercek	2 000
Obelezavanje dana srzavnosti Crne Gore na Kosovu	Udruzenje Crnogoraca Kosova	1 500
Obelezavanja dana Bosnjaka Kosova	Vijece Kongresa Bosnjakckih Intelektualaca Kosova	500
NVO Centar u opstini Dragas	Omladinski centar Krusevo	2 990
Osnovanje omladinskih saveta u opstini Ranilug i Partes i olaksavanje ucesca mladih u donosenju odluka	Centar za Socijalnu Afirmaciju Mladih	4 500
Otvoranje Crnogoske Kuce	Udruzenje Crnogoraca Kosova	1 000
Zgjimi me Artin	Shoqata e Artisteve Turk te Kosovës	1 500
Izlozba tradicionalne osnjacke nosnje	Mladi Talenti	200
Zimski, Novogodisnji program za decu u opstini Strpce	NGO Dona	2 500
Magazina në gjuhën Rome Yekhipë	NGO Sakuntala	5 000
Shënimi i ditës së Ashkalive	Rezet e Arta	1 500
Kultura-ura lidhëse në mes të komuniteteve	Shtëpia e shokëve	2 000
Drama në gjuhën Rome me rastin e shënimit të ditës ndërkombëtare të Romëve 8 Prilli	Durmish Aslano	4 000
Përkthimi i romanit 1000 lotuset në gjuhën rome	NGO Sakuntala	2 000

4. Fuqizimi i kapaciteteve të OJQ-ve të pakicave (think tank) për të avokuar dhe promovuar agjendat e politikave zhvillimore publike dhe ngritja e bashkëpunimit

Nëpërmjet këtij objekti Fondacioni synon që të rris kapacitet e OJQ-ve të pakicave (think tank) për të avokuar për ndryshimin/avancimin e politikave publike që adresojnë nevojat e komuniteteve pakice dhe në të njëjtën kohë të ngris bashkëpunimin në mes të OJQ-ve "pakicë-shumicë".

Për t'i adresuar këto sfida dhe për të arritur rezultate sa më konkrete programi përdori mekanizmat avokues që posedon Fondacioni si Forumin 2015 përmes së cilit u prezantuan katër studime mbi çështjet më të rëndësishme të gjashtë komuniteteve pakicë e që synonin partitë e tyre politike që garonin në zgjedhjet e parakohshme. Dialogu Kosovë-Serbi shënoj ngritje të bashkëpunimit pakicë-shumicë përmes disa projekteve të cilat fituan edhe vemendje mediale dhe ndikuan që komunitetet pakicë të paraqesin opinjonet dhe shqetësimet e tyre, ndërsa kapanjat e para regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare ndikuna në ngritje të bashkëpunimit në mes të OJQ-ve dhe formim të rrjeteve jo formale, regjionale apo edhe tematike. Për të plotësuar këtë objektiv Programi M&R i përkrahi 11 projekte të cilat u zbatuan apo janë ende në zbatim nga më shumë se 35 organizata dhe individ.

Zhvillimet e shumta politike në Kosovë si zgjedhjet e parakohshme, regjistrimi i popullsisë, dialogu Kosovë-Serbi si dhe tensionet në Veri të Mitrovicës shënuan vitin 2011. Të gjitha këto zhvillime patën ndikim edhe në komunitetet pakicë të cilët nuk mbetën të heshtur dhe inert por treguan iniciativë dhe vepruan për të kontribuar në të kuptuarit më të mirë të këtyre proceseve prej komuniteteve të tyre repektive por edhe shpalosjen e qëndrimeve të tyre karshi qeverisë së Kosovës e edhe ndaj asaj të Serbisë kur bëhej fjalë për dialogun apo tensionet e vjeshtës në Veri të Mitrovicës.

Investimi në organizata të qëndrueshme, dinamike dhe me aftësi profesionale për të adresuar çështje të rëndësishme politike dhe zhvillimore është një prej parakushteve për të arritur rezultate dhe ndryshime në shoqëri. Për këtë arsye Programi M&R ka krijuar partneritet me një numer të OJQ-ve/Think Tank me të cilët në partneritet realizon projekte operacionale dhe i përkrahë me projekte që përputhen me drejtimet strategjike të Fondacionit.

Dialogu Kosovë-Serbi u adresua me 4 projekte 2 prej të cilëve ishin projekte bashkëpunimi në mes të organizatave shumicë-pakicë. KIM radio realizoi projektin **Debate about talks** përmes së cilit u përgaditën 24 emisione/diskutim në radio mbi dialogun dhe rezultatet tij si dhe senzibilizimi i komunitetit Serb për rëndësin që ky dialog do të ketë në jetën e përditshme të tyre. Mysafirë në emisione ishin përfaqësues të qeverive të të dy palëve, përfaqësues politik të komuniteteve pakicë, ata të shoqërisë civile, intelektual të pavarur, etj. Këto emisione u transmetuan në mbarë Kosovës dhe në të gjitha komunat/regjionet ku jeton komunitetit Serb përmes linkut të vendosur në mes të radio stacioneve lokale.

Një projekt tjetër që synoj diskutime dhe analizim të qëndrimeve të qytetarëve mbi dialogun Kosovë Serbi sihte projekti **Bridge: Kosovo-Serb Civil Dialogue** i cili sjelle së bashku një rrjet 15 radio; 3 radio serbe nga veriu i Kosovës, 3 radio serbe nga Kosova qendrore dhe jugore, 4 radio stacione të shumicës shqipëtare dhe 5 radio stacione lokale nga Serbia të cilat përmes emisioneve informative dhe diskutimi informuan ndëgjuesit në Kosovë dhe Serbi mbi rrjedhjen e dialogut dhe në të njëjtën kohë ballafaquan intelektual nga të dyja anët për të shpalosur mendimet e veta mbi çështjet e trajtuara në seansat e dialogut. Ky projekt vazhdon edhe në 2012 me fonde të donatorëve tjerë pasi u vlerësua si një projekt i suksesshëm i cili arriti sensibilizoj opinionin mbi domosdoshmërinë e zgjidhjes së problemeve përmes bisedimeve, dialogut dhe arriti të ngris kulturën e diskutimit publik në një shkallë më të lartë. Ky projekt pati një eko edhe në mediat e shkruara në Serbi dhe ato ndërkombëtare.

Pas rundit të parë të dialogut dhe marrëveshjeve të para u përkrah projekti: **Të kuptuarit e dialogut: Një shënim mbi bartësit e dialogut**, kompetencat dhe opinionet ekzistuese në përkufizimin e tij nga palët e interesit i cili përveç synimit që të jep një sqarim të kompetencave dhe rolit të qeverisë, kuvendit dhe presidencës, të sqaroj qëllimin dhe strukturën e dialogut ka për qëllim edhe të vej në pah opinionin e përfaqësuesve të gjitha komuniteteve etnike që jetojnë në Kosovë, si dhe qëndrimet e tyre në lidhje me konkluzionet e arritura. Ky projekt deri më tani janë mbajtur 4 tryeza diskutimi me tamat në vijim: (1) "Dialogu Kosove-Serbi pas ngjarjeve të fundit në veri të Kosovës". (2) "Marrëveshja e Vulave Doganore në mes Kosovës dhe Serbisë" (3) Rreziqet nga Paradigma Ahtisaari Plus: Çfarë mendojnë liderët e komuniteteve etnike në Kosovë?", (4) Një Agjendë Gjithëpërfshirëse për Veriun: Cilës Zgjidhje i Referohet Komisioni Ev-

ropian në Strategjinë e Zgjerimit 2011-2012?”. Diskutimet publike u përcollën me 3 hulumtime/ analiza: (1) Marreveshja mbi Vulat Doganore ne mes Kosovës dhe Serbisë: Sfidat dhe e ardhmja, (2) Sfidat nga një Paradigme Ahtisaari Plus: Një zgjidhje unike apo e ndare për komunitetet etnike ne Kosovë, (3) Një Agjende Gjithpërfshirëse për Veriun: Një qasje e re evropiane. Projekti vazhdon deri në Mars 2012.

Projekti Kosovo Serb Community: Integration, Challenges and Prospects është një projekt hulumtimi të cilin e realizon Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi përmes së cilit do të ekzaminohet progresi i arritur në implementim të planit të Ahtisaar-it dhe me cilat sfida ballafaqohet komuniteti Serb në komunat e decentralizuara. Hulumtimi do të prezantohet në fund të Marsit, ndërsa i njëjti do të vendosë bazë për diskutim publik gjithëpërfshirës me komunitetin Serb dhe komunitetet tjera pakicë në Kosovë, duke i mundësuar kështu edhe senzibilizimin e qeverisë së Kosovës, komunitetin ndërkombëtarë dhe institucionet e qeverisjes lokale mbi sfidat me të cilat ballafaqohet komuniteti Serb në procesin e integrimit politik dhe socio-ekonomik.

Projekti Dialogu (intra) Serb i cili realizohet nga Media Qendra ka për qëllim të krijoj një platformë jo-formale të përfaqësuesve të komunitetit Serb në të cilën do të diskutohen tema që ndikojnë në kualitetin e jetës së tyre dhe intergimin në shoqërinë Kosovare. Poashtu do të ndikoj në përaftimin e qëndrimeve të komunitetit Serb në mes veti. Dialogu Kosovë-Serbi, por edhe shumë ngjarje të tjera përpara dhe në ndërkohë tregojnë se qëndrimet e komunitetit Serb në Kosovën qendrore dallojnë mjaft nga ato të të njëjtit komunitet i cili jeton në Veri, regjionin e Gjilanti apo në Shtërpe. Për këtë arsye u pa e nevojshme që të këto qëndrime të përballen në tryeza diskutimi dhe përveç të ngritjes së kulturës së diskutimit të arrihet deri te pozicionet së paku të përafërta për sa i përket rrjedhave kryesore politike dhe zhvillimore dhe në këtë mënyrë të ndikohet në arritjen e qëndrimeve konstruktive dhe reale. Deri më tani është organizuar një diskutim, ndërsa deri në fund të projektit do të mbahen edhe 25 të tjera. Secili diskutim do të përcjellet me një policy brief dhe rekomandime për fushën e caktuar i cili do të postohet në web faqen e Mida qendrës dhe KIM Radios dhe menjëherë pas do të diskutohet edhe në emisione në KIM radio dhe programin e tyre televiziv.

Lista e granteve

Project Title	Grantee	Grant Amount
Talk show Slobodno Srpski	New Press Production	10 000
Debate about talks	KIM Radio	9 000
Bridge: Kosovo-Serbia Civil Society Dialogue	Independent News Center	8 994.50
Të kuptojmë dialogun: Një shënim mbi bartësit e dialogut, kompetencat dhe opinionet ekzistuese në përkufizimin e tij nga palët e interesi	Grupi për Studime Juridike dhe Politike	4 110
Serb-Serb (intra) Dialogue	Media Center	9 500
Kosovo Serb Community: Integration, Challenges and Prospects	Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi	10 000
Strpce Civil Forum	Future Without Fear	9 000
Waiting for Mitrovica	Samir Ramixhiku	9 000
Ustavne promjene o izboru predsjednika Kosova	Utilis	1 500
Izrada platforme o zajednickom delovanju i saradnji bosnjackih NVOa	Centar za Integraciju Etnickih Zajednica	6 000
U susret izmjenama izbornog zakona na Kosovu	NGO Relax	1 140

#4 [Programi i Shoqërisë Civile]

#4 Programi i Shoqërisë Civile

Prioriteti kryesor i Programit të Shoqërisë Civile edhe në vitin 2011 mbetet i njëjti, ngritja e kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile për të ndikuar në proceset e politikave që ndikojnë zhvillimin politik, ekonomik dhe social të Kosovës. Në veçanti, programi do të vazhdojë të mbështesë OSHC-të në monitorimin dhe avokimin për një qeveri transparente dhe të përgjegjshme, si dhe mbështetjen e zhvillimit të marrëdhënieve në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë. Mbështetja e këtij procesi është një prioritet kyç i Programit të Shoqërisë Civile.

Programi i Shoqërisë Civile është unik në punën e tij: ofrimi i granteve dhe mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të organizatave dhe zbatimin e iniciativave të veta operacionale. Duke punuar në partneritet me shoqërinë civile, përpiqet për të ndërtuar marrëdhënie në mes të saj dhe qeverisë., Programi i Shoqërisë Civile do të vazhdojë të zhvillojë kapacitetin lokal për të kërkuar nga qeveria të jetë e përgjegjshme dhe transparente dhe krijimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike. Kjo çasje ka mundësuar që Programi i Shoqërisë Civile të zhvillojë një rol të veçantë në nxitjen, lehtësimin dhe udhëheqjen e një debati të gjerë në çështjet prioritare në Kosovë.

Iniciativat për Transparencë, Llogaridhënie dhe Avokim

Kosova sot ka një numër të think tank dhe të watch dog organizatave që sigurojnë një presion të përhershëm civil në institucionet publike dhe në projekte të mëdha zhvillimore. Fondacioni është duke i mbështetur projektet e këtyre organizatave, si edhe nëpërmes granteve institucionale që iu jep mundësi organizatave të jenë më produktive dhe të rrisin efektin e punës të organizatave që grantohen.

Programi i Shoqërisë Civile i përkushtohet inkurajimit dhe mbështetjes së aktiviteteve të OJQ-ve të cilat synojnë ruajtjen dhe monitorimin e qeverisjes së mirë bazuar në parimet kryesore. Programi mbështet ato aktivitete të cilat me kujdes monitorojnë formulimin dhe miratimin e politikave në bazë të parimeve të transparencës, llogaridhënies, efektivitetit, përfshirjes dhe barazisë.

Projektet e mbështetura për gazetari hulumtuese

Një prej projekteve të mbështetura për gazetari hulumtuese është ai i BIRN-it. Ky projekt është fokusuar në arritjen e objektivave specifike si: lufta kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës lidhur me shpenzimet publike në Kosovë, zhvillimi i kapaciteteve të mediave, promovimi i punës së OJQ-ve, ngritja e vetëdijes lidhur me çështjet e integritimit Evropian, sigurimi i raportimit të paanshëm, nxitja e bashkëpunimit mes komuniteteve lokale dhe bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, si dhe insistimi në ngritjen e përgjegjësisë.

Segment i posaçëm i veprimit të Programit ka qenë mbështetja e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, dhe atë kryesisht duke përkrahur organizata civile (hulumtuese) dhe jo-doemos mediat, siç janë BIRN (Prishtina Insight dhe TV reportazhet) dhe Çohu. Lidhur me këtë, në bashkëpunim me Forum 2015 Programi ka organizuar edhe debata lidhur me gazetarinë publike si dhe ka botuar hulumtime të caktuara të këtyre organizatave.

Debatet dhe raportet televizive, në të cilat kanë qenë të përfshirë nëpër intervista dhe diskutime njerëz të për çështjet e lartpërmendura, janë transmetuar në mediat kosovare dhe kanë pasur mjaft të madh. Për më shumë, këto debate në shumë raste janë vënë në dispozicion online për shikues në faqet e internetit

Përmes mbështetjes së vazhdueshme të KFOS-it, Prishtina Insight ka arritur të krijojë një brez të ri të gazetarëve profesionistë, të cilët janë në gjendje të prodhojnë raporte hulumtuese të paanshme dhe profesionale. Pesë gazetarë (katër të trajnuarit dhe një gazetar me përvojë) e kanë ndjekur trajnimin gjatë kryerjes së punës, të cilët janë angazhuar në hulumtim lidhur me temat që janë trajtuar gjatë projektit. Në ndërkohë, ata ishin të mbikëqyrur dhe të këshilluar nga një redaktor me përvojë të gjatë, i cili u ka dhënë atyre këshilla profesionale, duke u ndihmuar kështu në zhvillimin e tyre gazetaresk.

Projekti i dytë është ai i OJQ Çohu, i cili si objektiv pati realizimin e raporteve hulumtuese në fushën e gazetarisë, në kuadër të Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese QKQH. Për më tepër objektivë tjetër ishte edhe ngritja e kapaciteteve të Qendrës për raportimet hulumtuese si dhe nxjerrja në pah e temave të ndryshme socio-ekonomike veçanërisht rreth kompanive publike dhe këshilltarëve të transaksionit. Në kuadër të këtij projekti QKQH ka angazhuar 3

gazetarë me orar të plotë, puna e të cilëve do të përqendrohet në gazetari hulumtuese dhe do të jetë në shërbim të Qendrës.

Përveç kësaj, QKGH ka angazhuar edhe 4 gazetarë profesionalë si bashkëpunëtorë të jashtëm. QKGH me ndihmën e gazetarëve ka realizuar numrin e ri të Gazetës Preportr e cila u botua si shtojcë në të përditshmet Koha Ditore dhe Zëri, gazeta të përditshme me tirazh mjaft të lartë të shitjes në vend. Përmbajtja e këtij numri të gazetës iu përkushtua kompanisë më profitalible në vend Postës dhe Telekomit të Kosovës, PTK-së, si dhe këshilltarëve të transaksionit që rezultuan me paqartësi dhe konflikte interesi. Përveç kësaj në kuadër të këtij projekti janë realizuar edhe 5 hulumtime tjera gazetareske me përmbajtje socio-ekonomike, të cilat u botuan në të ueb-portalin Preport si dhe në gazeta të ndryshme ditore.

Sukses i këtij projekti mund të konsiderohet numri i ri i gazetës Preportr, përmbajtja e të cilës iu përkushtua Postës dhe Telekomit të Kosovës. Ky numër i gazetës u përshtat fare mirë duke vënë të vërteta në pah lidhur me tërheqjen e Telekomit Kroat nga procesi i privatizimit, dyshimet e tyre se ky proces ishte i përcaktuar qysh më herët dhe se nuk pati garë të mirëfilltë. Poashtu kjo gazetë elaboroi në detaje dyshimet dhe parregullsitë në Z –mobile, si dhe operatorin Plus. Përmëtepër në këtë numër u analizua edhe roli i këshilltarëve të transaksionit dhe konfliktet e tyre të interesit në këtë kompani.

Monitorimi i Komunave

Në vazhdimësi Fondacioni përkrahë projektet për monitorim të Komunave. Janë mbështetur tri projekte, ai për monitorimin e Komunës së Prishtinës nëpërmes OJQ INPO, për monitorimin e Komunës së Skenderajt nëpërmes OJQ Prehja dhe monitorimi i Komunës së Prizrenit nëpërmes OJQ Ec Ma Ndryshe. Më poshtë janë informata të përgjithshme për mbarëvajtjen e këtyre projekteve.

INPO e ballafaquar me një ambient jo të përshatshëm për të kryer misionin (praktika kundërligjore të funksionimit, papërgjegjësi në punë, mungesë transparence e llogaridhënese dhe injorim të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile) e saj dhe ka filluar disa procedurat ligjore pranë Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për përgjegjësi nga organet Komunale. Zgjidhja e rastit të parë tek Avokati Popullit është shumë inkurajuese. Avokati i Popullit në Raportin me Rekomandime ka aprovuar ankesën e INPO-s dhe arsyetim ligjor të saj. Në këtë mënyrë Avokati i Popullit i ka vlerësuar veprimet kufizuese të komunës

kundër qytetarëve dhe OJQ-ve si kundërligjore dhe kundër-kushtetuese. Për më tepër e ka vlerësuar se Rregullorja për Transparencë e komunës Prishtinës është kundër parimeve Kushtetuese të cilat kërkojnë transparencë dhe përfshirje të qytetarëve në vendim-marrje duke kërkuar ndryshimin e saj.

Monitoruesit e INPO-s kanë vazhduar me monitorimin proaktiv të punës së organve të komunës së Prishtinës, përfshirë Kuvendin Komunal, Ekzekutivin e Komunës dhe zyrën e prokurimit. Ky monitorim është realizuar duke analizuar funksionimin e tyre në tri aspekte: respektimin e kërkesave dhe procedurave ligjore, vlerësimin profesional, efikasitetin dhe zbatueshmërisë të akteve dhe veprimeve të tyre, dhe në respektimin e parimeve të transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në procese vendim-marrëse. Nga ky monitorim kanë rrjedhur shumë reagime për keq-qeverisje, reagime në media, rekomandime për komunën dhe presion publik. Të gjeturat do të publikohen më detajisht në raportin vjetor të monitorimit. Sipas vlerësimeve të TACSO organizata INPO vazhdon të mbetet një prej organizatave më të cituara dhe më të pranishme në mediat në Kosovë. Kjo duke përfshirë shtypin e shkruar, portalet elektronike, televizionet kombëtare (disa herë në lajme qëndrore të televizioneve kombëtare). Kështu INPO është duke luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e problemeve të cilat duhet adresuar nga komuna, ngritjen e vetëdijes qytetare për rolin e komunës dhe është duke funksionuar si një lloj mekanizmi për presion ndaj Komunës së Prishtinës. Qëndrimet e INPO vlerësohen nga mediat dhe aktorët tjerë si profesionale, të paanshme dhe tejet të rëndësishme për kryeqytetin.

Projekti i monitorimit të Komunës së Skenderajt do të implementohet deri në qershor të vitit 2012. Dy muajt e parë të fillimit të realizimit të projektit, janë vlerësuar të jenë të suksesshëm, në disa fusha të caktuara, në të cilat është krijuar mundësia për përmirësimin e performancës së pushtetit lokal, pas monitorimit të punës, si dhe rekomandimeve të Ekipit Monitorues lidhur me çështjet që lidhen me interesin e qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe është arritur objektivi, që kishte për synim nxitjen dhe forcimin e shoqërisë në fushën e avokimit për transparencën e pushtetit lokal dhe llogaridhënien. Është mbajtur debati i parë me temën "Transparenca e pushtetit lokal dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve", në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e pushtetit lokal, OSBE-ja, KFOR-i, përfaqësues të partive politike, shoqëria civile, OJQ, mediat, etj. Debati, gjithashtu, ka nxjerr disa rekomandime për pushtetin lokal, të cilat janë vlerësuar nga të pranishmit si të domosdoshme për punën e autoriteteve lokale në raport me transparencën publike dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve. Këto

rekomandime do të përfshihen edhe në manualin që do të botohet pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore të monitorimit të punës së pushtetit lokal në Skenderaj. Faza fillestare e projektit Transparenca on-line e Komunës së Prizrenit, dakordimi me qeverinë lokale të Prizrenit për monitorimin e ekzekutivit ka përfunduar me sukses. Përmes marrëveshjes me komunën e Prizrenit, EC Ma Ndryshe ka siguruar qasje në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e ekzekutivit të komunës së Prizrenit, për procesin e monitorimit të veprimtarisë së zyres së Kryetarit të komunës dhe resorëve tjerë të ekzekutivit. Paralelisht la filluar zhvillimi i web aplikacionit, i cili do të jetë sistem i grumbullimit dhe klasifikimit të të dhënave që dalin nga procesi i monitorimit. Në momentin e publikimit të web-faqes së transparencës online, në këtë web-faqe do të vendosen të gjitha të dhënat, në mënyrë automatike nga procesi i monitorimit të ekzekutivit. Deri tani, monitorimi i ekzekutivit ka prodhuar disa të dhëna relevante, të cilat në formë të përpunuar do të publikohen në web-faqen e projektit. Një nga efektet e para të këtij projekti është vërejtur në ndryshimin e qasjes së qeverisë lokale në raport me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin dhe miratimin final të Rregullores për Transparenca të komunës së Prizrenit, një obligim ligjor i të gjitha komunave të Kosovës. EC Ma Ndryshe ka qenë drejtpërdrejtë e angazhuar në përgatitjen e versionit përfundimtar të kësaj Rregulloreje, e cila është edhe bazë e procesit të monitorimit të transparencës komunale. Pas përfundimit të fazës së monitorimit dhe raportimit për të gjeturat, nga vjeshta e vitit 2012, EC Ma Ndryshe është duke përgatitur fillimin e fazës së dytë të këtij projekti. Pasi që të krijohet një bazë e qëndrueshme e të gjeturave dhe të dhënave nga monitorimi i ekzekutivit, projekti do të nisë fazën e avokimit dhe referimit të të gjeturave problematike për adresim të ligjshmërisë.

Tabla e Granteve

Emri i Projektit	Grantist	Shuma
Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në Komunën e Prishtinës	INPO	9360
Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN	9925
Seminar: Sfidat në procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve rregulluese urbane	Asociacioni i planerëve	1708.64
Qendra Kosovare për gazetari hulumtuese	OJQ COHU	10.000
Të kuptojmë dialogun: Një shënim mbi bartësit e dialogut, kompetencat dhe opinionet ekzistuese në përkufizimin e tij nga palët e interesit»*	Grupi për studime Juridike dhe Politike	5000
Përmisimi i pozitës së pensionistëve	Sindikata e pensionistëve të Kosovës	2000
Monografia e Mehmet Gjevorit	Shtypshkronja Dukagjini	1200
Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar mbi të Drejtat e Njeriut "Një Botë"	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut	8100
Baby (revolution) comeback	Stacion CCA	4500
Përpilimi i udhëzuesit për shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës	5000
Krijimi i fondit për ndihmë për shkollimin e vajzave të shkollave fillore, të mesme dhe fakultete	Grupi i Veteranëve të Arsimit	2000
Monitorimi i punës të Komunës së Skenderajit	OJQ "Prehja"	7440
Prezantimi dhe promovimi i të drejtës në privatësi në Kosovë	OJQ LENS	7250
Transparenca on-line e komunës së Prizrenit	OJQ Ec Ma Ndryshe	7450

*Vlera totale e këtij projekti të mbështetur prej nesh është 9110 Euro. Shuma prej 5000 Eurove është ndarë nga Programi i Shoqërisë Civile dhe shuma prej 4110 Eurove nga Programi i Minoriteteve dhe Roma

Bashkëpunimi në mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile

Platforma CiviKos

Duke filluar që nga fundi i muajit Korrik 2010, Platforma CiviKos ka kontaktuar rreth gjashtëdhjetë e pesë organizata të shoqërisë civile (65), me qëllim të njoftimit të tyre lidhur me nismën për rifunksionalizimin e CIVIKOS dhe ftesën për anëtarësim. Si rrjedhojë, deri më tash kemi pesëdhjetë organizata anëtare në Platformën CiviKos. Kontaktimi dhe anëtarësimi i organizatave të tjera në CIVIKOS është ndaluar përkohësisht, me qëllim të organizimit të Kuvendit Zgjedhor të CIVIKOS. Anëtarësimi i organizatave tjera në CIVIKOS do të jetë aktivitetet i vazhdueshëm

● Publikimi i analizës mbi praktikat e mira të vendeve të rajonit dhe Europës në bashkëpunimin në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike

Me 10 Shkurt, 2011, në sallën e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është bërë prezantimi i analizës së praktikave të mira të bashkëpunimit në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike, të cilin e ka shoqëruar diskutimi rreth situatës aktuale të bashkëpunimit të dy sektorëve në Kosovë, si dhe qasjen që duhet ta ketë shoqëria civile karshi bashkëpunimit me autoritetet publike. Në takim morën pjesë rreth gjashtëdhjetë (60) organizata të shoqërisë civile nga mbarë Kosova. Në mesin e tyre kishte organizata anëtare të Platformës CiviKos, por edhe organizata tjera aktive të interesuara për këtë fushë. Për bërjen e analizës është kontraktuar Amir Haxhikadrija, duke u bazuar nga përvoja që ka si anëtar me përvojë të madhe në sektorin e shoqërisë civile në Kosovë dhe njohës i mirë i sektorit të shoqërisë civile dhe rrethanave politike në Kosovë.

● Takimet e grupeve të vogla

Si rekomandime të dala nga diskutimi mbi nevojën e bashkëpunimit të sektorit të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Kosovë, ishin takimet e grupeve të vogla të cilat do të punoni në identifikimin e çështjeve kyçe të komponentëve kryesorë të strategjisë së bashkëpunimit:

1. Avancimi i kornizës ligjore për funksionimin e organizatave të shoqërisë civile;
2. Përkrahja financiare (direkte dhe indirekte) për shoqërinë civile;
3. Kontraktimi i disa shërbimeve publike tek shoqëria civile;

4. Fuqizimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendimmarrje;
5. Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e Integritimit European.

Në takimet e grupeve të vogla morën pjesë rreth 30 OShC anëtare në Platformën CiviKos. Në fund të takimit të dytë, të secilit nga grupet punues është bërë përzgjedhja e dy anëtarëve të grupit të cilët do ta marrin pjesë në punëtorinë nacionale për hartim të kornizës së strategjisë së bashkëpunimit.

● Punëtorja për hartimin e draft strategjisë së bashkëpunimit në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Kosovë

Punëtorja për hartim të strategjisë së bashkëpunimit është mbajtur më 2-5 Qershor 2011, në Vila Belvedere, Durrës. Pjesëmarrës në punëtori ishin njëzet e tre përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Pas një pune intensive dhe përkushtimi të madh nga pjesëmarrësit në punëtori, në fund të punëtorisë doli drafti i parë i kornizës logjike të strategjisë së bashkëpunimit në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në Kosovë (shih të bashkëngjitur Kornizën logjike).

Për udhëheqjen dhe moderimin e punëtorisë janë angazhuar z. Arben Shala dhe z. Petrit Tahiri, që të dy nga Qendra e Kosovës për Edukim (KEC) të cilët tashmë janë të dëshmuar në punën e tyre në udhëheqjen dhe draftimin e strategjive.

● Kuvendi Zgjedhor i Platformës CiviKos

Pas konsolidimit të anëtarësisë dhe përgatitjeve të bëra në drejtim të hartimit të strategjisë së bashkëpunimit në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në vend, Platforma CiviKos organizoi Kuvendin Zgjedhor me qëllim të zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të CiviKos dhe legjitimit të plotë të përfaqësimit të të gjitha organizatave anëtare. Kuvendi Zgjedhor i Platformës CiviKos u mbajt më 30 Shtator, 2011. Të pranishëm në Kuvend ishin katërdhjetë e dy pjesëmarrës të organizatave anëtare në Platformën CiviKos, dhe me të drejtë vote 36.

Pas votimit të tridhjetë e gjashtë anëtarëve të Kuvendit, anëtarët e Bordit të CIVIKOS u zgjedhën: Taulant Hoxha (KCSF), Driton Bajraktari (DSK), Ismet Kryeziu (KDI), Petrit Tahiri (KEC), Valbona Salihu (NORMA), Veton Mujaj (Syri i Vizionit), Sihana Mehmeti (KFOS) – (anëtar pa të drejtë vote).

● **Fillimi i bashkëpunimit formal me Qeverinë e Kosovës**

Përmes vendimit të Zyrës së Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është mandatuar përgjegjëse për procesin e hartimit të strategjisë së bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile. Në këtë formë, më 14 Nëntor 2011,

Platforma CiviKos (si nënshkrues e memorandumit të bashkëpunimit me Qeverinë e Kosovës) dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (si bashkëpunëtor të ngushtë) janë ftuar nga ZQM/ZKM për takim konsultativ lidhur me procesin e hartimit të strategjisë së bashkëpunimit. Njëherë, ky takim u karakterizua me fillimin e procesit të hartimit të strategjisë së bashkëpunimit.

Në takim u vendos që të krijohet një grup i vogël, i përbërë nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra Ligjore, Zyra për Planifikim Strategjik, Platforma CIVIKOS (dy përfaqësues) dhe Driton Selmanaj nga KDI. Platforma CIVIKOS në këtë grup do ta ketë rolin kryesor pasi që edhe diskutimi dhe puna mbi draftin e parë të strategjisë së bashkëpunimit do të bazohet në komponentët e strategjisë së hartuar në Durrës nga Platforma CiviKos.

Takimet e grupit do të jenë të rregullta deri në finalizimin e draftit të parë të strategjisë. Më pas, diskutimi mbi draftin e parë do ta zgjerojë grupin duke përfshirë kështu të gjitha palët e interesit, si: zyrtarë qeveritar, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (anëtare në CiviKos dhe të tjera), donatorë potencial etj.

Tabela e granteve

Emri i Projektit	Grantist	Shuma
Hartimi i Strategjisë së bashkëpunimit mes Shoqërisë Civile dhe Qeverisë së Kosovës dhe funksionalizimi i saj	Platforma CiviKos	29.590
Hartimi i Strategjisë së bashkëpunimit mes Shoqërisë Civile dhe Qeverisë së Kosovës dhe funksionalizimi i saj	Platforma CiviKos	19.700

Rrjetëzimi dhe Bashkëpunimi Regjional

Programi i Shoqërisë Civile mbështet organizatat e shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për të rritur bashkëpunimin me organizatat në rajon. Ky është një hap veçanërisht i rëndësishëm në përpjekjet e tyre për t'u bërë më efektive në punën e tyre brenda kufijve të Kosovës, dhe të ndikojnë jashtë kufijve (rajon, BE-së dhe ndërkombëtare) në politikatat që influencojnë zhvillimin social dhe ekonomik në Kosovë.

Është intensifikuar pjesëmarrja e CSO-ve kosovare në rrjete rajonale. Shumë OJQ, individë, organizata kulturore morën pjesë në ngjarje rajonale të organizuara në Kosovë apo jashtë saj. Disa nga këto ngjarje mbeten si projekte të shënuara, për të cilat u fol shumë, dhe e promovuan bashkëpunimin rajonal në mënyrën më të mirë.

Table of grants

Emri i Projektit	Grantist	Shuma
1 + 1 : Life & Love	Muzeu i Kosovës	1000
Mountain for All*	SCRADUS	6000
Festivali i muzikës	NGOM	5000
Punësimi i vajzave të konviktit	Motrat e Shën Kryqit	2000
Analize e historisë së Kosovës 1912-2011 në tekstet e shkollave fillore e të mesme në Kosovë, Serbi e Shqipëri	KAHCR	8360
Konferenca e dhjetë ndërkombëtare për biznes dhe punësim	Instituti i Financave të Kosovës	2000
Konferenca Ndërkombëtare me rastin e 10 vjetorit të themelimit të Departamentit të Psikologjisë - UP "Zhvillimi i psikologjisë në Kosovë - shikim në të ardhmen"	Departamenti i Psikologjisë - UP	3000
Konferenca Ndërkombëtare me rastin e Ditës Botërore të Filozofisë of Philosophy	Fakulteti i Filozofisë	680
Balkan Incentive Fund for Culture	European Cultural Foundation	10.000
Konferenca e katërt e Lidhjes së Psikiatërve Shqiptarë	Lidhja e Psikiatërve Shqiptarë	2000
Ekspozita personale e Jutta Benzenberg	Galeria e Arteve e Kosovës	2500
Shfaqja rajonale: Leksikoni i mitologjisë së ish Jugosllavisë	Teatri Kombëtar i Kosovës	4000
Ndjenja e sigurisë në Kosovë	Asociacioni i Kriminalistëve të Kosovës	1095
Konferenca e Katërt Ndërkombëtare «Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve)»	Instituti për Hulumtime Ekonomike "Globus"	2000

*Vlera totale e këtij projekti të mbështetur prej nesh është 9750 Euro. Shuma prej 6000 Eurove është ndarë nga Programi i Shoqërisë Civile dhe shuma prej 3750 Eurove nga Programi i Minoriteteve dhe Roma

Programi i Debatit dhe Iniciativat e të rinjëve

Programi i Debatit dhe Iniciativat e të rinjëve

Gjatë vitit 2011, Fondacioni nëpërmes të sektorit jo-qeveritar ka përkrahur iniciativat rinore për rrjetëzim të suksesshëm dhe komunikim me organizatat jashtë kufijve, edukimin e të rinjëve për lider dhe mbështetësit e programin e debatit.

Fondacioni që nga viti 2009 e përkrahë Programin e Debatit të cilin e implementon Lëvizja FOL. Në vitin 2009 Lëvizja FOL anëtarësohet në

tion) ku Lëvizja FOL ftohet nga IDEA që të marrë pjesë në garat botërore të debatit Youth Forum 2009 Bosnja & Hercegovina. Ekipa përfaqësuese e Kosovës në këto gara ishte një ekip (3 persona) nga shkolla Amerikane ASK. Me këtë ngjarje rikthehet debati i formatit "Karl Popper" në Kosovë.

Më 29 dhe 30 Janar 2011 u mbajt turneu i debatit Peja Open në shkollën e mesme "Lidhja e Prizrenit". Turneu u organizua në bashkëpunim me organizatën nikoqire Syri Vizion.. Në këtë turne morën pjesë 15 ekipe nga komunat Prishtinë, Ferizaj, Pejë gjithashtu një ekip nga shkolla Amerikane(ASK) si dhe një ekip nga komuniteti RAE si dhe me vetëfinancim dhe vetëpërgatitje morën pjesë për herë të parë komuna e Gjakovës me dy ekipe. Në këtë turne morën pjesë 18 ekipe gjithsej 54 debaterë.

Në datat 15-17 prill 2011 u mbajt turneu i 2të Kombëtar në Vushtrri "Kosova Open" në qendrën e Kosovës për siguri publike. Në këtë turne përveç tri komunave (Prishtinë, Ferizaj, Pejë) u inkuadruan edhe 3 komuna të reja (Malisheva, Mitrovica dhe Suhareka). Në këtë turne kanë marrë pjesë 20 ekipe ku numri i debaterëve ishte 60. Ekipa fituese si dhe 3 folëset më të mirë të këtij turneu përfaqësuan Kosovën në garat botërore të debatit Youth Forum 2011 Istanbul. Më datat 8 dhe 9 tetor të vitit 2011 organizohet turneu i debatit Mitrovica Open në Mitrovicë. Në këtë turne morën pjesë 4 komuna : Mitrovica, Malisheva , Suhareka dhe Ferizaji me 16 ekipe gjithsej 48 debaterë. Gjatë organizimit të këtij turneu janë mbajtur disa trajnime për gjykatës të rinj që kishin qenë debaterë me përvojë të cilët morën pjesë në këtë turne në cilsinë e ndihms gjykatësve për të krijuar përvojë dhe gjithashtu për tu formuar një elite e re e gjykatësve. Më 10-11 dhjetor u organizua turneu i debatit Prishtina Open nga organizata YIHR (Youth Initiative for Human Rights) në shkollën e mesme Xhevdet Doda në Prishtinë. Në këtë turne morën pjesë skuadrat nga komunat e Prishtinës, Ferizajit dhe Mitrovicës , 11 ekipe gjithsej 33 debaterë Planifikohet që me datat 9 dhe 16 prill të vitit 2012 të organizohet turneu më i madh i debatit të formatit Karl Popper, turneu i 3të kombëtar Kosova Open 2012 ku në të cilin përveq 6 komunave do të inkuadrohet edhe komuna e Gjakovës dhe e Prizrenit.

Në të gjitha turnetë e organizuar nga Lëvizja FOL gjithsej kanë marrë pjesë 97 ekipe nga 6 komuna të ndryshme që i bie 291 debaterë që kanë marr pjesë aktive nëpër gara të organizuar nga Lëvizja FOL me partneret lokal.

Grantet individuale/të udhëtimit

Rreth 85 grante individuale që u ndanë për shkollat verore dhe dimërore, si dhe pjesëmarrja e organizuar e të rinjëve në festivale dhe ngjarje ndërkombëtare e bën projektin e bursave të udhëtimit të qëlluar, aq më tepër që mungojnë burime tjera përkrahjeje për ta nga donatorë dhe institucione tjera.

Tabela e granteve

Emri i Projektit	Grantist	Shuma
Programi i Debatit	Lëvizja FOL	10000
Klubi i Debatit	Youth Initiative for Human Rights	5000
Vlerësimi i Programit të Debatës	IQ Consulting	2447.6
Punëtorja në Beograd "False truths: Disputed Histories"	American University in Kosovo	2000
Shkolla e Liderëve të Rinj	YIHR	8850
Media tools for peace advocacy	YMCA	1951
Grantet e udhëtimit*		15.000

* Lista e granteve të udhëtimit është në raport të veçantë. Grantet e udhëtimit janë ndarë nga buxheti i tri Programeve të Fondacionit. Pjesa e ndarë nga Programi i Shoqërisë Civile është 15.000 Euro

Shëndeti Mental

Në vitin 2011, në kuadër të Programit të Shoqërisë Civile është ndarë buxhet për mbështetje të projekteve të Shëndetit Mental. OSI Mental Health Initiative vazhdon të jetë përkrahëse e fuqishme në këtë fushë. Deri më tani janë përkrahur tri organizata, njëra prej të cilave për herë të parë financohet nga ne, OJQ Të Bashkuar për Autizëm.

Skena e organizatave më efikase që punojnë me persona me aftësi të kufizuara mentale është definuar mirë dhe janë arritur rezultate të mira nga puna e tyre. Bashkëpunimi me programin e rrjetit ka qenë shumë i mirë dhe frytdhënës. Është vazhduar edhe me ngritjen e kapaciteteve të këtyre organizatave nën mbikëqyrjen e Programit të Rrjetit. Fondacioni ka siguruar grante plotësuese për projektet e përkrahura.

Mbështetja e integritetit të komunitetit me Sindromin Down në Shoqërinë Kosovare

Objektivi i këtij projekti ishte ofrimi i shërbimeve të ndërhyrjes së hershme dhe edukimit në 5 Qendrat Burimore për personat me Sindromin Down. Gjithsej, 280 fëmijë kanë përfituar nga shërbime në 5 Qendrat Burimore (67 fëmijë me sindromin Down, të dy grup moshave të ndryshme 2-4 vjet dhe 4 -16 vjeçare kanë përfituar shërbimet e ofruara në Prishtinë, 19 në Gjakovë, 17 në Prizren dhe 9 në Mitrovicë)

Gjatë vitit 2011 kanë lindur 21 fëmijë, të gjithë fëmijëve vazhdimisht ju ofrohen shërbime të fizioterapisë nga 5 fizioterapistët (3 në Prishtinë, 1 në Gjakovë dhe Prizren dhe 1 në Mitrovicë. Ndërsa, të gjithë familjarët janë vizituar dhe kanë marr shërbimet mbi informimin dhe edukimin e prindërve.

Janë zhvilluar 6 takime në pesë (5) qendrat dhe një numër i madh i seancave individuale në Kafenenë X21 (Programi X21). Për me tepër janë inkurajuar prindërit dhe anëtarët tjerë të familjes për të vizituar shërbimet ekzistuese dhe të largohen nga rutina e mërzitshëm e tyre dhe izolimi, si dhe për të ndarë shqetësimet, nevojat e përbashkëta dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me zhvillimin e fëmijëve të tyre në përgjithësi.

Ofrimi i trajnimeve për të rinjtë dhe të rriturit me sindromin Down, për kamerier dhe barman ishin të përfshirë të paktën 20 persona. Pesë (5) të rinjë me Sindromin Down kanë vazhduar pesë (5) ditë në javë rregullisht dhe deri në këtë periudhë të raportimit kanë përfituar shkathtësi dhe aftësi për jetë të pavarur.

Organizimi i Shënimit të Ditës Botërore për Personat me Sindromin Doën 21 Mars 2011 ka pasur një numër aktivitete: Program argëtues me përfundim të personave me Sindromin Down, 7 ditë prezantim të misionit në Sheshin Nëna Terezë, promovimi i këngës "Unë Jam Si Ti", projekt i realizuar në bashkëpunim me Eliza Hoxha & Etno Engjujt, fillimi dhe promovimi i programit të punëtorisë për prodhimin e kartolinave në programin X21, pjesëmarrja në video promovimin e organizuar nga Down Syndrome International. Drejtorit ekzekutiv të Down Syndrome Kosova, Driton Bajraktarit i dhurohet çmimi vjetor nga World Down Syndrome Day dhe Down Syndrome International, për kontributin e madh në përmirësimin e imazhit dhe gjendjes së personave me sindromin Down.

Përkrahja dhe integrimi i personave me probleme intelektuale dhe mendore në shoqëri

Aktivitete të zhvilluara në Klubin Dëshira vazhduan të jenë si edhe vitet e kaluara: kursi i shkrimit, i matematikës, gjuhës angleze, kompjuterit, aktivitete grupore, ligjëratat për edukimin shëndetësor, bashkëpunimi me Qendrat e Shëndetit Mendor

Është organizuar vizita në Kroaci. Udhëheqësit dhe disa anëtarë në fund të muajit mars janë njoftuar me punën e qendrës "Udruga za Samozastupanje" në Zagreb. Ka qenë një përvojë shumë e mirë e shkëmbimit të informatave dhe mënyrës së punës së të dy organizatave.

Në fund të qershorit, RTK në kuadër të emisionit "Mundësi" ka pasqyruar punën e Klubit.

Në fund të vitit 2011 është angazhuar një kompani e cila për disa muaj do të mbajë trajnime dhe do të punojë në baza ditore me stafin e Klubit Dëshira në mënyrë që të fuqizohen dhe të aftësohen për të ngritur fondet për këtë Klub.

Të Bashkuar për Autizëm

Organizata "Të Bashkuar për Autizëm" ka filluar ofrimin e shërbimeve për fëmijë me autizëm në Prill 2011, ndërsa në Gusht 2011 nën mbështetjen e KFOS dhe Ambasadës së Holandës u bë e mundur kanalizimi i këtyre shërbimeve përmes projektit "Ura lidhëse drejt Integritetit dhe Pavarësisë së Fëmijëve me Autizëm"

Me anë të vizitave në terren dhe takimeve me prindër janë identifikuar gjithsejt 29 fëmijë me autizëm me ç'rast 15 prej tyre kanë qenë përfitues të shërbimeve të rregullta në baza ditore ku secili nga këta fëmijë ka marr tre orë shërbime individuale ditore përmes programeve shkencërisht efektive si ABA duke përfshirë edhe Qasjen Piramidale dhe PECS. Përveç punës direkte individuale në baza ditore, përfitues të projektit ishin edhe fëmijët të cilët nuk ishin përfitues të shërbimeve të rregullta ditore, por këtyre fëmijëve i'u është ofruar: Vlerësim i shkathësisive dhe potencialeve të tyre, Plani Individual i Punës, këshillim i prindërve, gjetjen e studenteve të psikologjisë apo psikologëve për të punuar me fëmion në kopshte apo shkolla, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të progresit të tyre. Përfitues të shërbimeve të projektit kanë qenë fëmijët e moshës 2 deri në 14 vjeç, ndërsa bazuar në gjini dominon gjinia mashkullore ku nga 29 përfitues të shërbimeve 19 prej tyre ishin të gjinisë mashkullore.

Edhe pse projekti është implementuar përmes organizatës me zyre në Prishtinë, fëmijët përfitues të organizatës ishin me vendbanim në: Prishtinë (19), Pejë (2), Deçan (2), Prizren (1), Gjilan (1), Podujevë (1), Istog (1), Ferizaj (1) dhe Mitrovicë (1). Siç mund të shihet, shumica

e tyre ishin me vendbanim në Prishtinë të cilët e kishin më të lehtë qasjen edhe në shërbimet direkte ditore. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve, 15 prej tyre ishin përfitues të shërbimeve ditore, ku 14 prej tyre ishin me vendbanim në Prishtinë ndërsa një prej tyre është shpërngulur nga Peja në Prishtinë me qëllim të të pasurit qasje në shërbimet ditore.

Përveç punës direkte me fëmijë, në kuadër të projektit është realizuar edhe aftësimi profesional për punë më fëmijë me autizëm për student nga Departamenti i Psikologjisë, të cilët njëkohësisht edhe kanë ofruar shërbime në baza ditore në mënyrë vullnetare, dhe njëkohësisht përfundimin e orëve praktike të cilat janë të obliguara nga Fakulteti i Filozofisë-Departamenti i Psikologjisë me nga 100 orë në vit.

Në kuadër të projektit është inicuar edhe bashkëpunimi me institucione relevante si: Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ambasada e Holandës, Unicef, Save the Children dhe kompani të ndryshme.

Tabela of grants*

Emri i Projektit	Grantist	Shuma
The bridge to integration and independence of children with autism	Të Bashkuar për Autizëm	2001,42
Vizitë Studiu në Kroaci	Klubi Dëshira	800
Mbështetja dhe integrimi i personave me probleme të shëndetit mental - 2012	Klubi Dëshira	11000
Ngritja e kapaciteteve të Klubit Dëshira	IQ Consulting	4071.6

*Projects allocated from Civil Society Program Core Budget

Table of grants*

Emri i Projektit	Grantist	Shuma
Mbështetja dhe integrimi i personave me probleme të shëndetit mental - 2011	Klubi Dëshira	USD 40580
Mbështetja dhe integrimi i personave me syndrome down	Downsyndrome Kosova	USD 35690
Mbështetja dhe integrimi i personave me probleme të shëndetit mental - 2012	Klubi Dëshira	USD 26.230
The bridge to integration and independence of children with autism	Të Bashkuar për Autizëm	5340 Euro



#5 [Fondi Emergent]

#5 Fondi Emergjent

Z. George Soros krijoi Fondin Emergjent si fond ekstra buxhetor për shtetet, ku Instituti për Shoqëri të Hapur është tradicionalisht i pranishëm për të ndikuar në përmirësimin e situatës në disa nga çështjet socio-ekonomike më të ndikuara nga kriza globale financiare. Ky fond ka për qëllim të sigurojë që arrijtjet e mëhershme drejtë qëllimeve të një Shoqërie të Hapur të mos ngecin apo shkojnë mbrapa, duke qenë të ndikuara nga presioni ekonomik i shkaktuar nga kriza.

Përmes këtij fondi synohen projekte që adresojnë nevoja urgjente të shtresave më të rrezikuara të shoqërisë. Këto grupe të rrezikura janë jo vetëm ato që tradicionalisht i shohim si të tilla (grupe të marginalizuara nga varfëria, përkatësia etnike, bindjet dhe shprehjet etj...) por janë edhe shtresa të tëra shoqërore (si p.sh. klasa e mesme) që dikur kanë qëndruar shumë mirë, por që ndryshimet shoqërore sidomos kriza financiare, që në Kosovë ka ardhur përmes investimeve të ndalura, ndihmave të zvogëluara nga diaspora si dhe humbjeve direkte që kanë pësuar institucionet e ndryshme (p.sh. fondi pensional), i kanë bërë të jenë grupi i rrezikuar.

Deri më tani Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur ka mbështetur 28 projekte të ndryshme në shumë totale prej 500 000 dollarë përmes 5 konkurseve të hapura. Raundi i VI-të dhe i fundit i projekt propozimit do të lejohet kah fillimi i muajit mars. Në vazhdim gjinden përshkrimet e shkurta dhe buxhetet për 28 projektet e mbështetura gjatë periudhës kohore 2009-2011.

Raundi 1-2009

1. Titulli i projektit: Përmirësimi i kushteve për aktivitetet e përditshme të njerëzve me aftësi të kufizuara mendore

Dorëzuar nga: Qendra ditore për njerëzit me aftësi të kufizuara mendore, Klubi "Dëshira"

Kohëzgjatja e projektit: 1 dhjetor 2009- 30 qershor 2010

Granti i KFOS-it: 10 000 € (\$ 14 095) granti

Përshkrimi:

Klubi "Dëshira" është njëra prej organizatave të pakta në Prishtinë që punon me njerëzit me aftësi të kufizuara mendore dhe përmes aktiviteteve të saj ofron shërbime rehabilitimi, risocializimi dhe reintegrimit për anëtarët e saj. Që nga themelimi, ky klub iu ka ofruar shërbime 300 anëtarëve të regjistruar; ndërsa 180 prej tyre i vijnë rregullisht programet dhe shërbimet e ofruara. Ndonëse, grup moshave që u ofrohen këto shërbime ndryshon prej 18 deri në 60 vjet, aktivitetet e ofruara përqendrohen në nevojat individuale të anëtarëve të saj. Klubi, përveç shërbimeve për edukim dhe socializim, ia ka dalë me sukses të sigurojë madje edhe punësimin për anëtarët e saj si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat në Kosovë. Me të ndjehurit e krizës në Kosovë, ndërsa mbështetja kryesore e donatorëve vazhdon të drejtohet me vështirësi kah asistencë teknike, subjektet si Klubi "Dëshira" duhen ose t'i reduktojnë shërbimet e tyre në mënyrë dramatike ose t'i mbyllin përgjithmonë. Që të dy alternativat do të ndikojnë tek anëtarët e vet, të cilët jo vetëm që kanë aftësi të kufizuara mendore por gjithashtu paraqesin individët, të cilët vijnë nga familje të varfëra ose nuk janë nën kujdesin e askujt dhe varen shumë nga udhëzimet, trajnimin ose mbështetjen e klubit. Prandaj, mbështetja e ofruar nga Fondacioni do ta ndihmojë përmirësimin e kushteve të Klubit, e cila përbën rehabilitim të lehtë. Veç kësaj, këto fonde do të përdoren për blerjen e materialeve/pajisjeve didaktike dhe furnizimin e 40 anëtarëve me pako higjienike dhe veshmbathje, të cilët jetojnë në kushte më të rënda.

2. Titulli i projektit: Mbështetja e Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës

Dorëzuar nga: Shoqata e Pensionistëve të Kosovës (SHPK)

Kohëzgjatja e projektit: 1 dhjetor 2009- 30 qershor 2010

Granti i KFOS-it: 10 000 € (\$ 14 095)

Bashkëpjesëmarrja: 4 000 € Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

Përshkrimi: Deri më tani përsionistëve në Kosovë iu duhet të mbijetojnë me pension 70 euro, i cili është pothuajse i njëjtë me shumën e ndihmës sociale. Meqë sistemi pensional i Kosovës dështoi menjëherë pas konfliktit të vitit 99-të dhe me rënienën remitancave nga anëtarët e familjes jashtë vendit, situata e pensionistëve është rrënuar në mënyrë shumë të shpejtë. Në vendet e mëdha si Prishtina, pensionistët gjithashtu ndjehen të izoluar për shkak të migrimit të fëmijëve të tyre dhe ata janë të përjashtuar nga shoqëria, meqenëse nuk shihen më si kontribues të shoqërisë. Të gjitha këto kanë efekte dramatike në shëndetin e tyre mental si dhe i molis ata fizikisht. Shoqata e Pensionistëve të Kosovës (SHPK), të cilën Fondacioni synon ta mbështesë përmes qendrës së saj në Prishtinë, i ofron mundësi të ndryshme personave të pensionuar që të mblidhen sëbashku dhe lehtësojnë izolimin e tyre. Është vendi i vetëm ku pensionistët e Prishtinës mbidhen, luajnë shah, domino, lexojnë, shoqërohen dhe informohen për çështjet që u interesojnë atyre. Grupi i grave organizon dy herë në vit ekspozita të punëdoreve që ato i bëjnë. Një herë në javë, mjeku e viziton SHPK-në dhe ofron kontrolla pa pagesë për anëtarët e saj. SHPK-ja mban kontakte me Shoqatët e Pensionistëve nga rajoni si me ato të: Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi për çështjet e politikave të popullatës së moshuar. Të gjitha këto aktivitete zhvillohen në dy dhoma të pajisura dobët. Mbështetja e ofruar nga Fondacioni i Kosovës do t'i përmirësojë kushtet e objektit të SHPK-së, do të ia mundësojë anëtarëve të saj të kalojnë kohë cilësore së bashku dhe të zgjerojnë shërbimet e tyre. Granti do të mbështesë pajisjet didaktike, shkëmbimin e vizitave rajonale dhe dialogun për ndërmarrjen e veprimeve rajonale për nevojat e popullatës së moshuar dhe vazhdimësinë e vizitave të mjekut në baza të rregullta.

68

3. Titulli i projektit: Fuqizimi i Qendrës së komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian (RAE)

Dorëzuar nga: Qendra e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian "Jeta e Re" në Prizren

Kohëzgjatja e projektit: korrik 2009, korrik 2011

Granti i KFOS-it: \$ 25 000

Përshkrimi: Qendra e komunitetit RAE „Jeta e Re“ gjendet në një lagje të Prizrenit, i shërben më shumë se 800 anëtarëve të komuniteteve RAE. Është e vendosur në një ndërtesë private që është në shfrytëzim nga një pjesëtarë i komunitetit për 10 vitet e ardhshme. Kthimi me dhunë nga shtetet e Evropës Perëndimore, papunësia kronike dhe jeta e kufizuar i ka bërë RAE-t komunitetet më të rrezikuara dhe më të marginalizuara në Kosovë. Krizat financiare e përsheptuan vendimin e shteteve perëndimore që t'i kthejnë RAE-t. Pavarësisht paralajmërimeve të disa subjekteve të rëndësishme për të drejtat e njeriut dhe ato ekonomike, që atdhesimi do të shkaktojë kriza ekonomike, nuk i ka ndaluar vendet pritëse të fillojnë me atdhësim. Kjo mënyrë e kthimit jo vetëm që i ngarkon të kthyerit dhe buxhetet komunale por gjithashtu e ngarkon edhe komunitetin pritës dhe familjet e tyre. Numri i madh i të kthyerve me dhunë dhe rënia e të ardhurave ka efekte të shumëfishta si: (1) rënia e vijimit të shkollës, (2) shkalla e lartë e papunësisë, (3) kushtet e dobëta higjienike, të cilat ndikojnë në shëndetin e anëtarëve të komunitetit, (4) apatia në mesin e të rinjve dhe (5) dhuna në familje. Me mbështetjen e këtij granti, Qendra do të sigurojë rehabilitim të lehtë, pajisje didaktike dhe zbatimin e programeve të saj, me synim që të: (1) përmirësojë qasjen dhe mbajtjen e komuniteteve RAE si dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre për të përfituar nga niveli arsimor i mesëm dhe tretësorë (2) Të ngrisë zhvillimin e aftësive dhe krijojë mundësi për punësim; (3) të përmirësojë qasjen në shërbime shëndetësore dhe sociale dhe (4) të angazhojë gratë dhe rininë në programet arsimore dhe të jetesës.

4. Titulli i projektit: Fuqizimi i grave përmes metodologjië "ndihmoji vetes"

Dorëzuar nga: Instituti Pedagogjik PEDAKS

Kohëzgjatja e projektit: 1 dhjetor 2009- 30 qershor 2010

Granti i KFOS-it: 12 000 € (\$ 16 913)

Përshkrimi:

Synimi i projektit është fuqizimi i grave që jetojnë në zonat rurale në komunën e Prishtinës, të merren me problemet e përditshme dhe të mbështesin njëra – tjetrën në kohët e vështira. Projekti ka për cak 180 gra prej grupeve të ndryshme etnike si: shqiptare, serbe, turke dhe rome; 45 nga secili. Rezultati afatgjatë i projektit do të jetë përmirësimi marrëdhënies ndëretnike. Efektet e krizave financiare kanë ndikuar në mënyrë të dukshme mbi gratë në shoqërinë kosovare. Veçanërisht amviset, të cilat janë zakonisht përgjegjëse për menaxhimin e "buxhetit të shtëpisë", edukimin e fëmijëve, punët e shtëpisë dhe balancimin e marrëdhënies në shtëpi. Planifikimi dhe manaxhimi i "buxheteve të shtëpisë" në familjet e varfëra shpeshherë shkakton stres dhe presion tek gratë. Idea kryesore e projektit është të krijohet një familje stabile dhe e fuqishme dhe si rrjedhim, komunitetet stabile përmes fuqizimit të pozitës së gruas në të. Projekti do të ofrojë shërbime dhe këshillim për 180 gra, në mënyrë që t'i fuqizojë ato të merren me sfidat e përditshme në familje dhe shoqëri. Më saktësisht, do të formohen 6 grupe të grave, të afta për të përdorur metodologjinë "ndihmoji vetes".

5. Titulli i projektit: Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në shoqëri

Dorëzuar nga: OJQ Sfida

Kohëzgjatja e projektit: 1 dhjetor 2009- 30 nëntor 2010

Granti i KFOS-it: 10 000 € (\$ 14 095)

Përshkrimi:

Rajoni i Gjakovës është njëri prej rajoneve më të varfëra në Kosovë dhe krizat financiare e kanë goditur shumë rëndë. Fëmijët me nevoja të veçanta janë kategoria që vuan më së shumti meqë janë të izoluar dhe nuk kanë mundësi ta gëzojnë fëmijërinë si të tjerët. Situata sht edhe më e rëndë me fëmijët e komuniteteve pakicë. Vetëm 100 nga 608 fëmijë të identifikuar me nevoja të veçanta që jetojnë në komunën e Gjakovës janë të përfshirë në sistemin arsimor. Grupi i synuar i projektit të propozuar janë fëmijët me nevoja të veçanta nga grupet e ndryshme etnike, të cilët vijonë shkollimin përmes një programi të veçantë. Ai do t'i përfshijë 80 fëmijë të moshës shkollore, prindërit dhe mësimmshëmësit. Aktivitetet e propozuara kanë për synim ndërprerjen e ciklit të izolimit, në të cilin gjenden atni fëmijët me nevoja të veçanta.

Aktivitetet do të organizohen në bashëpunim të ngushtë me shkollat, departamentet komunale të arsimit dhe do të përfshijnë aktivitete arsimore, sportive dhe kulturore për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe takime dhe sikutime me prindërit dhe mësimmshëmësit. Gjithashtu, do të ofrohen shërbime të nevojshme fiziko-terapeutike dhe trajtime psikologjike, të cilat mungojnë për shkak të buxhetit të paktë.

6. Titulli i projektit: Kujdesi social për të moshuarit dhe të varfërit në Prilluzhë

Dorëzuar nga: OJQ Lepsa Buducnost (Ardhmëria e bukur)

Kohëzgjatja e projektit: 1 dhjetor 2009- 30 nëntor 2010

Granti i KFOS-it: 10 642.5 € (\$ 15 000)

Përshkrimi:

Ky projekt do të realizohet në Prilluzhë, komuna e Vushtrrisë (enklavë serbe) dhe do të mbështesë nevojat e komunitetit serbë dhe romë. Nga ky projekt do të përfitojnë 25 familje që nuk janë nën kujdesin

e askujt (të moshuarit), 48 familje rome, të cilat nuk kanë të ardhura të rregullta dhe të cilat nuk marrin ndihmë sociale. Gjithashtu, do të ofrohet transport falas për 20 studentë që udhetojnë përditë në Mitrovicë për të shkuar në shkollë. Familjeve pa kujdestar (personave të moshuar) do t'u ofrohet ndihmë për punë të shtëpisë, furnizim me ushqim dhe përgatitj të tij (gatim), vizita mjekësore dhe furnizime. Ndërsa familjet rome, personat me nevoja të veçanta dhe fëmijët pa prindër do të marrin pako humanitare, kryesisht ushqim dhe furnizime higjienike. Projekti do të zhvillohet në bashkëpunim me Qendrën për Ndihmë Sociale në komunën e Vushtrrisë.

Gjithsej:

\$ 99 198

Raundi 2-2010

7. Titulli i projektit: Mbështetja e pensionistëve për të bërë një jetë të shëndetshme dhe Inkurajimi i pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore në komunitetin e tyre.

Dorëzuar nga: Forumi për Iniciativë Demokratike

Kohëzgjatja e projektit: maj-nëntor 2010

Granti i KFOS-it: 14 700 €

Përshkrimi:

Forum i për Iniciativë Demokratike propozon të zbatohet një projekt që do t'i qaset pensionistëve të Gjakovës dhe do t'i adresojë nevojat e tyre në rritje në fushën e kujdesit preventive shëndetësor dhe socializim. Aktualisht, gjendja e pensionistëve të Gjakovës nuk ndryshon nga ajo e pjesës tjetër të Kosovës, kur është fjala për nevojat e paplotësuara të kujdesit shëndetësor, mbrojtjes sociale, rrethanat e rënda ekonomike, etj. Përveç kësaj, Gjakova ka qenë një nga zonat më të prekura nga konflikti në Kosovë në vitin 1999, gjatë të cilit shumë njerëz kanë humbur familjet e tyre ose anëtarët e familjes së tyre. Çrregullimet post-traumatike të stresit, shumë të theksuara dhe të shoqëruara me situatën e dhimbshme sociale, ndikojnë thellë në jetën e pensionistëve. Prandaj, Forumi për Iniciativë Demokratike propozon të zbatohen veprimtaritë me kosto të ulët, që do t'iu mundësojnë pensionistëve të dyja shërbime dhe një shans për pjesëmarrje në skenën sociale të Gjakovës. Aktivitetet do të mbulojnë shpenzimet e një mjeku, bisedimet mbi atë se si të udhëheqin një jetë të shëndetshme duke i njoftuar me një dietë të përshtatshme dhe një shportë të lirë të ushqimit dhe aktivitetet fizike. Gjithashtu, do të ofrohet orientimi në shërbimet e parashikuara me ligj për pensionistët që duan të fillojnë një biznes të vogël. Më tutje, do të punojnë ngushtë me autoritetet lokale në aktivizimin e resurseve lokale dhe qendrore për të përmirësuar statusin e pensionistëve me anë të programit

të politikave lokale. Një pjesë e fondeve të kërkuara do të mbulojë koston e pajisjeve të nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve, përmirësimin e renovimit duke i mbuluar bazat, me qëllim për ta kthyer hapësirën fizike në një ambient mikpritës dhe të dobishëm gjatë jetës së projektit dhe pas asaj. Mbështetja shtesë për projekt do të nxirret nga qeveria lokale, bizneset lokale dhe donatorët e mundshëm.

8. Titulli i projektit: "You are not alone"

Dorëzuar nga: Rrjeti Informativ i Kosovës "Mitrovica Press"

Kohëzgjatja e projektit: prill-dhjetor 2010

Granti i KFOS-it: 10 000 €

Përshkrimi:

Fëmijët jetim të vendosur nën kujdestari dhe nëpër jetimoret, janë duke u prekur nga kriza ekonomike, pasi që mbështetja financiare e caktuar për ata vazhdimisht zvogëlohet nga ana e institucioneve shtetërore. Për t'i bërë jetat

më keq, shumë organizata ndërkombëtare që iu kanë dhënë ndihmë janë tërhequr nga Kosova, duke krijuar një vakum që askush nuk merr përsipër që ta plotësojë. Shumica e ndihmës së dhënë për mbështetjen e pamjaftueshme financiare vjen nga bizneset dhe donacionet private, por jo në mënyrë të rregullt. Prandaj, Rrjeti Informativ i Kosovës, ka për qëllim të mbështesë 250 fëmijë jetimë në komunën e Mitrovicës duke u ofruar atyre ushqim, asistencë mjekësore, rroba, pajisje higjienike dhe aktivitetet edukative. Fondet e kërkuara do të ndihmojnë në sigurimin e kushteve më të mira të jetesës për jetimet, kujdesin mjekësor dhe përmirësimi i kushteve dhe normave higjienike. Gjithashtu, aktivitetet arsimore do të sigurojnë përparimin e tyre në shkollë dhe do t'i ofrojnë me aftësitë e nevojshme sociale.

9. Titulli i projektit: Të përmirësojmë jetën e të moshuarve me kujdes shtëpiak

Dorëzuar nga: "Iniciativa 6"

Kohëzgjatja e projektit: prill-dhjetor 2010

Granti i KFOS-it: 15 000 €

Përshkrimi: "Iniciativa 6" ka vërejtur faktin e tmerrshëm që shumë qytetarë të moshuar që jetojnë në qytetin e Prizrenit jetojnë të vetmuar, me fare pak apo aspak ndihmë. Pasardhësit tyre në shumtën e rasteve kanë emigruar jashtë vendit, ose thjeshtë të moshuarit nuk kanë as familjarë ose dikë të afërm të kush mund të mbështetën. Pensionimi në shtëpi nuk është një mundësi për ata, pasi që hapësira është e kufizuar në shtëpitë e tilla, dhe ata preferojnë të qëndrojnë në shtëpitë e tyre, ku kanë jetuar deri më tani, ku rritet besimi i tyre dhe i mbajnë kontaktet me miqtë dhe fqinjët në lagjen e tyre. "Iniciativa 6" propozon që të trajtohen individët e kujdesit që do të ofrojnë kujdes dhe përkrahje për 40 (dyzet) qytetarë të moshuar të Prizrenit, të cilët jetojnë vetëm dhe janë të sëmurë ose të dobët fizikisht për të kryer rutinën e tyre të përditshme. Projekti i propozuar ka për qëllim që të identifikon dhjetë individë që do t'i trajnojë se si të kujdesën dhe të ofrojnë shërbime për qytetarët e moshuar. Ofruesit e përzgjedhur të kujdesit do të ofrojnë kujdesin në aktivitetet në vijim: sigurimi dhe blerja e ushqimit të tyre, pastrimi i shtëpisë, gatim i ushqimit dhe shoqërimi i tyre nëpër aktivitetet e komunitetit. Në rast të sëmundjes, kujdestarët e të moshuarve do t'i dërgojnë te mjeku ose në spital për trajtim ose për sigurim të barërave. Ata do t'i shoqërojnë dhe do t'i dërgojnë në ecje të përditshme për t'i mbajtur në formë. Kujdestarët e të moshuarve gjithashtu do t'i mbajnë të moshuarit vigjilent dhe të informuar, duke u lexuar dhe përcjellë lajme për çdo ditë nga programet televizive. "Iniciativa 6" beson se një ndihmë e tillë do të rivendosë dhe do të ruaj dinjitetin e qytetarëve të moshuar, dhe njëkohësisht, do të krijojë një ambient mbështetës për ata. Praktikrat dhe përvojat e mira të projektit do të emitohen nëpër radio dhe TV lokale.

10. Titulli i projektit: Zhvillimi i fermave dhe bletarisë në komunën e Dragashit

Dorëzuar nga: Shoqata e bujqëve dhe bletarëve të Dragashit, "Majcina Dushica"

Kohëzgjatja e projektit: prill-dhjetor 2010

Granti i KFOS-it: 10 000 €

Përshkrimi: Shoqata e Fermerëve dhe bletarëve të Dragashit propozon një projekt për gjenerimin e të ardhurave në përmirësimin e bujqësisë dhe ngritjen e biznesit të bletarisë në komunën e Dragashit. Të dy bizneset konsiderohen si fitimprurëse, duke pasur parasysh se komuna e Dragashit është një komunë rurale me shumë potencial dhe është e njohur për produktet e qumështit dhe produktet bujqësore. Megjithatë, mjetet financiare të individëve në zonën e Dragashit janë të pasigurta dhe shumica kryesisht zgjedhë të emigrojnë në vendet e tjera të ish Jugosllavisë, dhe të kryen punë të ndryshme shërbëtoresh. Të ardhurat

shfrytëzohen për të mbajtur familjen në shtëpi dhe për të gjeneruar çdo kursim që më vonë gjithashtu do të përdoret për përmirësimin e ekonomisë bujqësore në shtëpi. Pavarësisht nga përpjekjet e tyre të vështira, të ardhurat e krijuara gjatë punës së tyre jashtë vendit nuk janë të qëndrueshme dhe në këtë krizë ekonomike për të gjetur punë diku tjetër është bërë më vështirë se kurrë. Më tej, institucionet financiare në Kosovë i aplikojnë normat e larta të interesit për huatë dhe kreditë për bizneset e vogla. Prandaj, Shoqata propozon një projekt për gjenerimin e të ardhurave që me anë të grantëve të vogla do t'i ndihmojë prodhuesve lokal që të krijojnë apo përmirësojnë biznesin e tyre. Përveç aktivitetit të granteve, Shoqata do të sigurojë asistencë teknike në përmirësimin e bizneseve ekzistuese dhe ndërtimin e atyre të reja, mbrojtjen e produkteve dhe regjistrimin e tyre sipas legjislacionit të Kosovës. Projekti gjithashtu do të mbështesë edhe gratë që janë të gatshme për të startuar biznesin e tyre dhe do të kontribuojnë në rritjen e të ardhurave të familjes përmes aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura.

11. Titulli i projektit: Krijimi i mundësive të punësimit për personat me aftësi të kufizuara

Dorëzuar nga: Handicap Kosova

Kohëzgjatja e projektit: prill-dhjetor 2010

Granti i KFOS-it: 15 000 €

Përshkrimi: Përderisa legjislacioni në Kosovë është i vetëdijshëm se të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe veprimet janë duke u marrë nga nivelet më të larta të institucioneve shtetërore, punësimi i tyre nga sektori publik dhe privat mbetet në numër simbolik. Handicap Kosova propozon punësimin e 25 personave me aftësi të kufizuara dhe trajnimin e tyre në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut. Handicap Kosova do të krijojë lidhje me kompanitë private dhe publike dhe do të merr porositë/detyrat që do të kryhen nga personat me aftësitë e kufizuara, në lokacionet e tyre ku nuk do të kërkohen orë të gjata dhe të mundimshme pune. Duke pas parasysh krizën aktuale, shumë biznese kanë zgjedhë të mirëmbajnë një numër të vogël të të punësuarve me kohë të plotë dhe t'i transferojnë shërbimet dhe produktet e tyre. Qasja që është propozuar është e re dhe e panjohur.

12. Titulli i projektit: Ndhimja fëmijëve me disgrafi dhe disleksi në zhvillimin e aftësive të tyre të shkrimit dhe të leximit

Dorëzuar nga: OJQ "Shkolla XXI"

Kohëzgjatja e projektit: prill-dhjetor 2010

Granti i KFOS-it: 10 000 €

Përshkrimi: Fëmijët që vuajnë nga disgrafia dhe disleksia shpesh janë duke u trajtuar në shkollë dhe nga ana e sistemit arsimor, si një tërësi, si nxënësit me qëndrim jo të drejtë të mësuarit dhe me sjellje problematike. Për fat të keq, pikëpamjet e tilla në vendet ku mungojnë institucionet e specializuara dhe të aftësuara dhe ekspertët të aftë mbi çështjet e tilla janë të përhapura. Kosova në këtë rast nuk është një përjashtim. Shumë nga këta fëmijë nuk merr ndihmë të specializuar, kanë prirje për të lënë shkollën për shkak të progresit të ultë dhe shpesh bien në ose i kryejnë aktet e kriminalitetit. Shkolla XXI propozon një sere aktivitete që do të ndihmojnë këtë grup të fëmijëve, që janë nxënësit e nivelit fillor të shkollave në Prishtinë. Aktivitetet e propozuara do t'i sigurojnë fëmijëve me disgrafi dhe disleksi që të përfitojnë nga aktivitetet që përkrahin mësimin për të formuar shkronja, për të formuar shkrimin automatik të letrës, udhëzimet për gërmëzimin dhe strategjitë për kompozimin. Shkolla XXI ka një staf të kualifikuar që do të zbatojë aktivitetet e tilla dhe do të ju ndihmojë fëmijëve të identifikuar me detyrat e shtëpisë dhe çështje emocionale të angazhohen plotësisht në shkollë dhe aktivitetet shoqërore. Aktivitetet e propozuara synojnë përmirësimin e: a) progresit cilësor të këtyre fëmijëve, b) udhëzimeve të specializuara në të gjitha aftësitë përkatëse që ndërhyjnë në të mësuarin e tyre të gjuhës së shkruar. Grupi i synuar i fëmijëve do të jenë ata që vijnë nga familjet me vështirësi ekonomike, familjet me një prind ose ata jetimët që jetojnë nën kujdesin e një të afërmi apo anëtarit të familjes.

Gjithsejt:

74 700 €

Raundi 3-2010

13. Titulli i projektit: Fuqizimi i bizneseve joformale në Kosovë

Dorëzuar nga: Iniciativa e Grave të Kosovës

Kohëzgjatja e projektit: nëntor 2010- qershor 2011

Granti i KFOS-it: \$ 16 600

Përshkrimi: Në vend të luftimit të biznesit joformal që shpesh mbetet i vetmi burim i të ardhurave për shumë familje të varfra dhe në mungesë të informacionit statistikor që cenon zhvillimin e punës efektive dhe të politikave të ndërmarrjes, Iniciativa e Grave të Kosovës propozon që të mbahen dhjetë (10) muaj trajnim dhe asistencë teknike për 20 biznese familjare në komunën e Gjakovës dhe fshatrat përreth për të zhvilluar dhe avancuar bizneset e tyre dhe për të hapur tregun në Kosovë dhe në diasporë. Projekti do të merret me grupet e cenueshme siç janë gratë, prindërit e vetëm, familjet e mëdha, dhe do të përfshijë pakicën etnike serbe që jeton në zonën gjeografike të projektit. Përveç kësaj, Iniciativa e Grave të Kosovës do të punojë ngushtë me Qendrën për Përkrahje të biznesit në Kosovë që ofron trajnime profesionale për ngritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të krijon të holla për ndërmarrësit e rinj deri në 10,000.00 për të filluar aktivitetin e biznesit privat.

14. Titulli i projektit: Lehtësimi i integritit të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian në

shoqërinë kosovare përmes Rrjetit të Qendrave Mësimore

Dorëzuar nga: Balkan Sunflowers Kosovo

Kohëzgjatja e projektit: nëntor 2010-qershor 2011

Granti i KFOS-it: \$ 25 000

Përshkrimi: Rrjeti i Qendrave Mësimore ka dëshmuar të jetë i efektshëm në lehtësimin e integritit të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në shoqërinë kosovare. Deri më sot, ekzistenca e Qendrave Mësimore dhe aktivitetet e tyre të fokusuar kanë kontribuar në: a) uljen e ndjeshme të nivelit të braktisjes së shkollës fillore, b) rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve RAE në nivelin e shkollës së mesme dhe pas shkollës së mesme, c) integrimin e fëmijëve të tërhyerë, duke pasur parasysh që regjistrimi dhe pjesëmarrja e tyre në sistemin e arsimit të Kosovës do të kishte qenë e pamendueshme, sidomos kur një numër i tyre nuk flasin asnjë nga gjuhët që fliten në Kosovë.

Në këtë moment, kontributi i Qendrave Mësimore mund të jetë i rrezikuar nga mungesa e fondeve të donatorëve dhe mungesa e alokimit të fondeve të komunës, që do të lehtësojnë integrimin e pakicave dhe do ta përmirësojnë jetën e tyre. Prandaj, projekti i propozuar ka për qëllim të ruajë vullmin e fituar me punë të vështirë në vitet e fundit, të avancojë çështjen e integritit të minoriteteve, duke ndjekur një agjendë të fuqishme të avokimit në dialogun me qeverisjen qendrore dhe lokale, dhe presionin ndaj tyre për shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme për zbatimin e strategjisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë. Rrjeti i Qendrave Mësimore do të përfitojë nga shfrytëzimi i ndërtesave publike pa pagesë, që do ta zvogëlojë koston administrative të projektit në mënyrë të konsiderueshme, në sajë të bashkëpunimit me organet e qeverisjes lokale. Ndërkohë, ky rrjet ka intensifikuar dialogun me Ministrinë e Arsimit të Kosovës për të përfituar nga alokimi i buxhetit për shërbimet që do të jepen për organet e ndryshme jo-qeveritare.

Gjithashtu, UNICEF / Kosova vazhdon të mbështesë pjesërisht aktivitetet e Qendrave Mësimore.

Shkurtimisht, projekti i propozuar do të realizohet në 4 qytete, duke krijuar një ekip të qëndrueshëm dhe të përkushtuar prej 77 anëtarëve, kryesisht nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës, të cilët do ta mbështesin arsimimin e fëmijëve të prekshëm të këtyre komuniteteve.

15.Titulli i projektit: Mundësitë për gjenerimin e të adhurave për familjet baritore

Dorëzuar nga: Grauf – Shoqata e prodhuesve të bagëtisë

Kohëzgjatja e projektit: nëntor 2010-qershor 2011

Granti i KFOS-it: \$ 11 700

Përshkrimi: Menjëherë pas luftës së Kosovës, donatorët e ndryshëm, në mënyrë bujare, kanë mbështetur fermerët e Kosovës për të filluar biznesin e tyre. Ndër të tjera, fermerët ishin njohur me shoqatën Grauf për mbarështimin e bagëtive nga Tiroli, që është përshtatur shumë mirë me klimën e Kosovës dhe kushtet baritore. Shoqata "Grauf" deri më sot ka marrë mbështetje nga Caritas-i Zviceran, USAID, dhe departamentet e bujqësisë të komunave të ndryshme. Shoqata propozon që të zgjerojë eksperiencën e saj dhe të ndihmojë familjet baritore në rajonin e Dragashi dhe Prizrenit, për të përmirësuar jetën e tyre përmes mbarështimit të bagëtive. Shoqata ka për qëllim që përmes buxhetit të propozuar të përmirësojë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme të fermerëve, duke i njoftuar ata me metodat dhe teknikat për rritjen dhe mbarështimin e bagëtisë, rritjen e sasisë të produkteve të fituara nga bagëtia (qumësht, mish, lesh) dhe marketingun për shitjen e produkteve të tyre me çmime më të mira. Grupet e synuara i përkasin më të varfërve të kategorisë së të varfërve dhe të cilët mbijetojnë vetëm nga rritja e bagëtisë dhe shitja e produkteve të tyre. Grupet etnike që do të përfitojnë nga granti i propozuar janë të përkatësisë etnike goranë, boshnjakë dhe shqiptarë. Asistencë me parësi do t'i jepet grave që kalojnë kohë të konsiderueshme në ngritjen e bagëtisë, mbledhjen dhe shitjen e produkteve.

16.Titulli i projektit: Ndhima juridike për personat e marginalizuar

Dorëzuar nga: Klinika për Ndhimë Juridike në Mitrovicë

Kohëzgjatja e projektit: nëntor 2010-maj 2011

Granti i KFOS-it: \$ 15 500

Përshkrimi: Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të sigurojë ndihmë juridike pa pagesë dhe të promovojë qasjen në drejtësi për individët që kanë të ardhura të ulëta, me anë të ofrimit të shërbimeve mbështetëse juridike të vazhdueshme të cilësisë së lartë në një mënyrë me kosto efektive dhe efikase. Grupi i synuar do të jenë: pensionistët, të rinjtë, të papunët dhe të zhvendosurit, të cilët nuk mund të paguajnë këshillat ligjore dhe shërbimet ligjore, të tilla si këshillim ligjor, shërbimet për të shkruar parashtresat ligjore dhe dokumentet ligjore (kërkesa, deklarata, testamente, etj) që kanë të bëjnë me rastet e paraqitura në gjykatën e Mitrovicës dhe vende të tjera sipas nevojës, etj. Një grup avokatësh, të gjithë anëtarë të Odës së Avokatëve të Kosovës që janë të gatshëm të japin kohën dhe ekspertizën e tyre, do të ofrojnë këshillim për çështje ligjore të paraqitura nga personat në nevojë nga rajoni i Mitrovicës. Kohëzgjatja e projektit do të jetë 8 muaj dhe do të zbatohet nga grupi i ekspertëve i përbërë nga anëtarët e OJQ-së Klinika Ligjore, me ndihmën e OJQ-së Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. Programi do të menaxhohet nga menaxheri i projektit të Klinikës për Ndhimë Juridike të Mitrovicës me ndihmën e stafit të LCM. Përveç ndihmës juridike dhe shërbimeve të këshillimit, Klinika do të ofrojë informacione ligjore dhe do të llojë, në bashkëpunim me grupet e tjera, në qeveri për politikën që ndikojnë negativisht në grupet e marginalizuara të qytetarëve me të ardhura të ulëta. Rezultati i paraparë i projektit është rritja e numrit të përfituesve të ndihmës ligjore falas dhe ngritja e vetëdijes për rëndësinë e sistemit ligjor të fortë dhe efikas në veri të Kosovës. Është e qartë se projekti synon të promovojë një sistem ligjor të fortë dhe funksional, ndërsa do të ndihmojë qytetarët të cilët nuk mund të sigurojnë shërbime ligjore.

17.Titulli i projektit: Mundësitë për gjenerimin e të ardhurave për kultivuesit e frutave

Dorëzuar nga: Shoqata e Kultivuesve të Frutave Blagoje

Kohëzgjatja e projektit: nëntor 2010- qershor 2011

Granti i KFOS-it: \$ 13 600

Përshkrimi: Shoqata e kultivuesve të frutave Blagoje, e themeluar që nga viti 2003, ka 7 anëtarë të përkatësisë boshnjake, egjiptiane dhe shqiptare. Shoqata zotëron 4,000 pemë frutore; të gjitha të vendosura në kushtet e përshtatshme klimatike. Të gjithë anëtarët e Shoqatës janë kultivuesit e kualifikuar të frutave dhe me një përvojë solide në këtë fushë dhe kanë marrë pjesë në trajnimet e kualifikuara të ofruara nga ekspertët ndërkombëtarë. Aktualisht, për të zgjeruar, diversifikuar dhe plasuar produktet e tyre, për shkak mungesës së programeve financiare nga Ministria e Zhvillimit Rural dhe normat e larta të kredisë të aplikuara nga bankat dhe institucionet financiare në Kosovë, është bërë tejet e vështirë dhe vështirësitë e tilla do të kenë pasoja të tmerrshme për prodhuesit vendor duke i hedhur në falimentim. Ekziston edhe një mungesë të donatorëve në sektorin e bujqësisë dhe politikat aktuale të qeverisë për të inkurajuar prodhuesit vendor janë të dobëta edhe në rastet më të këqija, nuk ekzistojnë. Përmes grantit të propozuar, Shoqata ka për qëllim që të rrisë prodhimin e frutave, blerjen e pajisjeve të reja, teknologjinë dhe fidane dhe të përmirëson bashkëpunimin mes vreshtarëve dhe shitësve. Konsumatorët e Kosovës do të jenë në gjendje të konsumojnë produktet vendore, të freskëta dhe me çmime shumë më të lira. Përveç në zonat e mësipërme të investimit për grantet e kërkuara, Shoqata synon zgjerimin e biznesit të frutave duke angazhuar njerëz të rinj dhe grate si kultivues të mundshëm të frutave apo ndërmarrësit e ardhshëm.

18.Titulli i projektit: Gjenerimi i të ardhurave – bizneset familjare

Dorëzuar nga: Qendra e grave "PREHJA"

Kohëzgjatja e projektit: nëntor 2010-qershor 2011

Granti i KFOS-it: \$ 13 600

Përshkrimi: Promovimi i vetëpunësimit dhe mundësitë e barabarta punësimi, rritja dhe transferimi i aftësive dhe njohurive, dhe zbutja e varfërisë së familjeve që jetojnë në prag të varfërisë ose nën kufirin e varfërisë, janë aktivitetet kyçe të projektit të propozuar. Qendra e Gruas synon të përdorë fondet e nevojshme të projektit të propozuar për të mbështetur krijimin dhe funksionimin e 15 serrë /fidanishte, në 48 metra katror për secilin. Serrë do të ndërtohet në pesë fshatra, në një mesatare prej tre për çdo fshat. Familjarët që do të përzgjidhen si përfituesit e rojektit do të marrin farë, materialet për ndërtimin e serrës, insekticid. Përveç kësaj, do të mundësohet trajnimi dhe orientimi për 30 individë, dy për çdo familje do të merr aftësi dhe transferim të njohurive për t'iu mundësuar atyre të jenë të suksesshëm në këtë përpjekje. Përfituesit e trajnuar do të ndihmohen nga një ekspert përgjatëfazës fillestare. Pritet që familjet që do të përfitojnë nga kjo ndihmë të jenë në gjendje të mbulojnë nevojat e tyre dhe të jenë në gjendje të gjenerojnë të ardhura të vogla ngashitja e produkteve shtesë në treg.

Gjithsej:

\$ 96 000

Raundi 4-2011

- 19.Titulli i projektit:** Mbështetja për bizneset e vogla dhe mikro familjare në komunat Deçan dhe Rahovec
- Dorëzuar nga:** Fondi për Zhvillimin e Komunitetit
- Kohëzgjatja e projektit:** 3 muaj (15 qershor- 15 shtator 2011)
- Granti i KFOS-it:** \$ 20 000
- Përshkrimi:** Në vitin 2009, rritja ekonomike e Kosovës, që deri më atëherë ishte 5.4 për qind, ra në 4 për qind si pasojë e krizës globale ekonomike që preku ekonominë e Kosovës nëpërmjet rënies së investimeve të huaja, eksportit dhe zvogëlimit të remitancave.
- Qëllimi i përgjithshëm i projektit është mbështetja e bizneseve të vogla dhe mikro në dy komuna: Deçan dhe Rahovec. Mbështetja do të ofrohet nëpërmjet ndihmës teknike për bizneset e vogla dhe mikro familjare, si dhe nëpërmes blerjes së pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për këto biznese. Projekti do të përkrah 10 biznese të vogla dhe mikro, pra nga 5 për qind në secilën komunë. Projekti pritet që të shtojë të ardhurat për së paku 8 familje nga këto dy komuna dhe, në mënyrë të tërthortë, do të kontribuojë në përmirësimin e ekonomisë lokale nëpërmes shtimit të konsumit. Bizneset e shënuara janë bizneset e vogla mikro dhe familjare që plotësojnë kushtet e mëposhtme: (1) janë zyrtarisht të regjistruara si biznese, (2) zbatojnë projekte të vogla të bujqësisë, (3) punësojnë më shumë se 5 persona, si dhe (4) janë të gatshëm që t'i kontribuojnë grantit me 10 për qind nga fondi i tyre. Granti nuk do të jepet në formë të parasë së gatshme, por në formë të materialeve apo pajisjeve të nevojshme për të ruajtur apo për të zgjeruar biznesin. Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (Community Development Fund) ka arritur marrëveshjet me drejtoritë komunale për bujqësi, të cilat do të sigurojnë se prodhuesit/përfituesit e projektit do të kenë vend në treg, pa pagesë, për të shitur prodhimet e tyre.

76

- 20.Titulli i projektit:** Subvencionimi i prodhimeve ushqimore të shoqatës së grave në fshatin Krushë e Madhe
- Dorëzuar nga:** Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
- Kohëzgjatja e projektit:** 1 qershor- 10 tetor 2011
- Granti i KFOS-it:** \$ 20 000
- Përshkrimi:** Krusha e Madhe është një fshat në komunën e Rahovecit që ka pësuar më së shumti gjatë luftës së fundit në Kosovë. Si pasojë e luftës, fshati është kryesisht i banuar me të veja dhe e tërë ekonomia familjare varet nga ato dhe puna e tyre. Në mënyrë që të mbijetojnë, gratë e këtij fshati themeluan një shoqatë nëpërmes së cilës ato zbatojnë projektet të ndryshme socio-ekonomike dhe kulturore. Përveç kësaj, me mbështetjen e donatorëve dhe të komunës, shoqata e grave në Krushë të Madhe ia doli që të ndërtojë një fabrikë të vogël për konservimin e prodhimeve bujqësore, të cilat ato i prodhojnë. Komuna e Rahovecit u dha atyre tokën e punueshme për ndërtimin e fabrikës së konservimit të prodhimeve bujqësore. Kjo fabrikë e vogël që menaxhohet nga gratë e Krushës së Madhe u prek nga kriza financiare nëpërmjet rritjes së kostos së prodhimit dhe konservimit, gjë që i bëri këto prodhime, shumë kohë para shitjes së tyre, më të shtrenjta se sa prodhimet e importuara nga shtetet e tjera në rajon. Qëllimi i projektit është mbështetja e shoqatës së grave me anë të subvencionimit të prodhimeve, në mënyrë që çmimi i prodhimeve të jetë konkurrues në tregun e Kosovës dhe që të zgjerohet rrjeti i pikave të shitjes. Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë për prodhim, do të organizohet edhe një fushatë promovuese për prodhimet në tërë Kosovën.

21.

- 22.Titulli i projektit:** Zhvillimi i qëndrueshëm i prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit në komunën e Gjakovës
- Dorëzuar nga:** Fondacioni për Nisma Demokratike
- Kohëzgjatja e projektit:** 6 muaj
- Granti i KFOS-it:** \$ 20 000

Përshkrimi: Komuniteti i bujqve në komunën e Gjakovës po përballët me vështirësi në menaxhimin e fermave të tyre dhe prodhimit, kryesisht për shkak të zvogëlimit të subvencioneve nga qeveria komunale dhe ajo qendrore por edhe për shkak të huave të pafavorshme bankare për bizneset e vogla dhe bujqësore. Fermat që prodhojnë dhe përpunojnë qumështin janë prekur shumë nga kriza financiare, duke qenë se në 90 për qind të rasteve ata janë mbështetur nga remitancat e anëtarëve të familjes të cilët jetojnë jashtë vendit. Për shkak të krizës financiare, anëtarët e familjes, të cilët jetojnë në shtetet perëndimore, nuk janë në gjendje që të japin edhe aq shumë përkrahje sikur më herët. Tani, kur remitancat kanë rënë në minimum dhe në disa raste janë ndalur plotësisht, prodhimi i qumështit dhe përpunimi i tij janë në rrezik që të ndërkrehen krejtësisht. Remitancat u ndërprejnë saktësisht në kohën kur bujqit po krijojnë një bazë të mirë për qëndrueshmëri. Me një investim të vogël në këto ferma, shumica prej tyre do të jetë në gjendje të sigurojë qëndrueshmërinë dhe gjenerimin e të ardhurave. Veprimtaritë e projektit që kanë cak 10 ferma të vogla janë: (1) sigurimi i pajisjeve të nevojshme për paketimin e qumështit dhe ushqimit nga djathërat e bagëtive; (2) mbështetja për shpërndarjen e qumështit dhe prodhimeve qumështore, si dhe për krijimin e një rrjeti të pikave shitëse; dhe (3) vizita studimore në shoqatën e bujqve dhe prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit në Maqedoni.

23. Titulli i projektit: Avancimi i bujqësisë në komunën e Lipjanit

Dorëzuar nga: Organizata Publike për Nisma Lokale dhe Mbështetje-POLIS

Kohëzgjatja e projektit: 4 muaj

Granti i KFOS-it: \$ 22 000

Përshkrimi: Sektori i bagëtisë, posaçërisht njësia për prodhimin e artikujve qumështor në komunën e Lipjanit, ka një nevojë të madhe për përkrahje. Ky përfundim është arritur në bazë të një analizë të kryer nga drejtoria komunale për zhvillimin e bujqësisë në bashkëpunim me Organizatën Publike për Nisma Lokale dhe Mbështetje-POLIS. Përveç dhënies së këshillave të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së qumështit, bujqve iu duhet edhe një "infuzion" pas krizës financiare në mënyrë që të përdorin të gjitha kapacitetet ekzistuese në mbarështimin e bagëtive dhe prodhimin e prodhimeve qumështore. Në mënyrë që të përmirësojë bujqësinë, prodhimin dhe përpunimin e qumështit, organizata POLIS ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet 33 bujqve, drejtorisë komunale për zhvillimin e bujqësisë në Lipjan dhe Bylmetit, kompani e mbledhjes dhe përpunimit të qumështit me seli në Fushë-Kosovë. Drejtoria për zhvillimin e bujqësisë do të subvencionojë kamatat e bankës për blerjen e lopëve, të racës Simental, ndërsa kompania Bylmeti do të blejë nga bujqit tërë qumështin e prodhuar. Në mënyrë që të sigurojë kapacitetet drejtuese të organizatave vogla të fermave të bagëtive, POLIS do të ndërmerr veprimet si në vijim: (1) identifikimin e 33 bujqve me një potencial të fortë për të ruajtur dhe shtuar prodhimin e qumështit, (2) sigurimin e këshillave profesionale për bujqit mbi mbarështimin e bagëtive dhe prodhimin dhe përpunimin e qumështit, dhe (3) subvencionimin e blerjes të lopëve së racës Simental, një për secilin bujk të përzgjedhur. Të gjithë viçat që lindin nga lopët e blera do të jenë pronë e bujqve, në bazë të marrëveshjes të nënshkruar me drejtorinë komunale për zhvillimin e bujqësisë që parasheh se viçi-lopa që jep qumësht nuk mund të shitet dhe se mund të përdoret vetëm për prodhimin e qumështit, ndërsa demat mund të shiten vetëm nëse drejtoria komunale për zhvillimin e bujqësisë e konsideron si të arsyeshme dhe nëse është në përputhje me politikën për zhvillimin e bujqësisë. I gjithë qumështi i prodhuar do të blihet nga qumështorja Bylmeti.

24. Titulli i projektit: Qendra për gratë e moshës së tretë
Dorëzuar nga: OJQ Mirëbërësi
Kohëzgjatja e projektit: 1 shtator 2011- 28 shkurt 2012
Granti i KFOS-it: \$ 18 000

Përshkrimi: Deri më sot, pensionistët në Kosovë duhet të mbijetojnë me 70 euro pension, që pak a shumë është e barasvlershme me shumën e ndihmës sociale. Duke qenë se sistemi pensional në Kosovë dështoi menjëherë pas luftës së vitit 1999, si dhe duke marrë parasysh zvogëlimin e remitancave nga anëtarët e familjes jashtë vendit, gjendja e pensionistëve po vjen duke u përkeqësuar shumë shpejt. Gjendja e grave pensioniste është edhe më e rëndë, posaçërisht e të vejave dhe atyre të cilat jetojnë vetëm. Kjo qendër ka bashkëpunim me komunën e Prishtinës. Komuna ka siguruar lokalet pa qira për 10 vitet e ardhshme. Përfituesit e shënjuar të këtij projekti janë gratë pensioniste të cilat jetojnë vetë, gratë pensioniste me një gjendje të rënduar ekonomike, gratë me trauma lufte të cilat jetojnë vetëm dhe gratë të cilat nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre. OJQ Mirëbërësi, nëpërmjet kësaj qendre, do të trajtojë një gamë të çështjeve sociale: varfërinë, izolimin, shëndetin, solidaritetin ndërmjet brezave, arsimin e brezave të rinj, mirëqenien sociale, etj. Për gratë e moshës së tretë do të sigurohen shërbimet vijuese brenda qendrës: (1) hapësirë për shoqërim, (2) vakte ushqimi ditore, kryesisht drekë, dhe (3) veprimtari kulturore dhe argëtuese. Përveç veprimtarive që ofrohen brenda qendrës, Qendra do të identifikojë gratë të cilat mund të ofrojnë shërbime në shkëmbim për shërbime tjera apo pagesë të vogël. Këto veprimtari futen në këto dy kategori: (1) strehim të studentëve në shtëpitë/ banesat e grave të cilat kanë hapësira të lira në shkëmbim për kujdesin ndaj grave në nevojë – si kompensim për strehim, studentët do të ofrojnë kujdesin themelor për gratë në nevojë, si për shembull me mirëmbajtjen e shtëpisë dhe shoqërimin. Në mënyrë që Qendra të ketë një qëndrueshmëri përkritazi me veprimtaritë e veta, studentët do të paguajnë një shumë simbolike për çdo muaj (p.sh., 10-15 euro); (2) ofrim të kujdesit për fëmijët dhe bebet nga gratë të cilat janë në gjendje të mirë fizike dhe mendore për ta bërë një gjë të tillë.

Totali i përgjithshëm

\$ 100 000

Raundi 5-2011

25. Titulli i projektit: Identifikimi dhe mbështetja e të rinjve të talentuar dhe me dhunti
Dorëzuar nga: Encompass
Kohëzgjatja e projektit: 1 nëntor 2011-31 gusht 2012
Granti i KFOS-it: 16 400 € (\$ 22 638, 56)
Bashkëpjesëmarrja: 37 413, 95 € (Fondacioni Rockefeller Brothers), 20 000 € (Banka Raiffeisen), 11 784, 28 € (The Balkan Trust for Democracy), 673, 46 € (kontributi i Encompass) dhe and 30 000 € në natyrë (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë [MASHT]).

Përshkrimi: **Qëllimi** i këtij projekti është që të identifikojë, në fazën e hershme, të rinjtë e talentuar dhe me dhunti në të gjithat fushat në Kosovë dhe që t'iu ofrojë atyre mundësi, trajtim, kujdes dhe arsim të veçantë.
Nevoja: Kriza ekonomike dhe varfëria kronike në Kosovë ndikon në cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet, por ndikon në mënyrë të veçantë tek te rinjtë e talentuar dhe me dhunti. Për shkak të shkurtimeve buxhetore, familjet nuk investojnë në gjëra "luksi" dhe veprimtari të tilla si librat dhe literaturë të avancuar, vlerësim profesional dhe konsultime, programe të veçanta pasurimi, etj, ndonëse këto gjëra janë nevoja themelore dhe thelbësore për nxënësit. E njëjta gjë ndodhë edhe në shkolla, komuna dhe ministri; përkrahja institucionale për veprimtaritë jashtëshkollore, investimet në laboratorë, TI, librari, bursa, etj, është ndalur dhe në këtë mënyrë mundësitë tashmë të vogla të mësuarit janë pakësuar edhe më shumë.
Veprimtaritë e projektit: projekti do të ofrojë programe të hartuara

posaçërisht për nxënësit e rinj dhe me dhunti, si:

1. Konsultime për zhvillimin e talentit, konsultime lidhur me karrierën dhe konsultime psikologjike,
2. Shkolla verore do të ofrojë: 2.1. kurse të avancuara (kryesisht shkencë), 2.2. shkathtësitë e jetës dhe 2.3. veprimtari rekreative-intelektuale;
3. Mentorim nga profesionistët,
4. Rrjet të talenteve,
5. Librari për talentet,
6. Bursa, etj.

Përzgjedhja dhe numri i përfituesve: Programi do të shpallet në të gjithat shkollat e Kosovës dhe nëpërmjet masmedias në dispozicion, pa pagesë. Projekti do të mbulojë 500 nxënës të shkollave të mesme nga anekënd Kosova dhe një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet 50 nxënësve më të talentuar dhe me dhunti.

Bashkëpunimi/qëndrueshmëria: Projekti ka vendosur raporte bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Universitetin e Prishtinës, RTK dhe Qendrën për Arsim të Kosovës. Organizata "Encompass" synon që të zhvillojë dhe përmirësojë këtë projekt në mënyrë që, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe institucionet e tjera gjegjëse të shtetit, të themelojë Institutin për të Rinjtë e Talentuar dhe me Dhunti brenda një periudhe trevjeçare.

26. Titulli i projektit: Krijimi i mundësive të barabarta për nxënësit nga vendbanimet rurale dhe komunitetet RAE

Dorëzuar nga: Shërbimi për studentë

Kohëzgjatja e projektit: 1 nëntor 2011- 1 qershor 2012

Granti i KFOS-it: 11 500 € (\$ 15 874, 60)

Përshkrimi: **Qëllimi** është krijimi i mundësive të barabarta për nxënësit nga vendbanimet rurale dhe pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të cilët studiojnë në Universitetin e Prishtinës, si dhe tejkalmi i mangësive në arsimin e tyre të mesëm dhe përgatitja e tyre për punë me orar të përgjysmuar në institutet kërkimore.

Nevoja: Cilësia e arsimit që sigurohet jashtë qyteteve më të mëdha në Kosovë gjithmonë ka qenë më e ulët dhe më pak sfiduese, kështu që studentët të cilët kanë ardhur në kryeqytet për ndjekjen e studimeve baçelor në Universitetin e Prishtinës gjithmonë kanë pasur vështirësi për të arrirë moshatarët e tyre nga qytetet e mëdha. Kjo gjë është edhe më e theksuar kur flasim për pjesëtarët e komuniteteve RAE, regjistrimi i së cilëve në universitet është tradicionalisht i ulët. Krizat ekonomike kanë përkeqësuar gjendjen, duke qenë se mundësitë e bursave janë pothuajse të paqena dhe familjet e studentëve, të cilët vijnë për të studiuar në UP, nuk janë më në gjendje për të mbështetur financiarisht trajnime/kurse shtesë dhe literaturën në mënyrë që fëmijët e tyre të arrijnë dhe të kenë mundësi të barabartë sikur studentët e tjerë.

Veprimtaritë e projektit: Përgjatë shtatë muajve, shërbimi për studentë do të ofrojë programe të hartuara posaçërisht për studentët të cilët kanë vështirësi për të arrirë sikur studentët e tjerë në pesë departamente të Universitetit publik të Prishtinës. Shërbimi do të sigurojë kurse për kompjuterë dhe për gjuhë angleze, përdorim pa pagesë të librarisë, këshilla për shkrimin e biografive, letrës motivuese dhe llojet e intervistave për punë. Do të vendoset bashkëpunimi me Institutin për Studime Sociale dhe Zhvillimore, i cili do të ofrojë ligjërata pa pagesë për metodat dhe teknikat kërkimore dhe mentorim për grupet të përbëra nga pesë studentë mbi temat e akorduara më herët; seancat e mentorimit do të organizohen një herë në javë për secilin prej pesë grupeve. Po ashtu, këto programe do t'i përgatisin ata për punë me orar të përgjysmuar në institutet e ndryshme kërkimore, të tilla si Gani Bobi, Riinvest, Instituti për Studime Sociale dhe Zhvillimore, etj, si intervistues me orar të pjesshëm për anketat publike, pra ata të cilët tashmë kanë shfaqur interes për t'u angazhuar në ato. Këto institute do të ofrojnë trajnime shtesë, varësisht nga tema e kërkimit në të cilën ata do të angazhohen.

Përzgjedhja dhe numri i përfituesve: Projekti ka cak 100 studentë nga departamenti juridik, ai i ekonomisë, sociologjisë, shkencave politike dhe psikologjisë. Caku kryesor do të jenë studentët e vitit të parë; 20% e përfituesve do të jenë studentë të vitit të dytë. Shpallja dhe punësimi i pjesëmarrësve do të bëhet nëpërmjet shërbimit për studentë dhe mbledhjeve që do të organizohen në çdo departament.

Bashkëpunimi/qëndrueshmëria: Shërbimi për studentë u themelua me mbështetjen financiare të Bankës Botërore. Ky shërbim bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa Universiteti i Prishtinës i siguroi lokale pa pagesë dhe mbulon shpenzimet komunale. Duke qenë të trajnuar dhe duke qenë se tre organizata profesionale kërkimore janë të interesuara që të angazhojnë ata, studentët do të jenë në gjendje që të fitojnë honorarë dhe në këtë mënyrë do të plotësojnë shpenzimet për studimet e tyre.

- 26. Titulli i projektit:** Krijimi i mundësive të barabarta për gratë në komunën e Ferizajt
- Dorëzuar nga:** Caritas Kosova
- Kohëzgjatja e projektit:** 1 nëntor 2011- 1 maj 2012
- Granti i KFOS-it:** 15 000 € (\$ 20 706)
- Përshkrimi:** **Qëllimi i projektit** është themelimi i një kooperative për prodhimin e pastičerive dhe në këtë mënyrë do të krijojë mundësi punësimi për 30 gra të moshës 30-45 vjeçare.
- Nevoja:** Krizat ekonomike kanë prekur shumë biznese private, gjë që ka rezultuar me mbylljen e tyre dhe si pasojë ka lënë shumë të punësuar pa punë dhe pa të ardhura të rregullta. Gratë janë kryesisht të ndikuara, ndërsa posaçërisht në shoqëritë tradicionale dhe qytete e vogla gratë janë zakonisht ato të cilat kujdesen për familjet dhe në shumicën e rasteve nuk mbështeten në të ardhurat e burrit. Gratë të cilat nuk ka kualifikime të veçanta nuk mund lehtë të gjejnë një vend pune, prandaj mënyra më e mirë për ato që të sigurojnë çfarëdo të ardhurash është nëpërmjet krijimit të kooperativave të vogla, gjë që tashmë është dëshmuar e suksesshme në të shumtën e rasteve. Gratë e moshës së shënjuar janë posaçërisht të cenueshme, duke qenë se ato nuk vështrohen si punëtoresh të dëshirueshme për shkak të pushimit potencial që iu takon atyre me ligj, në rast se të lindjes së fëmijës apo nëse shfaqen obligime tjera familjare.
- Veprimtaritë e projektit:** Veprimtaritë e projektit do të ndahen në dy drejtime kryesore: (1) trajnimin për 30 gra për gatimin e tortave dhe ëmbëlsirave të ndryshme dhe (2) planifikim biznesi, marketing, promovim të markës tregtare dhe nënshkrim të marrëveshjeve me konsumatorët potencial (restorante, tregje, pastičerie, etj). Projektet gjithashtu do të furnizojnë kooperativat e pastičerive me një financim fillestar për blerjen e pajisjeve të nevojshme, të tilla si mikserin e pastave, furrën profesionale e madhësisë mesatare, etj.
- Përzgjedhja dhe numri i përfituesve:** Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë është 30 gra të papuna pa asnjë kualifikim të veçantë. Përzgjedhja do të bëhet në bazë të nevojës, ndërsa prioritet do t'i jepet grave vetushqyese. Punësimi do të bëhet nëpërmjet OJQ-ve të grave, qendrave rajonale për punësim dhe shpalljes publike në masmediat lokale.
- Bashkëpunimi/qëndrueshmëria:** Janë vendosur raporte bashkëpunimi me qendrat rajonale për punësim që do të ndihmojnë në identifikimin e grave në nevojë, të atyre që rishtazi kanë humbur vendin e punës për shkak të mbylljes së kompanisë, si dhe do të sigurojnë trajnime në lokalet e tyre për planifikimin e biznesit dhe marketing. Komuna e Ferizajt do të sigurojë lokalet pa pagesë për kooperativën e themeluar rishtazi për një periudhë dyvjeçare.

27. Titulli i projektit: Themelimi i një kooperative bujqësore në komunën e Graçanicës
Dorëzuar nga: Sindikata e Punëdhënësve të Kosovës (SPK), Graçanica
Kohëzgjatja e projektit: 1 nëntor 2011- 1 maj 2012
Granti i KFOS-it: 14 500 € (\$ 20 015, 80)

Përshkrimi: **Qëllimi:** sigurimi i qasjes së qëndrueshme në treg për prodhimet bujqësore, nëpërmjet themelimit të një kooperative funksionale në komunën e Graçanicës.
Nevoja: Banorët e komunës së Graçanicës janë kryesisht bujq të cilët kultivojnë dhe prodhojnë perime dhe fruta. Përveç prodhimit të mirave për përdorim vetanak, bujqit shesin një pjesë të madhe të prodhimeve të tyre në fabrikat për përpunimin e ushqimeve të vogla. Si pasojë e krizës ekonomike, këto fabrika ose u mbyllën, ose u shkrinë në kompanitë më të mëdha; në të dyja rastet, bujqit u prekën nga humbja e shitblerësve të rregullt (fabrikat) dhe nga humbja e të ardhurave nga shitja.

Veprimtaritë e projektit: SPK tashmë ka identifikuar 40 bujq të cilët janë të interesuar për krijimin e kooperativës. Në fazën e parë të projektit do të përfshihet nënshkrimi i marrëveshjeve me bujqit të cilët i bashkëngjiten kooperativës, si dhe saktësimi i llojit, cilësisë dhe sasisë së të mirave që ata duhet të jenë në gjendje t'i prodhojnë. Në të njëjtën kohë do të bëhet shqyrtimi i kërkesës në treg për llojin e të mirave që janë akorduar dhe saktësuar më herët. Në fazën e dytë të projektit do të përgatitet i tërë dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim zyrtar së bashku me bizneset, si dhe me përpunuesit e ushqimit do të nënshkruhen strategjia operative dhe marrëveshjet. Pas regjistrimit zyrtar të kooperativës, me një plan të mirë biznesi dhe operativ dhe pas nënshkrimit të marrëveshjeve me përpunuesit e ushqimit, UEK do të ofrojë ndihmën teknike për bujqit në mënyrë që të nxjerrin maksimumin e farave dhe fidanëve të mbjella, paketimin dhe ruajtjen e të mirave të prodhuara dhe blerjen e tyre për cilësi të nivelit të parë të farave dhe fidanëve.

Përzgjedhja dhe numri i përfituesve: Tashmë është vlerësuar se 30 nga 40 bujq të identifikuar do të bëhen anëtarë me të drejta të plotë të kooperativës. Në fazën e mëvonshme, kur kooperativa të jetë plotësisht funksionale dhe e qëndrueshme, ajo do të jetë e hapur për të gjithë bujqit e interesuar të cilët janë të gatshëm të ruajnë cilësinë e domosdoshme të mallrave. Bujqit në fjalë do të jenë ata të cilët janë në gjendje të prodhojnë së paku trefishin e sasisë së mallrave që atyre u duhet për përdorim privat.

Bashkëpunimi/qëndrueshmëria: Janë vendosur raporte bashkëpunimi me komunën e Graçanicës që do të sigurojë lokale pa pagesë për kooperativën, si dhe do të investojë në promovimin e prodhimeve të kooperativës në nivel vendi. Kooperativat mund të jenë të vetë-qëndrueshme brenda një viti dhe mund të përdoren si modele për vetorganizim në fushat e tjera bujqësore në Kosovë.

28. Titulli i projektit: Mënjanimi i "efektit serë" nëpërmjet investimit në sëra
Dorëzuar nga: Shoqata e grave "Aureola"
Kohëzgjatja e projektit: 1 nëntor 2011- 1 maj 2012
Granti i KFOS-it: 15 000 € (\$ 20 706)

Përshkrimi: **Qëllimi:** Rritja e kapaciteteve të prodhimit bujqësor dhe krijimit të mundësive të punësimit për gratë në komunën e Obiliqit.

Nevoja: Hapësira rreth rajonit të Obiliqit është shumë e pasur me minerale dhe posaçërisht linjit dhe në tokën bujqësore rreth kompleksit ekzistues industrial të termocentraleve. Prandaj, qytetarët e kësaj komune ose janë bujq, ose punojnë në kompaninë publike të termocentraleve. Termocentralet nuk po respektojnë standardet mjedisore dhe rregulloret. Së voni, njëri bllok i termocentralit është mbyllur dhe si pasojë ka lënë shumë njerëz të papunë dhe pa të ardhura të rregullta mujore. Në përgjithësi, gratë janë grupi më i cënueshëm kur kemi të bëjmë me mundësitë e punësimit, posaçërisht në komunat më të vogla dhe fshatra. Në këto vendbanime, gratë zakonisht kryejnë punët e shtëpisë dhe punët e riparimit në fusha dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në gjenerimin e të ardhurave për familjen. Një numër i madh i

atyre të cilët humbën punë për shkak të mbylljes së bllokut të termocentralit janë gra të moshës 45-60 vjeçare, për të cilat nuk do të jetë e lehtë të gjejnë vende të reja të punës dhe për shkak se ende nuk kanë të drejtë pensionimi. Megjithatë, këto gra ende kanë vullnet për punë dhe kanë përvojë të vogël në menaxhimin e fushave dhe prodhimin e mallrave bujqësore.

Veprimtaritë e projektit: Shoqata e grave "Aureola", me mbështetjen e agjencive tjera donatore në Kosovë, ka ndërtuar një serë për 62 familje me 75 m² për secilën. Duke qenë se kjo u dëshmuar të jetë një mundësi e mirë punësimi për gratë, shoqata e grave "Aurola" propozoi zgjerimin e serës ekzistuese prej 0,12 Ha në 0.5 Ha. Ky zgjerim do të mundësojë punësimin e 15 grave të cilat rishtazi kanë humbur vendin e tyre të punës në termocentral dhe kjo do të zvogëlojë shkallën e papunësisë ndër gratë në komunën e Obiliqit. Shkathtësitë e tyre të punës do të përmirësohen nëpërmjet trajnimit në vend të punës përgjatë 6 muajve. Prodhimet bujqësore do të mbledhen dhe do të shiten nëpërmes kooperativës të themeluar AGRO&EKO, me të cilën "Aureola" tashmë ka nënshkruar një marrëveshje dhe njëkohësisht është anëtare e saj.

Përzgjedhja dhe numri i përfituesve: Përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij projekti do të jenë 15 gra, ish punonjëse të termocentralit. Përzgjedhja e grave në nevojë do të bëhet në bashkëpunim me qendrat rajonale për punësim.

Bashkëpunim/qëndrueshmëria: Shoqata e grave "Aureola" tashmë ka një bashkëpunim afatgjatë me zyrat komunale për shërbime sociale dhe qendrat rajonale për punësim në fushën e fuqizimit ekonomik të grave. Në të njëjtën kohë, ajo është anëtare e kooperativës bujqësore AGRO&EKO në Obiliq. Kooperativa AGRO&EKO do të shërbejë si pikë e mbledhjes dhe shitjes së prodhimeve bujqësore.

Totali i përgjithshëm:

\$ 99 940, 96

Programi i Përmirësimit të Kosovës Përmes Edukimit

Programi i Përmirësimit të Kosovës përmes Edukimit (PPKE apo KITE) ka për qëllim të krijojë përmirësime afat-shkurtëra dhe afat-mesme në performancën e bizneseve dhe OJQ-ve në mënyrë që ta asgjësojë ndikimin e krizës globale fi-nanciare. Këto përmirësime do të jenë rezultatet direkte të trajnimeve të disenjuara në bazë të kërkesave si dhe me mentorim për sta-fin e bizneseve dhe të OJQ-ve. Qëllimi përfundimtar i programit KITE është ofrimi i elementeve të nevojshme për bizneset dhe OJQ-të në mënyrë që ato të ngriten në kapacitet, kualitet dhe kuantitet të shërbimeve që i ofrojnë, si dhe ta ngrisin fuqinë punëtore.

Nga bizneset dhe OJQ-të do të kërkohet t'i vlerësojnë nevojat e tyre, t'i identifikojnë dhe nominojnë anëtarët e sta-t të cilët do të mund të për-tojnë nga trajnimet speci-ke dhe të disenjuara në bazë të kërkesave. Programet do të përqëndrohen drejt bizneseve dhe OJQ-ve në mënyrë që ato ta risin nivelin e menaxhmentit dhe të kapaciteteve teknike me qëllim të ngritjes së konkurrencës dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Trajnimet do të krijojnë në bazë të kërkesës së aplikantëve, por edhe mund të përqëndrohen në fushat si: Planifikim Strategjik, Ngritje Fondesh, Marketing, Shitje, Menaxhim Financash, Inxhinieri, Komunikim Strategjik, Komunikim dhe Teknologji Informativ, Burime Njerëzore, Ueb Dizajn, Planifikim Evenimentesh, Biznes Agrikulture, Nisje Prodhimi, Elektronikë, Teknologji e Energjisë së Regjenerueshme, Shitëblerje Pro-nash dhe Vlerësim Biznesi.

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Kosovo Improvement Through Education-KITE	American Councils for International Education	173 687,90 €

#6 [Programi i mbështetjes për shkolla verore / dimërore dhe takime ndërkombëtare]

6 Programi i mbështetjes për shkolla verore/dimërore dhe takime ndërkombëtare

Bordi i KFOS-it në fillim të vitit 2011 krijoi një buxhet të veçantë për mbështetje të koso-varëve të cilët marrin pjesë në shkolla verore, dimërore, seminare, kongrese, simpoziume, etj. jashtë vendit. Ky program gjatë këtij viti i mundësoi rreth 100 individëve dhe organizatave të marrin pjesë në programe të ndryshme në Evropë, SHBA dhe Azi.

Në këtë vit u përpilua një udhëzues i cili ka kritere më të fokusuara të cilat na mundësuan që aplikacionet të cilat nuk përputhen me këto kritere, në start ti eliminojmë.

Prioritetet iu është dhënë të rinjëve dhe studentëve.

Lista e Granteve:

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Harvard National Model United Nations Delegation 2011	Fidan Çerkini	1000.00€
Harvard National Model United Nations Delegation 2011	Ermal Leci	188.30€
Artists' concert on Kosovo's third independence anniversary	Alberta Troni	380.00€
Artists' concert on Kosovo's third independence anniversary	Sanije Matoshi	380.00€
England's Folkestone Triennial	Erzen Shkololi	362.00€
Vaccinology Summer School, Belgium	Kushtrim Grezda	360.55€
UN Model 2011 – Singapore	Muhamed Latifi	1094.49€
Corruption-are we on a road to nowhere?	Qerkin Berisha	250.00€
American Institute for Political and Economic Systems	Arzana Myderrizi	268.00€
I Concerti Di Primavera	Ardita Ponosheci	549.20€
19 th Ain Shams International Medical Students Congress (AIMSC)	Taulant Sadriu	532.14€
Education Without Borders 2011	Zana Bacaj	549.80€
Stereotypes, Prejudice, Racism And Discrimination	Bajram Kinolli	268.24€
Stereotypes, Prejudice, Racism and Discrimination	Mirsad Dalipi	268.24€
EFANetwork-SEE Regional Meeting 2011	Taulant Hodaj	270.00€
39 th International ESTA Conference	Mrika Hoxha	720.00€
New Tear	Astrit Ismaili	210.20€

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
International Law and Power politics: Great Powers, Peripheries and Claims to Spheres of Influence in the International Normative Order	Kushtrim Istrefi	350.00€
International Summer School ISEO	Agon Dula	378.00€
Joint Action on Conflict Transformation and Peace-building	Rexhep Lushta	265.00€
Joint Action on Conflict Transformation and Peace-building	Nora Ahmetaj	265.00€
European Weekend School 2011	Gentiana Berisha	274.00€
The International Symposium on Cultural Diplomacy 2011	Arban Mehmeti	231.68€
Transformation Thinkers Reunion	Fatmir Curri	400.00€
IFCC World lab Berlin 2011	Ylka Begolli	410.00€
Summer School AIPES	Rene Behluli	369.00€
Take the best from East and West	Hana Cakuli	172.22€
Summer School Lubjana	Argjira Ramosaj	268.75€
Summer School Lubjana	Fitor Murati	268.75€
Summer School Lubjana	Butrint Ymeri	268.75€
International Summer School Berlin	Lura Limani	350.00€
Summer School in Italy	Jeta Jusufi	210.00€
European Architecture Student Rrita Pula Assembly, Spain	Rrita Pula	554.00€
DRC Summer School on Regional Co-operation, Austria	Veli Hoti	450.00€
Summer Entrepreneurship Academy	Ejona Blyta	250.00€
Summer Entrepreneurship Academy	Fatos Mehmeti	250.00€
Summer School, Helsinki	Nart Orana	342.00€
American Institute on Political and Economic Systems-AIPES 2011	Rea Kryeziu	320.00€
Take the best from East West	Artur Krasniqi	268.00€
The Summer Entrepreneurship Academy	Dafina Olluri	220.00€
The Summer Entrepreneurship Academy	Arian Rogova	200.00€

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
The Summer Entrepreneurship Academy	Jeta Bejtullahu	200.00€
MIT Professional Education Course	Erzen Komoni	700.00€
International Summer School Seggau	Doruntina Demiri	350.00€
International Culture week in Pesc ICWIP	Blond Gerqari	302.00€
Young Citizens Danube Network	Alejtin Berisha	320.00€
TFAS International Institute AIPES Leartha Hollaj 196.92€	Leartha Hollaj	196.92€
International Summer School Seggau	Yllka Hoxha	350.00€
Summer School on Vaccinology	Flaka Siqeca	264.52€
Europe Future Fashion 2011	Flutura Dedinja	355.00€
Genova Film Festival	Edita Azemi	250.00€
International Insitute for Political and Economic Studies IIPES	Besart Zhuja	380.00€
The Summer Entrepreneurship Academy	Leon Thaqi	456.72€
The Summer Entrepreneurship Academy	Flaka Qerimi	456.72€
The Summer Entrepreneurship Academy	Nita Nishliu	230.00€
Vois Vives de Mediterranean	Ali podrimja	680.00€
International Entrepreneurship University	Arta Istrefi	90.00€
Institute in International Commercial Law and Dis- pute	Marigona Hoti	289.45€
TFAS-AIPES	Fjolla Metaj	257.00€
Jadran Viseboj 2011	Armend Naxhiu	425.00€
Fredric Chopin-Festival	Lule Elezi	304.00€
Fredric Chopin-Festival	Antonio Gashi	304.00€
Happy Birthday Italy	Florin Sanaja	180.00€
Happy Birthday Italy	Vigan Beqiri	180.00€
Nicosia, Cyprus	Dijana Smijonovič	349.00€
European Architecture Student Assambly 2011	Rron Beqiri	385.00€
Arava-valley peace summer camp	Bardha Celaj	623.00€

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Summer Training Conference	Fitim Krasniqi	1080.00€
European Forum Alpbach 2011	Behar Mangjolli	260.00€
Arava Valley of Peace summer course	Krenar Roka	432.85€
Model United Nations of Istanbul MUNIST 2011	Jonila Fetiu	215.00€
International Summer University on Federalism, Decentralization and Diversity	Mimoza Telaku	415.00€
European Youth Parliament	Edona Sina	296.00€
Meetings of Design Students MEDS	Erzë Dinarama	230.00€
La Scala di Milano Academy	Riad Ymeri	435.99€
International Conference-The Sino-Global Discourse: The Growing Prominence of China on the World Stage; Exploring the Political, Economic and Cultural Relation of China and Global Stakeholders	Florina Zhubi	503.12€
PECS Advanced Training Picture Exchange Communication System	Mimoza Gashi	395.00€
Spaceship Yugoslavia	Driton Hajredini	408.00€
Intervention and State-building Seminar Series	Arben Qirezi	233.80€
Media reporting of the attacks on Dubrovnik and recognition of Croatia	Nora Musa	208.29€
EDSA Annual General Assembly	Driton Bajraktari	317.00€
International Congress on Medical and Law	Blerta Rexhepi	218.92€
International Congress on Medical and Law	Jetmir Sejdiu	204.00€
Think tank to promote recognition of skills gained through youth exchange programmers and voluntary work	Dardan Kryeziu	380.00€
Europe 3D	Visar Haxhifazliu	270.00€
JEF Europe Annual Congress	Granit Tërnavë	439.37€
International debate school of Slovenia	Donika Lamaxhema	239.00
Developing the Future GIZ	Jetmir Idrizi	695.55€
Europe's and Mediterranean Young Artists' Biennale	Albert Heta	513.00€

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Europe's and Mediterranean Young Artists' Biennale	Dren Berishaj	310.00€
Study Visit to Columbia University and presentation of organization's activities in suicide prevention in Kosovo	Vera Remškar	823.89€
Sundance-Film Festival	Blerta Zeqiri	1074.00€
Sundance-Film Festival	Kreshnik Berisha	1074.00€
Galerie Ardes European Art Club C.V Gjermani	Rron Qena	290.00€
Study Visit of youth from both sides of Mitrovica to Haifa, Israel: Workshop on leadership and volunteering	Community Building Mitrovica	2080.00€
La Scala di Milano Academy	Riad Ymeri	435.99€
Summer School, Helsinki	Nart Orana	342.00€

#7

[Programi Lindje Lindje Partneritet Përtej Kufijve]

#10 Programi Lindje Lindje Partneritet Përtej Kufijve

Programi Lindje Lindje Partneritet Përtej Kufijëve është program i rrjetit të OSI-it i cili synon përkrahjen e iniciativave regjionale dhe ndër-regjionale me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave dhe modeleve në fusha të ndryshme përmes takimeve rajonale, vizitave studiuuese, vizitave bilaterale, seminareve, etj. Ky program operon me buxhet të hapur, nuk përcakton buxhet për secilin fondacion dhe për secilin vit veçmas, por alokon mjetet e shpenzuara për projektet e aprovuara nga ky program çdo 6 muaj. Programi shihet si vlerë shtesë projekteve që gjatë implementimit kanë nevojë apo vlerësohet se eksperiencia e një shtetit tjetër do të ndihmonte që të arrihen rezultate më të konkrete. Asistenca e programit përpos përkrahjes financiare mund të pritet edhe në identifikimin e partnerëve, modeleve dhe eksperiencave nga shtetet e rrjetit të OSI. Ky program mbështet iniciativa inovative afatgjate të cilat kanë për qëllim gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për ndonjë çështje lokale (të vendit/shtetit), duke përdorur eksperiencia të shteteve të regjionit apo edhe të regjioneve tjera të rrjetit të OSI-it, e që është me ndikim në kontekstin ndërkombëtarë.

Përmes Programit Lindje Lindje Partneritet Përtej Kufijëve në vitin 2011 janë mbështetë 3 iniciative vendore, ndërsa është përkrahë pjesëmarrja në 9 iniciativa jasht vendin me 32 pjesëmarrës. Duke e pas parasyshë natyrën e programit Lindje Lindje Partneritet Përtej Kufijëve i cili është i hapur për aplikim gjatë tërë vitit dhe nuk limiton aplikimin për vit fiskal, është me rëndësi të thuhet së gjatë vitit 2011 është aplikuar edhe me 5 projekte tjera vendore të cilat janë në proces të vlerësimit dhe aprovimit, ndërsa njëri prej tyre është aprovuar në fillim të vitit 2012 dhe ka filluar me realizim.

Tensionet në rafshin politik në mes të Kosovës dhe Serbisë bënë që ky program të ketë një prej synimeve kryesore ngritjen e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile të dy shteteve. Gjate 2 viteve të kaluara janë rrealizua 5 projekte bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Serbisë në rafshe të ndryshe. Në kapacitet më të madh është punu me të rinjtë, ndërsa rezultate konkrete dhe të dukshme sjellën projektet e bashkëpunimit të artit dhe kulturës. Projekt me ndikim më të madh në rafshin politik ishte vizita e delegacionit të përfaqësuesve të think tank organizatave, intelektualëve dhe artistëve Serbisë.

Këtë vit programi mbështeti edhe dy projekte bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Repub-

likës Çeke i cili kishte për qëllim përmirësimin e kushteve për investime të huaja në Kosovë dhe një bashkëpunim në mes të Kosovës, Sllovakisë dhe Bosnës e Hercegovinës në marrdheniet ndërkombëtare dhe politikat e sigurisë.

Prishtina-Belgrade: Alternative dialogue-Sektor Civil në Kosovë dhe Serbi, kontribut në procesin e evropeizimit, 17-19 Maj, 2011, Beograd

Fondacioni në kuadër të projektit të vet Të komunikosh me Evropën e në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi qysh në 2010 e filloj një iniciativë për përforcimin e një dialogu civil në mes të organizatave të shoqërisë civile, intelektualëve dhe artistëve të këtyre dy shteteve. Kjo iniciative e filluar me një vizitë të një delegacioni të shoqërisë civile të Serbisë në 2010 u vazhdu në 2011 me vizitën kthyesë të delegacionit Kosovarë Sërbesisë që u relalizua në Maj 2011. Delegacioni Kosovarë i përbërë nga personalitete të shquara nga jeta publike, politike, mediave, kulturës vizituan Beogradin, disa prej tyre për herë të parë pas shumë e shumë vitesh. Gjatë vizitës u organiza në tryezë e rrumbullakët me temen: Kontributi i shoqërisë civile në evropeizimin e shoqërisë së Serbisë dhe Kosovës, u promovua një përmbledhje poezishë me titull: Nga Prishtina me dashuri dhe Nga Beogradi me dashuri të përgaditur prej autorëve të përzgjedhur nga Kosova dhe Serbia dhe u mbajt një press konferencë në Media Qendër të Beogradit. Temat e diskutimit në tryezë u ndanë në dy tërësi: Evropeizimi i cili i preki çështjet si: Sundimi i ligjit, liria e lëvizjes, toleranca dhe bashkëpunimi, në të cilin panelistë ishin: Jadranka Jelincic, Engjellushe Morina, Bosko Jaksic, Agron Bajrami, Vukshin Obradovic dhe Zll Hoxha dhe paneli i dytë: Kultura si katalizatorë i bashkëjetesës trajtoj tema si bashkëpunimin dhe dialogun kulturorë, kultura si element i rëndësishëm i marrdhenieve të ndërsjellta, shqyrtimi kritik i të kaluarës i cili u përqëndrua në një rrafsh shumë më neutral dhe njëherë për njëherë shumë frytdhënës në aspektin e bashkëpunimit në mes të dy shteteve. Panelist në panelin e dytë ishin: Milena Dragicevic-Sesic, Shkelzen Maliqi, Branimir Stojanovic, Belul Beqaj, Nenad Vasic.

Në press konferencë u paraqitën: Sonja Biserko, Agron Bajrami, Engjellushe Morina dhe Belul Beqaj. Një takim jo formal u mbajt edhe në mes të OJQ-ve Kosovare dhe atyre të Serbisë për të shqyrtuar hapjen e frontit me efektiv të bashkëpunimit. Në këtë takim 3 orësh morrën pjesë Klubi për Politika të Jashtme, IKS, KFOS, Qendra Multimedia, Komiteti i Helsinkit për të Drejtatat e Njeriut në Serbi. Fraktal, Qendra për

Regjionalizim, dhe Fondi për Shoqëri të Hapur i Serbisë. Prezantimi i përmbledhjes së poezive Nga Prishtina me dashuri u bë në Qendrën për Dekontamin të Kulturës e cila u pasua me një koktel për të gjith mysafirët. Projekti pati jehone të madhe në media, në veçanti ato serbe. Ky takim prodhoj edhe një deklaratë të përbashkët të drejtuar qeverisve të dy shteteve duke bërë thirrje për përkrahje të aktiviteteve dhe përpjekjeve të shoqërisë civile për të vendosur stabilitet dhe respektim të ndërsjellë në mes të dy shoqërive.

Partnership and cooperation building with Kosovar and Bosnian organizations in the field of international relations and security policy-10/09-20/11/2011

Objektivi kryesor afat-gjatë ishte është që të hapen kanale të bashkëpunimit dhe partneritetit me subjekte të rëndësishme jo-qeveritare dhe qeveritare nga Sllovakia dhe Bosnja, në mënyrë që kapacitetet e ekspertëve nga Kosova të promovohen dhe shërbejnë si rrugë e qëndrueshme e bashkëpunimit shumë-palësh. Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte thellimi i kontakteve me partnerët Sllovak si dhe nga Bosnja Hercegovina, për të realizuar projekte në fushën e këmbimit të përvojave nga procesi i integritimit Euro-Atlantik, reformën në sektorin e sigurisë, ndërtimin e institucioneve dhe krijimin e dokumenteve strategjike.

Faza e parë e projektit është implementuar në Prishtinë nga data 25-28 Shtator 2011 me rastin e vizitës së delegacionit Sllovak në përbërje: Samuel Arbe, Monika Masarikova, Rebecca Murray, Elemir Necej, Dusan Fischer , Vladimir Tarasovic.

Faza e dytë e projektit është implementuar në Bratislava nga data 16-19 Tetor 2011 me rastin e vizitës së delegacionit nga QKSS në përbërje, Florian Qehaj, Drejtor Ekzekutiv; Pëllumb Kallaba, Udhëheqës i Hulumtimeve dhe Saranda Stublla, bashkëpunëtore e Jashtme. Agjenda e vizitës ishte fokusuar kryesisht në takime në nivel drejtorësh politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në organizatën Slovak Foreign Policy Association dhe në Institute for Public Affairs, në kompaninë mediave EurActiv Slovakia. Temat e diskutimeve kryesisht ishin të ndërlidhura me mundësitë e rritjes së bashkëpunimit reciprok mes dy shoqërive civile, shpjegimit të situatës politike dhe të sigurisë në Kosovë dhe ndikimi i mos-njohjes nga 5 shtetet e BE-së në rrugën e integritimeve të Kosovës, procesi i shtet-ndërtimit dhe marrëdhëniet ndër-etnike etj. Po ashtu, më datë 18 Tetor 2011 në një auditorium të hapur

me studentët e shkencave politike dhe marrëdhënies ndërkombëtare në selinë e SOROS-it në Bratislavë, udhëheqësi i hulumtimeve nga QKSS ka prezantuar procesin e integritimit Euro-Atlantik të Kosovës prej 1999-2008 dhe nga 2008-2011 kryesisht duke u ndalur tek ndikimi i 5 shteteve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën në thyerjen e izolimit të lëvizshmërisë për qytetarët e Kosovës, dhe rrugën e shtet-ndërtimit. Gjatë kësaj bisede interaktive me studentë, janë shtruar shumë pyetje dhe komente lidhur me mënyrën e rritjes së bashkëpunimit mes dy shoqërive civile si dhe ndryshimin e perceptimit të opinionit publik Sllovak për Kosovën. QKSS ka shpërndarë edhe disa publikime të saja në gjuhën angleze për nevojat akademike të studentëve sllovak

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Pristina-Belgrade: Alternative dialogue-Sektor Civil në Kosovë dhe Serbi, kontribut në procesin e evropëizimit, 17-19 Maj, 2011, Beograd	Operational	\$ 5 679. 89
Improvement of Investment and entrepreneurial climat in Kosovo	Quality Kosovo	\$ 19 270
International Relations and Security Policy: Slovakia, Bosnia and Herzegovina and Kosovo	Kosovo Center for Security Studies	\$ 5 683.30

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Effective Participation of Ethnic Communities Vulnerable to Racial Discrimination	Ferdane Aslani	130
Effective Participation of Ethnic Communities Vulnerable to Racial Discrimination	Arta Asllani	130
Effective Participation of Ethnic Communities Vulnerable to Racial Discrimination	Lendrit Qeli	110
Effective Participation of Ethnic Communities Vulnerable to Racial Discrimination	Elvana Qorri	110
Effective Participation of Ethnic Communities Vulnerable to Racial Discrimination	Diana Shaka	110
Effective Participation of Ethnic Communities Vulnerable to Racial Discrimination	Elda Hamza	110
Empowerment of Roma as Equal Citizens: Overcoming Stereotypes and Exclusion	Jusuf Thaçi	120
Empowerment of Roma as Equal Citizens: Overcoming Stereotypes and Exclusion	Bekim Syla	120
Empowerment of Roma as Equal Citizens: Overcoming Stereotypes and Exclusion	Adrian Zeqiri	85
Empowerment of Roma as Equal Citizens: Overcoming Stereotypes and Exclusion	Andrea Najvirtova	85
Sustainable Donor Strategies and Practices in Civil Society Development in the Balkans	Venera Hajrullahu	328.20
Western Balkans Rural Communities: Cultural Connections and Cooperation	Erkan Vardari	128.34
Western Balkans Rural Communities: Cultural Connections and Cooperation	Bari Zenelaj	128.34
Western Balkans Rural Communities: Cultural Connections and Cooperation	Emine Ismajli	128.34
Western Balkans Rural Communities: Cultural Connections and Cooperation	Afrim Pajaziti	128.34
Western Balkans Rural Communities: Cultural Connections and Cooperation	Driton Kastrati	128.34
Western Balkans Rural Communities: Cultural Connections and Cooperation	Emrush Huduti	128.34
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Mehmet Behluli	669.38
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Shkelzen Maliqi	669.38
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Valbona Shujaku	669.38
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Jeton Neziraj	669.38
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Aliriza Arenliu	669.38
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Florent Mehmeti	669.38
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Alban Muja	669.38

Project Title	Grantee	Grant Amount
Facing the Past / Creating the Future: Role of Culture in the Reintegration of the Western Balkans	Erzen Shkololli	669.38
Education for Democratic Citizenship and Human Rights: from Theory to Practice	Enesa Kadic	279.45
Tolerance and Cultural Interactions in the Balkans	Refik Kasi	287.50
Tolerance and Cultural Interactions in the Balkans	Mustafa Bale	287.50
20 Years Later: Dubrovnik and Vukovar	Azem Vllasi	255.00
Making Democracy Work Where Transition Seems to Fail	Edmond Kumnova	80
Making Democracy Work Where Transition Seems to Fail	Rozafa Ramadani	80
Making Democracy Work Where Transition Seems to Fail	Muhamet Bytyqi	80